Fenomeni i abuzimit seksual të fëmijëve paraqet kërcënim serioz për shoqërinë në tërësi dhe si parakusht dhe konform kësaj doemos duhet në mënyrë të vazhdueshme të gjenden masa dhe mekanizma të rinj përkatës për parandalimin e tij dhe kuptohet pengimin e përhapjes së mëtutjeshme të tij.

Abuzimi dhe eksploatimi seksual i fëmijëve është një dukuri mbi të cilën ndikojnë më shumë faktorë kompleks. Abuzimi dhe eksploatimi i fëmijëve gjeneron dukuri të fenomeneve komplekse dhe të shumëllojshme nga të cilat rezultojnë pasoja komplekse që ndikojnë mbi zhvillimin psikofizik të fëmijëve.

Me qëllim të pengimit, reduktimit dhe mbrojtjes së fëmijëve nga ky abuzim, detyrimsht nevojitet reagim shoqëror multidisiplinar dhe diferencues, gjithashtu nevojitet sistem i intervenimeve mbrojtëse të cilat, para së gjithash, do të përfshinin nivele të ndryshme të parandalimit, pastaj identifikimin, përkatësisht detektimin e abuzimit, analizimin e rasteve, sigurimin e mbrojtjes së drejtpërdrejt juridike, si dhe mbrojtjen shëndetësore, sociologjike-psikologjike, rehabilitimin e fëmijëve të abuzuar por edhe trajtimin përkatës të dhunuesve.

Në mënyrë që të arrihen këto objektiva dhe të përmbushet efikasiteti i tyre, nevojitet përfshirja dhe aktivizimi i më shumë sistemeve institucionale, duke filluar nga arsimit, shëndetësia, mbrojtja sociale, organet gjyqësore dhe organet për ndjekje dhe kuptohet sektori joqeveritar.

Problemi me abuzimin nuk është vetëm nacional, nuk është i izoluar, nuk rezulton dhe nuk mund të zgjidhet vetëm në kuadër të shtetit. Ai është shumë i gjerë, është problem global dhe për tejkalimin e tij me rëndësi të madhe është lidhja në rrjet i të gjitha institucioneve të cilët drejtpërsëdrejti ose tërthorazi janë të ndërlidhur dhe e trajtojnë këtë problem.

Dukuritë e abuzimit të fëmijëve, veçanërisht abuzimi dhe eksploatimi seksual, i tejkalonë kufijtë e brendshëm dhe i hasim edhe në vendet e zhvilluara edhe në vendet në zhvillim. Ky abuzim i fëmijëve shndërrohet në problem global, me ç'rast mesazhi kryesor i Kombeve të Bashkuara për dhunën mbi fëmijët, mes të cilave edhe abuzimi seksual, është se "nuk mund të arsyetohet asnjë lloj i dhunës mbi fëmijët dhe çdo lloj i dhunës mbi fëmijët duhet dhe mund të parandalohet".

Abuzimi seksual dhe eksploatimi seksual dhe shfrytëzimi i fëmijëve po shndërrohet në problem gjithnjë e më aktual për të cilin flitet çdo ditë e më shumë dhe denoncohet



numër gjithnjë e më i madh i rasteve të këtilla. Së këtejmi, imponohet nevoja për ndërmarjen e masave nga ana e çdo shteti në plan të brendshëm, por edhe përmes bashkëpunimit ndërkombëtar. Ndërmarrja e masave parandaluese, mbrojtëse dhe rehabilituese duhet të kontribuojë që fëmijët të jetojnë në mirëqenie dhe të respektohet interesi më i mirë i tyre pa kurrfarë diskriminimi, si principe fundamentale dhe themelore për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të çdo fëmije.

Në numrin më të madh të rasteve të abuzimit seksual të fëmijëve janë të pranishme dukuri të caktuara socio-patologjike, ndërkaq dukuria më e përhapur socio-patologjike në familje është alkoolizimi, çrregullimet psikike, ndërkohë që janë edhe varësitë nga droga dhe prostitucioni tek nëna.

Hulumtimet mbi fëmijët e abuzuar seksualisht dëshmojnë se fëmijët nuk kanë çdoherë lëndime fizike, por sa i përket gjendjes psikike, tek këta fëmijë mund të konstatohet se ata kanë çrregullime dhe çekuilibre psikike, ndërsa kjo më së shpeshti manifestohet përmes sjelljes agresive të fëmijëve, problemeve me komunikimin me të tjerët, problemeve me vëmendjen, çrregullimin e gjumit, depresionin dhe dukuri të tjera të cilat mund të lënë pasojë të përhershme në zhvillimin psikik të fëmijës. Pikërisht për këtë, të gjitha këto shenja, para së gjithash, duhet t'i vërejnë prindërit, ndërkaq t'i konstatojnë edhe organet kompetente dhe personat të cilët drejtpërsëdrejti ose tërthorazi janë të lidhur me fëmijën, ndërsa kjo nënkupton trajnimin dhe aftësimin e tyre përkatës për identifikimin më të lehtë të këtyre shenjave dhe në këtë kontekst të reagojnë shpejtë dhe me efikasitet, si dhe të aplikojnë metoda përkatëse për punë me fëmijën, por edhe për punë me familjen me qëllim të pranimit dhe mbështetjes së fëmijës, në mënyrë që të tejkalohen traumat të cilat mund ta ndryshojnë tërë jetën e fëmijës-viktimë.

Nisur nga kjo, rol të jashtëzakonshëm luan familja dhe për këtë qëllim qendrat për punë sociale, përmes masave dhe veprimeve të tyre, nevojitet t'i përforcojnë kapacitetet e familjes në lidhje me kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijës, të kryejnë mbikëqyrje profesionale dhe të vazhdueshme mbi të drejtën prindërore, të realizojnë punë ekipore këshillimore përkatëse dhe interdisiplinale me familjen dhe me fëmijën.

Me rëndësi të madhe është identifikimi i hershëm i fëmijëve-viktima të abuzimit seksual, ndërsa për këtë qëllim rol më proaktiv duhet të kenë të gjitha subjektet, veçanërisht profesionistët e qendrave për punë sociale, institucionet edukative-arsimore me të cilët fëmija është në kontakt të përditshëm, shërbimet për mbrojtje shëndetësore, institucionet për mbrojtje sociale dhe organet dhe organizatat e tjera të cilat punojnë me fëmijët dhe për fëmijët. Për t'u arritur kjo domosdoshmërisht nevojitet koordinimi dhe bashkëpunimi i ndërsjellë midis të gjitha këtyre subjekteve.

Për dhunën mbi fëmijët, dhe sidomos për abuzimin dhe eksploatimin seksual nuk duhet të heshtet, por duhet të tejkalohet heshtja e cila akoma është e pranishme dhe shpeshherë nuk denoncohen rastet e këtilla, edhe pse kohëve të fundit në publik flitet gjithnjë e më shumë për dukuritë e këtilla. Në këtë kontekst, ndërmarrrja e masave efikase, të shpejta dhe me kohë dhe reflektimi i tyre në politikat dhe programet nacionale duhet kontribuojnë në reduktimin e dukurive të çfarë do qoftë lloji të abuzimit dhe eksploatimit seksual të fëmijëve, me qëllim që sa më lehtë të tejkalohen traumat dhe përvojat e dhimbshme të viktimizeve të cilat shpeshherë kanë pasojë afatgjatë mbi zhvillimin e tyre të mëtutjeshëm psikofizik.

OBJEKTIVAT DHE PËRFSHIRJA E HULUMTIMIT (Periudha e përfshirë nga data 01.01.2008 – 30.06.2011)

Qëllimi i hulumtimit ishte grumbullimi i të dhënave nga të gjitha organet dhe institucionet relevante me qëllim të përcaktimit të gjendjes faktike me abuzimin seksual dhe eksploatimin seksual të fëmijëve në Republikën e Maqedonisë.

Njëherësh, përmes hulumtimit duhej të merreshin informata për mënyrën e perceptimit dhe kuptimit të këtij abuzimi të fëmijëve nga profesionistë në organet kompetente, nëse personat profesionistë të cilët veprojnë në lidhje me këtë abuzim të fëmijëve janë të pajisur me dije dhe shkathtësi për ta identifikuar shfrytëzimin, abuzimin dhe eksploatimin e fëmijëve. Me hulumtimin duhej të përcaktohej nëse dhe sa masa parandaluese janë paraparë për parandalimin dhe reduktimin e kësaj dukurie dhe cili është efikasiteti i tyre dhe në ç'masë ndërmerren masa për mbrojtje dhe rehabilitim të fëmijëve-viktima të këtij abuzimi. Po ashtu, me këtë hulumtim duhej të siguroheshin të dhëna se cilat janë shkaqet për shfaqjen e këtij abuzimi të fëmijëve, cilat kategori të fëmijëve janë më së shpeshti viktima, si dhe nëse politika normative ndëshkuese mundëson veprim parandalues, ndëshkim përkatës të kryerësve dhe parandalimin e personave tjerë për të kryer abuzim të këtillë mbi fëmijët. Hulumtimi është kryer në mbarë Republikën e Maqedonisë dhe është bazuar mbi të dhënat, masat dhe rekomandimet e të gjitha organeve kompetente (të gjitha gjykatat kompetente, prokuroritë publike, qendrat për punë sociale, organet policore dhe organizatat joqeveritare).

METODOLOGJIA PËR REALIZIMIN E HULUMTIMIT

Si parakushte kryesore për identifikimin e kësaj dukurie, reduktimin dhe parandalimin e saj është rregullimi normativ, implementimi praktik i kornizës ligjore, si dhe lidhshmëria e ndërsjellë dhe veprimi i koordinuar i të gjitha subjekteve të cilët janë të ngarkuar me ligj për të ndërmarrë masa për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga ky lloj abuzimi. Njëkohësisht, është i rëndësishëm roli i çdo individi, prindi, pedagogu, qytetari ta identifikojnë këtë abuzim dhe nëse ka informata për abuzim të këtillë ta denoncojë në organet përkatëse në mënyrë që me kohë të ndërmerren masa për parandalimin e abuzimit të këtillë dhe t'i ndihmohet viktimës.

Në këtë kuptim, me qëllim që të përcaktohet nëse janë plotësuar parakushtet e cekura paraprakisht, si instrumente që janë shfrytëzuar gjatë hulumtimit është analiza e legjislacionit ndërkombëtar dhe vendas për këtë çështje dhe konstatimi për harmonizimin e legjislacionit vendas me aktet ndërkombëtare, veçanërisht me Konventën e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Eksploatimi Seksual dhe Abuzimi Seksual dhe Konventën për të Drejtat e Fëmijës.

Me qëllim të sigurimit të të dhënave për përhapjen e kësaj dukurie, për format e abuzimit seksual dhe eksploatimit seksual të fëmijëve dhe të dhënave të tjera të cilat janë të rëndësishme për këtë çështje u dërguan pyetësorë me numër të madh të pyetjeve edhe atë pranë organeve kompetente (të gjitha qendrat për punë sociale, sektorët për punë të brendshme në mbarë Republikën, të gjitha prokuroritë themelore publike dhe të gjitha gjykatat themelore, si dhe organizatat joqeveritare të cilat merren me këtë problem). Të dhënat e pranuar janë analizuar dhe janë specifikuar konstatime dhe gjendje të caktuara.

Në pyetësorët për gjykatat u parashtruan pyetje nga të cilat u konstatua se si e kuptojnë dhe përshkruajnë nocionin e abuzimit dhe eksploatimit seksual të fëmijëve, cili është numri i fëmijëve-viktima sipas veprave të caktuara penale për të cilat kanë vepruar gjykatat në periudhën e përfshirë me hulumtimin, numri i kryerësve të moshës madhore të



veprave të cekura penale edhe atë në kontekst të kallëzimeve të paraqitura penale, aktakuza të ngritura, numri i personave të dënuar, si dhe të dhëna për llojin e dënimeve. Njëherësh, nga përgjigjet e gjykatave u konstatua se cili është profili i viktimave të veprave penale, të cilat kanë të bëjnë me abuzimin seksual dhe eksploatimin seksual të fëmijëve, edhe atë sipas: gjinisë, moshës, statusit arsimor, përkatësisë etnike, karakteristikat e familjes, statusin ekonomik, hedikepit të fëmijës, karakteristikat të tjera. Gjithashtu, nga përgjigjet e gjykatave u konstatua, se një fëmijë i njëjtë dhe një kryerës i njëjtë a është paraqitur përsëri në rolin e njëjtë dhe cili është numri i rasteve të këtilla, si dhe nëse fëmija është dëshmitar në procedurë a janë implementuar masa për ndihmë dhe mbrojtje dhe cilat masa janë ndërmarrë. Po ashtu, nga të dhënat e gjykatave u konstatua se cilët fëmijë janë më së shpeshti viktimat të llojeve të këtilla të abuzimeve dhe cilat grupe të fëmijëve në veçanti i ekspozohen rrezikut të abuzimit dhe eksploatimit seksual (përkatësisht a janë ata fëmijë: pa prindër; që jetojnë në varfëri; të cilët e kanë braktisur shkollën; fëmijë të komuniteteve minoritare; migrantë; fëmijët të ekspozuar në dhunë familjare; me përvoja paraprake të abuzimit seksual dhe eksploatimit seksual; fëmijë në rrugë; me nevoja të veçanta; përdorues të drogave; me zhvillim të pamjaftueshëm mendor; aftësi të kufizuara mendore ose kategori tjera të fëmijëve). Elementet i rëndësishëm pozitiv për tejkalimin e problemeve është nevoja e bashkëpunimit të gjykatave me organet e tjera, me ç'rast nga përgjigjet e pranuar u konstatua se me cilat shërbime bashkëpunojnë ato dhe si është ai bashkëpunim. Gjithashtu, me rëndësi të veçantë është trajnimi i vazhdueshëm i të gjithë profesionistëve të cilët punojnë me këtë kategori të fëmijëve, me ç'rast u konstatua se a kanë marrë pjesë gjyqtarët në programe për parandalim. Me qëllim të zgjidhjes së të gjitha problemeve me të cilat ndeshen gjykatat, disa gjykata dhanë propozime dhe rekomandime të tyre për përmirësimin sidomos të sistemit të parandalimit dhe mbrojtjes së fëmijëve-viktima të abuzimit seksual dhe eksploatimit seksual. Pranë prokurorive themelore publike u parashtruan të njëjtat pyetje sikurse edhe për gjykatat. Ndërkaq, nga përgjigjet për profesionistët në shërbimet policore, po ashtu, u konstatua nëse dhe sa e kuptojnë nocionin e abuzimit seksual dhe eksploatimit seksual, cili është numri i fëmijëve të denoncuar në organet policore dhe numri i fëmijëve-viktima të identifikuar të këtij lloji të abuzimit, struktura gjinore e fëmijëve-viktima, numri i kallëzimeve penale të paraqitura, numri i të dyshuarve dhe numri i veprave të kryera penale të këtij lloji. Gjithashtu, profesionistët e shërbimeve policore dhanë përgjigje (jo të gjithë) se cili është profili i fëmijëve-viktima, cilat masa për mbrojtje i ka ndërmarrë policia, nëse fëmijën-viktimë, policia e ka dërguar në ndonjë institucion tjetër profesional për ndihmë, si dhe si zbatohen programet për ndihmë dhe mbrojtje. Përndryshe, nga përgjigjet e organeve policore u konstatua se cilat kategori të fëmijëve, sipas analizave të tyre, veçanërisht janë të ekspozuar në rrezik nga abuzimi seksual dhe eksploatimi seksual. Po ashtu, është mjaft me rëndësi se me cilat shërbime bashkëpunojnë organet policore për ndihmë dhe mbrojtje të fëmijëve-viktima, si dhe nëse marrin pjesë në programet për parandalim dhe ndërmarrjen e veprimeve për parandalim. Gjithashtu, një pjesë e shërbimeve policore dhanë rekomandime të tyre për përmirësimin e gjendjes.

Nga të dhënat e pranuar sipas pyetësorit të dërguar pranë qendrave për punë sociale, gjithashtu u konstatua gjendja në lidhje me çështjet e cekura më lart për rastet e denoncuar në qendër, për statusin arsimor të fëmijëve-viktima të çdo lloj veprave penale, çfarë moshe janë fëmijët-viktima të denoncuar, cila është përkatësia e tyre nacionale. Gjithashtu u pranuan përgjigje (jo nga të gjitha qendrat) nëse dhe me cilat shërbime bashkëpunojnë dhe a kanë marrë pjesë në programet për parandalim dhe a kanë ndërmarrë veprime për parandalim.

Pyetësori iu dërgua edhe organizatave joqeveritare për të cilat pyetjet e para ishin të njëjta sikurse edhe për organet dhe institucionet e tjera, ndërsa në mënyrë plotësuese, sikurse edhe për qendrat për punë sociale edhe organizatave joqeveritare iu parashtruan pyetjet se si viktimat ka mbërritur në qendër, përkatësisht në organizatën joqeveritare, mbi bazë të cilëve indikatorë qendrat dhe organizatat joqeveritare kanë konstatuar se bëhet fjalë për fëmijë-viktima të abuzimit seksual dhe eksploatimit seksual dhe ta përshkruajnë punën e tyre për rastet konkrete dhe për çështjet të tjera në lidhje me bashkëpunimin, pjesëmarrjen

në programe për parandalim dhe rekomandimet e tyre.

Gjithashtu, gjatë hulumtimit u zhvillua edhe analizë në lidhje me informatat dhe qëndrimet e profesionistëve për këtë fenomen përmes intervistave të fokus-grupeve me profesionistë nga të gjitha fushat (institucione sociale, arsimore, shëndetësore, policia, prokuroria, gjykatat), organet nacionale (parlamentare dhe qeveritare) dhe organizatat jo-qeveritare (janë mbajtur 4 fokus-grupe dhe analiza e informatave dhe masave të ndërmarra nga intervistat e zhvilluara me fëmijët-viktima të abuzimit seksual.

Njëherësh, në hulumtim janë shfrytëzuar edhe të dhënat dhe informatat e Avokatit të Popullit për këtë problem përmes parashtresave të pranuara dhe hulumtimeve të realizuara, si dhe të dhëna dhe analiza të hulumtimit nga organe dhe institucione tjera për këtë problem.

Pyetësorë të dërguar

Nr. rend.	Institucione/organizata të dhënat e të cilëve janë analizuar	Pyetësor të dërguar
1.	Mbrojtja sociale (QPS)	32
2.	Fusha-juridiko-penale-gjithsej	61
	• Ministria e Punëve të Brendshme	11
	• Prokuroria	22
	• Gjykata	28
3.	Organizata joqeveritare	9
GJITHSEJ:		102

Intervista të realizuara me fokus-grupe me profesionistë nga të gjithë sektorët (Maj - Qershor 2012)

Janë mbajtur gjithsej 4 intervista me fokus-grupe, me nga 6-15 pjesëmarrës, nga fusha sociale, arsimore, shëndetësor, gjyqësore, prokurori publike, Ministria e Punëve të Brendshme, organe dhe komisione nacionale, organizata joqeveritare.

Intervista me fokus-grupet ishin me kohëzgjatje prej 120-180 minuta.

Janë mbajtur 5 intervista të detajuara me fëmijët-viktima të abuzimit seksual.

Intervistat e detajuara u mbajtën nga psikologu me përvojë në punën me viktima të dhunës në familje dhe lloje tjera të dhunë në sektorin joqeveritar.

Studimet për rastet e fëmijëve-viktima janë siguruar nga organizata joqeveritare e cila siguron pranimin dhe punën me viktimat e trafikimit me njerëz nga të gjitha pjesët e Republikës dhe nga Qendra për Punë Sociale në Shkup dhe me pëlqim të marrë paraprakisht nga prindërit dhe fëmijët.

LEGJISLACIONI JURIDIKO-PENAL I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PËR VEPRA PENALE TË CILAT KANË TË BËJNË ME EKSPLOATIMIN SEKSUAL DHE ABUZIMIN SEKSUAL TË FËMIJËVE

Me **Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë** parashikohen më shumë vepra penale të cilat kanë të bëjnë me eksploatimin seksual dhe abuzimin seksual të fëmijëve, edhe atë:

Përdhunimi

Neni 186 – marrëdhënie seksuale ose formë tjetër të sulmit seksual, që përfshin përdorimin e forcës ose kërcënimit.

Dënim me burgim prej tre deri më dhjetë vjet.

Sulm seksual mbi një person të pamundur

Neni 187- marrëdhënie seksuale ose formë tjetër e sulmit seksual që përfshin shfrytëzimin e viktimës së pamundur, viktimës e cila vuan nga sëmundje mendore, çrregullime mendore, zhvillim i prapambetur psikik ose ndonjë gjendje tjetër për shkak të së cilës viktimë nuk është në gjendje t'i rezistojë sulmit.

Dënim me burgim me më së paku tetë vjet, ose më së paku dhjetë vjet dhe mundësi për dënim të përjetshëm në rastet të cilat përfshijnë rrethana rënduese.

Sulm seksual mbi person të mitur i cili nuk ka mbushur moshën 14 vjeç

Neni 188- marrëdhënie seksuale ose formë tjetër e sulmit seksual mbi fëmijën që është nën moshën 14 vjeç.

Dënim me burgim prej më së paku tetë, ose më së paku dhjetë vjet me mundësi për dënim me burgim të përjetshëm në rastet kur ekzistojnë rrethana rënduese.

Sulm seksual përmes keqpërdorimit të pozitës

Neni 189 - detyrimi në marrëdhënie seksuale ose formë tjetër të sulmit ose aktit seksual përmes keqpërdorimit të pozitës së kryerësit, kur viktimë gjendet në rolin e vartësit dhe të nënshtruarit.

Për kryerësin e kësaj vepre penale mbi person të rritur: dënim me burgim prej më së paku pesë vjet.

Për kryerësin e kësaj vepre penale mbi person të mitur: dënim me burgim prej më së paku dhjetë vjet.

Kënaqja e instinktit seksual para personit tjetër (kryerje e aktit seksual para personit tjetër)

Neni 190 – kryerje e aktit seksual në vend publik para personit tjetër ku viktimë mund të jetë person i moshës madhore ose i mitur, ose detyrim të fëmijës të kryejë akt të tillë seksual, pavarësisht nëse kjo bëhet në vend publik ose vend tjetër.

Për persona të moshës madhore dhe të mitur të cilët kanë kryer akt të këfillë seksual në vend publik: dënim me para ose dënim me burgim deri një vit.

Për detyrimin e personit të mitur nën moshën 14 vjeç për kryerje të aktit të tillë seksual në vend privat: dënim me burgim në kohëzgjatje prej tre deri më pesë vjet.

Ndërmjetësim në kryerjen e prostitucionit

Neni 191- rekrutim, detyrim, joshje, gënjim të personave për të kryer prostitucion, si dhe mashtrim dhe dorëzim të personit tek personi tjetër me qëllim të kryerjes së prostitucionit dhe me qëllim të realizimit të përfitimit ose përmes kërcënimit me forcë fizike, të ketë dobi nga dhënia e shërbimeve seksuale.

Dënim me burgim prej pesë deri më dhjetë vjet.

Manipulim dhe mundësim i veprimeve ose akteve seksuale me fëmijë

Neni 192- manipulimi dhe mundësimi i akteve seksuale me fëmijë.

Dënim me burgim prej më së paku tetë vjet.

Paraqitja e materialeve pornografikë para një të mituri

Neni 193- shitja, paraqitja ose mënyra tjetër e sigurimit të qasjes deri te materialet pornografikë në të cilat viktimë është fëmija nën moshën 14 vjeç.

Kjo veprë penale gjithashtu nënkupton prodhim të materialit pornografik përmes shfrytëzimit të fëmijës-viktimë nën moshën 18 vjeç.

Për paraqitjen e materialeve pornografikë viktimës nën moshën 14 vjeç: dënim me burgim prej gjashtë muaj deri më tre vjet.

Për prodhuesin të materialit pornografik, në të cilin përfshihet shfrytëzimi i personave të mitur nën moshën 18 vjeç: dënim me burgim nga tre deri pesë vjet.

Produksioni dhe shpërndarja e pornografisë së fëmijëve përmes sistemit kompjuterik

Neni 193-a- furnizim, posedim dhe prodhuesin të pornografisë në të cilën fëmija-viktimë është nën moshën 18 vjeç, me qëllim që t'i paraqitet personit tjetër ose për distribuim ose transferim.

Dënim me burgim nga tre deri pesë vjet.

Neni 193-b – caktim i takimit ose lloj tjetër i mashtrimit të të miturit, i cili nuk i ka mbushur 14 vjet, në akt seksual ose veprim tjetër seksual ose të prodhuesin të pornografisë për fëmijë dhe nëse me këtë qëllim është realizuar takim i drejtpërdrejt me të miturit, përmes mjeteve kompjuterike-komunikuese.

Dënim me burgim prej një deri pesë vjet.

Incest

Neni 194 – marrëdhënie ose akt tjetër seksual ndërmjet farefisit me lidhje gjaku, përfshirë edhe ndërmjet vëllezërve dhe motrave.

Për kryerjen e kësaj veprë penale mbi person të moshës madhore ose person të mitur mbi moshën 14-vjeç: dënim me burgim nga pesë deri dhjetë vjet.

Për kryerje të kësaj veprë penale mbi fëmijë i cili është nën moshën 14 vjeç: dënim me burgim prej më së paku dhjetë vjet.

Jetë jashtëmartesore me person të mitur

Neni 197- të jetuarit në bashkësi jashtëmartesore me person të mitur ose lejimi i ekzistimit të bashkësisë së këtyre jashtëmartesore.

Dënim me burgim prej tre muaj deri tre vjet.

Trafikimi me fëmijë

Neni 418-g- regrutimi, transporti, blerja, sigurimi i strehimit ose pranimit të personave të mitur me qëllim që të shfrytëzohen për prostitucion ose forma tjera të eksploatimit seksual, pornografisë, martesës së detyrueshme, barrësimit të detyrueshëm, si dhe shfrytëzimi ose mundësimi i personave tjerë të shfrytëzojnë person të mitur për shërbime seksuale.

Dënim me burgim prej më së paku tetë vjet, ose dënim me burgim me së paku dhjetë vjet kur ekzistojnë rrethana rënduese.



VEPRA PENALE TË PARAPARA ME KONVENTËN E KËSHILLIT TË EVROPËS PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE NGA EKSPLOATIMI SEKSUAL DHE ABUZIMI SEKSUAL

Sipas Konventës, nën shprehjen eksploatim seksual nënkuptohet abuzimi seksual, prostitucioni i fëmijëve, pornografia e fëmijëve, pjesëmarrja e fëmijës në shfaqje pornografike.

Abuzimi seksual (Neni 18 i Konventës) e inkriminalizon këtë vepër nëse ekzistojnë aktivitete seksuale me fëmijë, i cili konform legjislationit vendas nuk e ka mbushur moshën e caktuar kur aktivitetet seksuale janë të lejueshme që të hyjë fëmija në aktivitete seksuale dhe kur është aplikuar dhuna, forca ose kërcënimi, ose nëse keqpërdorimi kryhet nga pozita e autoritetit, besimit ose ndikimit mbi fëmijën, përfshirë edhe gjendjen në familje.

Veprat penale, në lidhje me prostitucionin e fëmijëve (Neni 19 i Konventës), trajtohet si regrutim i fëmijës në prostitucion ose manipulim i fëmijës për të marrë pjesë në prostitucion, si dhe detyrimi i fëmijës për të ushtruar prostitucion ose përfitime nga eksploatimi tjetër i fëmijës për qëllime të tilla dhe cili do qoftë akt tjetër që shpie në drejtim të prostitucionit të fëmijës.

Veprat penale, në lidhje me pornografinë e fëmijëve (Neni 20 i Konventës), nënkuptojnë prodhim të pornografisë të fëmijëve, ofrim ose përgatitje të pornografisë së arritshme të fëmijëve dhe shpërndarjen dhe transmetimin e saj, si dhe furnizimin e pornografisë së fëmijëve për vete ose person tjetër, posedim të pornografisë të fëmijëve dhe krijimin me vetëdijeje të mundësisë për qasje përmes teknologjive informative ose komunikuese deri te pornografia e fëmijëve.

Vepra penale, në lidhje me pjesëmarrjen e fëmijëve në shfaqjet pornografike (Neni 21 i Konventës), nënkupton rekrutimin e fëmijës për të marrë pjesë në shfaqje pornografike ose joshjen e fëmijës për të marrë pjesë në shfaqje të këtilla, detyrimin e fëmijës për të marrë pjesë në shfaqje pornografike ose lloj tjetër të eksploatimit të fëmijës për qëllime të këtilla, si dhe me vetëdije të merr pjesë në performansa pornografike të cilat përfshijnë fëmijë.

Vepra penale, në lidhje me korrupsionin e fëmijëve (Neni 22 i Konventës), paraqet nxitje të qëllimshme për qëllime seksuale të fëmijës, i cili nuk është në moshën e përcaktuar në Nenin 18 të Konventës për të qenë dëshmitarë i abuzimit seksual ose aktiviteteve seksuale, por edhe atëherë kur ai nuk merr pjesë në mënyrë të drejtpërsëdrejt në atë.

Vepra penale, të cilat kanë të bëjnë me ofrimin e fëmijëve për qëllime seksuale (Neni 23 i Konventës), nënkuptojnë propozim të qëllimshëm përmes teknologjive informative dhe komunikuese të personit të rritur për takim me fëmijë i cili nuk e ka mbushur moshën e nevojshme, në përputhje me Nenin 18 të Konventës, me qëllim të kryerje së ndonjëres nga veprat e përcaktuara në Nenin 18, paragrafin 1 ose Nenin 20, paragrafin 1 ndaj tij ose asaj kur ky propozim është përcjell me akte materiale të cilët çojnë drejt takimit të tillë.

Nga analiza e veprave penale të parapara me Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë mund të konstatohet se në masë më të madhe përkojnë me veprat penale dhe përkufizimet e tyre të përcaktuara me Konventën.

ANALIZA E MASAVE TË VEÇANTA TË PARAPARA ME KONVENTËN DHE KORNIZËN LIGJORE DHE IMPLEMENTIMI I TYRE NË PRAKTIKË

Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Eksploatimi dhe Abuzimi Seksual është miratuar për shkak të nevojës që të përgatitet një instrument ndërkombëtar gjithëpërfshirës i cili fokusohet në masa parandaluese, mbrojtëse dhe masa juridiko-penale për luftë kundër të gjitha formave të eksploatimit dhe abuzimit seksual të fëmijëve dhe për t'u vendosur mekanizëm monitorues i posaçëm, me qëllim të rritjes së bashkëpunimit dhe unitetit të vendeve të Evropës në luftën kundër keqpërdorimit të cekur të fëmijëve.

Konventa, detyrimisht duhet të implementohet nga vendet nënshkruese si përmes legjislacionit ashtu edhe përmes implementimit praktik të masave të parashikuara. Në këtë kontekst, çdo shtet nënshkruar, para së gjithash, duhet t'i realizojë objektivat e përcaktuara me Konventë, përkatësisht t'i ndërmerret të gjitha masat e mundshme për parandalimin dhe luftën kundër eksploatimit seksual dhe abuzimit seksual të fëmijëve, të sigurojë mbrojtje efikase përkatëse të fëmijëve-viktima të këtij lloj abuzimi me respektimin e tri principeve kryesore të garantuara me Konventën për të Drejtat e Fëmijës, përkatësisht të gjitha masat të ndërmerren pa kurrfarë diskriminimi mbi çfarë do qoftë baze, respektim të interesit më të mirë të fëmijës dhe realizim të të drejtës për pjesëmarrjen e fëmijëve në çështjet dhe vendimet të cilat kanë të bëjnë me ta, gjithsesi në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tyre, si dhe të promovohet bashkëpunimi në nivel të brendshëm midis të gjitha organeve dhe organizatave, por edhe në bashkëpunim ndërkombëtar (Neni 1 dhe 2 i Konventës).

Ajo që duhet të ndërmerret, në mënyrë që të arrihen objektivat e Konventës së cekur, para së gjithash duhet të ndërmerren masa preventive edhe atë përmes kornizës ligjore dhe masave tjera praktike për implementimin e Konventës dhe të legjislacionit të brendshëm (Neni 4 i Konventës).

Analiza e kornizës ligjore

Me qëllim të veprimit preventiv për mbrojtjen e fëmijëve nga çdo lloj abuzimi dhe eksploatimi seksual, ndërkaq duke i marrë parasysh denoncimet gjithnjë e më të shpeshta të veprave të këtilla mbi fëmijët, Republika e Maqedonisë bëri ndryshime të Kodit Penal, me çka në mënyrë të konsiderueshme i ashpërsoi dënimet të cilat kanë të bëjnë me këto vepra penale të kryera mbi persona të mitur, përkatësisht dyfish u rritën dënimet dhe u parashikuan dënime me burgim prej 8 dhe 10 vjet dhe deri në burgim të përjetshëm.

Po ashtu, për shkak të mbrojtjes preventive të fëmijëve, të cilët janë në rrezik për t'u bërë viktima ose kryerës të veprave penale, po edhe viktima të abuzimit seksual, me **Ligjin për të drejtat e të miturve** janë paraparë më tepër masa për ndihmë dhe mbrojtje, ndërkaq edhe mekanizmat të cilët duhet të kontribuojnë për veprim parandalues, siç është formimi i Këshillit Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së të Miturve.

Me Ligjin për të drejtat e të miturve, si objektiva kryesorë parashikohet realizimi i interesave me prioritet dhe mbrojtja e të miturve nga krimi, dhuna dhe cila do qoftë formë e rrezikimit të lirive dhe të drejtave të tyre dhe zhvillimi i tyre i drejt, mbrojtja e kryerësve të mitur të veprave penale dhe socializimi i tyre, edukimi dhe riedukimi, ndihma dhe kujdesi dhe mbrojtja në procedurat para gjykatave dhe organeve tjera (Neni 2). Nga masat dhe sanksionet e parashikuara me këtë Ligj, përherë u jepet përparësi masave parandaluese, mbrojtëse dhe edukative (neni 7, paragrafi 1), ndërsa sanksionet që përfshijnë privimin nga liria zbatohen vetëm në raste të jashtëzakonshme, si mjet i fundit, nëse ndryshe nuk mund të realizohet qëllimi i masave për veprën e kryer penale (neni 7, paragrafi 2). Gjithashtu, me qëllim të mbrojtjes së interesit më të mirë të fëmijës, me këtë Ligj është parashikuar

se sipas rregullit nuk zhvillohet procedurë gjyqësore për vepër të kryer penale nga i mituri, në mënyrë që të shmanget ndikimi i dëmshëm mbi të miturin, përveç nëse karakteristikat e të miturit dhe rrethanat nën të cilat është kryer vepra nuk çojnë drejt nevojës për procedurë gjyqësore, me ç'rast procedura gjyqësore zhvillohet vetëm në raste të përcaktuara me këtë Ligj (neni 9). Nëse kryerësi i veprës penale është person i cili, në kohën kur e ka kryer veprën nuk i ka pas mbushur 14 vjet dhe i cili trajtohet si fëmijë në rrezik, nuk ndërmerren sanksione por masa për ndihmë dhe mbrojtje edhe atë nga fusha e arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes sociale, familjare dhe forma të tjera të mbrojtjes (neni 13, 14, 16). Përndryshe, si fëmijë në rrezik, sipas këtij Ligji, trajtohen personat e mitur të cilët në kohën e kryerjes së veprës kanë mbushur 7 vjet, e nuk i kanë mbushur 14 vjet, si dhe fëmijët deri në moshën 14 vjeç të cilët janë vartës nga droga ose alkooli, fëmijët me pengesa në zhvillim, fëmijët-viktima të dhunës, fëmijët e braktisur në aspekt edukues, dhe social ose fëmijët të cilët për këtë shkak nuk janë përfshirë në arsim ose i janë dhënë lypjes, bredhjes ose prostitucionit, si dhe fëmijët-viktima të dhunës (neni 12). Me Ligjin është përcaktuar trajtim i posaçëm me fëmijët në rrezik, me ç'rast rolin kryesor e kanë qendrat për punë sociale dhe së këtejmi **me tekstin fillestar të Ligjit u parashikua edhe obligimi për ndihmë juridike falas nga avokati në të gjitha procedurat ndaj të miturve**. Me ndryshimet e Ligjit shpenzimet e avokatit i bart familja, përveç nëse është rast social dhe nëse dëshmon se nuk ka mundësi t'i bart shpenzimet, atëherë ndihma juridike nga avokati bëhet falas, përkatësisht shpenzimet bien mbi barrë të institucionin përkatës i cili vepron edhe atë sipas tarifës së avokatisë, të zvogëluar për 30 për qind.

Në kontekst të masave parandaluese dhe mbrojtëse do t'i përmendim dispozitat e **Ligjit mbi mbrojtjen e fëmijëve** me të cilin rregullohet sistemi, organizimi dhe mënyra e sigurimit të mbrojtjes së fëmijëve. Por, përcaktimi i objektivit të këtyre ambicioz të Ligjit nuk është përmbushur edhe atë për shkak se pjesa më e madhe e dispozitave të këtij Ligji i përkushtohet rregullimit të të drejtave sociale të fëmijëve dhe institucioneve nga fusha e mbrojtjes sociale dhe të drejtave dhe obligimeve të tyre. Nga aspekti i mbrojtjes së fëmijëve nga abuzimi seksual vetëm në nenin 9 të Ligjit, mes tjerash, ndalohen: "të gjitha format e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual të fëmijëve (pornografia e fëmijëve, prostitucioni i fëmijëve), manipulimi me dhunë, shitja ose trafikimi me fëmijë, dhuna psikike ose fizike dhe keqtrajtimi, ndëshkimi ose trajtime tjera jonjerëzore, të gjitha llojet e eksploatimit, shfrytëzimit komercial dhe keqpërdorimit të fëmijëve, me të cilat shkelen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe të drejtat e fëmijës". Megjithatë, më tej, këto ndalime dhe masat eventuale për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga keqpërdorimi, nuk i trajton Ligji i cekur. Edhe pse paraqet obligim për të gjitha institucionet e sistemit t'i ndërmarrin të gjitha masat e mbrojtjes së fëmijëve nga keqpërdorimi, me këtë Ligj special për të drejtat e fëmijëve nuk janë parashikuar mekanizmat specifikë të cilët do të siguronin veprim parandalues dhe mbrojtje të fëmijëve.

Më tej, në **Ligjin për familjen** parashikohet mbrojtja preventive dhe represive e të drejtave dhe interesave të fëmijës përmes së drejtës dhe obligimit të qendrave për punë sociale të kryejnë mbikëqyrje mbi të drejtën prindërore dhe gjithmonë kur kanë informata se mungon edukimi dhe zhvillimi i fëmijës ose kur fëmija neglizhohet ose keqpërdoret nga prindërit, të ndërmarrin masa për ndihmë dhe këshillimin e prindërve, por edhe sanksione kundër prindërve tek të cilët nuk kanë ndihmuar masat parandaluese, përkatësisht përkohësisht ta marrin fëmijë nga njëri ose të dy prindërit ose ta kufizojnë të drejtën e kontakteve personale mes fëmijës dhe njërit ose prindit tjetër, si dhe të hapin procedurë për heqjen e të drejtës prindërore ose procedurë penale për vepër të caktuar penale (neglizhencë, keqpërdorim dhe ngjashëm).

Me këtë Ligj janë përcaktuar bazat për heqjen e të drejtës prindërore, përkatësisht keqpërdorimin e të drejtës prindërore dhe neglizhencës së vrazhdë gjatë kryerjes së detyrës prindërore. Si dukuri dhe veprime të këtyra trajtohet: keqtrajtimi ose neglizhenca ndaj fëmijës, dhuna fizike ose emocionale mbi fëmijën, shfrytëzimi seksual, detyrimi i fëmijës për të punuar punë joadekuate për moshën e tij, lejimi i fëmijës të përdor alkool, drogë ose substanca tjera psikotrope, manipulimi i fëmijës për të kryer vepra sociopatologjike dhe të

papranueshme në shoqëri, braktisja e fëmijës për një periudhë më të gjatë se tre muaj ose cila do qoftë mënyrë me të cilën shkelen të drejtat e fëmijës (neni 90).

Gjithashtu, me këtë Ligj është parashikuar mbrojtja preventive, represive dhe rehabilituese e fëmijëve nga dhuna në familje, me ç'rast ndalohet çdo lloj dhune në mesin e anëtarëve të familjes pa marrë parasysh moshën, ndërkaq si dhunë në familje, veç tjerash, nënkuptohet edhe rrezikimi i sigurisë, lëndimit trupor, dhunës seksuale, psikologjike ose fizike, me të cilën shkaktohet ndjesia e pasigurisë ose frikës - Kapitull i veçantë VI-A me 12 nene të reja (94b - 94j). Mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna në familje, para së gjithash e sigurojnë qendrat për punë sociale. Qendrat, mund të ndërmerren veprime sipas informatave ose sipas kallëzimit të policisë dhe denoncimit të institucioneve shëndetësore dhe arsimore, prindërit, fqinjët, por mekanizmat për bashkëpunim gjatë veprimit në raste konkrete nuk janë rregulluar me Ligj dhe për këtë arsye është miratuar Protokoll i veçantë. Qendrat mund të sigurojnë mbrojtje përkatëse shëndetësore, ndihmë psiko-sociale, mjekim, t'i vendosin viktimat në strehimore, t'i ndihmojnë fëmijës që ta vazhdojë me rregull arsimin, t'i informojnë institucionet përkatëse për ndjekje dhe të japin ndihmë juridike, si dhe t'i përfaqësojnë para gjykatës. Gjithashtu, qendrat gjithnjë kur një gjë të tillë nuk e bëjnë prindërit, paraqesin propozim pranë gjykatës për shqiptimin e masës së përkohshme. Gjykata mund të shqiptojë më tepër masa të përkohshme, mes të cilave t'ia ndalojë kryerësit të kërcënohet se do të kryejë dhunë në familje, t'ia ndalojë të kryejë keqtrajtim dhe shqetësim të më-tutjeshëm, kontaktim ose komunikim në mënyrë tjetër me anëtar të familjes, t'ia ndalojë kryerësit të afrohet pranë vendbanimit të viktimës, pranë shkollës ku mëson fëmija, të urdhërojë mjekim të detyrueshëm nëse ka nevojë për këtë, ta mbajë familjen dhe ta largojë kryerësin nga shtëpia pa marrë parasysh pronësinë, deri në miratimin e vendimit të formës së prerë nga gjykata, si dha ta dërgojë kryerësin të vizitohet këshillimore.

Qendra për punë sociale gjithnjë kur ka informata se ekziston dhunë në familje mbi fëmijë të mitur ose person me aftësi të kufizuar ose persona të paaftë për punë, ndërmerren masa për mbrojtje. Informatat, qendra për punë sociale i merr nga qytetarë, persona zyrtarë dhe juridikë, të cilët e kanë për detyrë që pa prolongim ta njoftojnë qendrën me informatat e këtyra.

Sipas Konventës, sidomos duhet të ndërmerren masa për largimin e kryerësit të mundshëm, ndërsa fëmija-viktima mund të largohet nga rrethi familjar nëse prindërit janë të involvuar në keqpërdorimin e fëmijës, kjo masë ndërmerret vetëm nëse një gjë e tillë është në interesin më të mirë të fëmijës, (Neni 14 i Konventës), ndërkohë që është e nevojshme të ndërmerren edhe masa për shmangien e rrethëve dhe risqeve të cilët mund të çojnë deri në përsëritjen e veprës (Neni 15 i Konventës).

Megjithatë, edhe pse me Ligjin për familjen, si një nga masat e përkohshme të cilat mund t'i shqiptojë gjykata është largimi i kryerësit nga shtëpia dhe dërgimi i tij në këshillimore këto dy masa, të cilat janë mjaft të rëndësishme sidomos për fëmijët-viktima të dhunës në familje, **në praktikë akoma nuk aplikohen sa duhet, me ç'rast më së shpeshti nga shtëpia largohet nëna bashkë me fëmijën të cilët në të shumtën e rasteve janë viktimat, e jo kryerësi, me çka fëmija përjeton trauma plotësuese,** ndërkohë që edhe më tej nuk janë hapur dhe nuk punojnë numër i mjaftueshëm i këshillimoreve për kryerësit e dhunës në familje në mënyrë që ta përmirësojnë sjelljen e tyre dhe kur të kthehen në familje të mos ushtrojnë përsëri dhunë mbi fëmijën ose anëtarë të tjetër të familjes.

Kodi Penal i RM-së dhe Ligji për familjen

Konform këtyre dispozitave të Konventës me Kodin Penal janë inkriminuar të gjitha llojet e përmendura të abuzimit seksual dhe shfrytëzimit të fëmijëve dhe, siç u cek më lart janë parashikuar edhe dënime mjaft të larta.

Gjithashtu, me qëllim të mbrojtjes së fëmijëve-viktima të trafikimit me njerëz, të



cilët më së shpeshti shfrytëzohen për shërbime seksuale, në **Ligjin për familjen** është përcaktuar Kapitulli për mbrojtjen e fëmijëve-viktima të trafikimit me njerëz.

Përkatesisht, me Ligj është përcaktuar se fëmijë-viktimë e trafikimit me njerëz është person i mitur deri në moshën 18 vjeç, i cili me ose pa pëlqimin e tij, në çfarë do qoftë mënyrë është shndërruar në viktimë të trafikimit me njerëz për qëllime eksploatimi. Së këtejmi, Ligji përcakton më tepër masa të cilat detyrimisht duhet t'i ndërmerren qendra për punë sociale, në mesin e të cilave: fëmijës t'i sigurohet kujdestar i trajnuar, bashkëpunimi me Ministrinë për Punë të Brendshme, prokurorin publik, kujdestarin, familjen, prindërit dhe organet e institucionet e tjera, të bëjë vlerësimin e përshtatshmërisë së familjes, ta monitorojë sjelljen e fëmijës, t'i ofrojë ndihmë profesionale familjes dhe fëmijës. Kur qendra ka informata se ekziston rreziku nga përfshirja e fëmijës në trafikimin me njerëz ose në një lloj tjetër të eksploatimit, derisa gjendet në familje, sipas detyrës zyrtare, duhet të miratojë aktvendim për kryerjen e mbikëqyrjes mbi të drejtën prindërore, ndërsa kur fëmija tanimë është bërë viktimë dhe duhet të kthehet në familje, qendra duhet të miratojë aktvendim për monitorim të përforcuar mbi ushtrimin e të drejtës prindërore me qëllim të parandalimit, pengimit, mbrojtjes dhe rehabilitimit të fëmijës. Ndërkaq, nëse prindërit kanë marrë pjesë në përfshirjen e fëmijës në trafikimin me njerëz, qendra e merr fëmijën nga prindërit dhe ia beson në ruajtje ose prindit tjetër, personit tjetër ose e vendos në institucion, dhe njëkohësisht në procedurë gjyqësore prindit mund t'i hiqet e drejta prindërore. Ndihej drejtuar fëmijës-viktimë të trafikimit me njerëz dhe familjes i ofrohet pa marrë parasysh: fenë, racën, gjininë, prejardhjen sociale, gjuhën, religjionin, aftësinë psikike ose fizike, orientimin seksual, moshën etj. Dhe, këto masa duhet t'i përshtaten moshën së fëmijës dhe pjekurisë së tij dhe të jenë në interesin e tij më të mirë.

Nisur nga fakti se njëra nga të drejtat themelore të fëmijëve është e drejta e pjesëmarrjes së tyre në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me ta, gjithsesi varësisht nga mosha dhe pjekuria, gjatë sigurimit të mbrojtjes së fëmijëve-viktima të trafikimit, përveç që duhet të mbahet llogari para së gjithash për interesin më të mirë të tyre, ata duhet të marrin pjesë aktive gjatë përcaktimit dhe marrjes së masave për ndihmë dhe mbrojtje. Në mënyrë që fëmija të mund ta shfaq mendimin e vet dhe në mënyrë aktive të marrë pjesë në marrjen e të gjitha masave të domosdoshme duhet të jetë i informuar dhe i njoftuar me të drejtat të cilat i takojnë si dhe me mënyrat se si mund t'i realizojë dhe mbrojtje ato të drejta.

Njëkohësisht, në përputhje me Konventën, në mënyrë që të parandalohen dhe të pengohen dukuritë e këtilla, është e domosdoshme edhe ngritja e vetëdijes publike për fenomenin e eksploatimit seksual dhe abuzimit seksual të fëmijëve dhe për masat parandaluese (Neni 8 i Konventës). Gjithashtu, me qëllim të parandalimit dhe pengimit të dukurive të këtilla, është i domosdoshëm trajnimi i fëmijëve me të drejtat e tyre dhe aftësimi i fëmijëve me dije dhe shkathtësi për t'i detektuar të drejtat, ndërsa në veçanti cenimet e këtyre të drejtave dhe të fitojnë informata të mjaftueshme për rreziqet nga eksploatimi seksual dhe abuzimi seksual, në mënyrë që të mund të vetëmbrohen, por edhe të informohen se ku dhe si mund të kërkojnë ndihmë dhe mbrojtje, si dhe nga cilat keqpërdorime duhet të mbrohen, veçanërisht për rreziqet të cilat përfshijnë shfrytëzimin e teknologjive të reja informatike dhe komunikuese, të cilat shpeshherë kontribuojnë në keqpërdorimin e fëmijëve (Neni 6 i Konventës)

Edhe përkundër obligimit të përgjithshëm ligjor, për ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve për parandalim social, për shkak të mbingarkimit të qendrave për punë sociale me administrimin e kompensimeve në para dhe ofrimin e llojeve tjera të shërbimeve sociale, pa arsye neglizhohet puna parandaluese dhe kjo lë pasoja të pariparueshme, sidomos tek fëmijëve në rrezik dhe fëmijët-viktima. Shkak për gjendjen e këtillë është edhe mungesa e vazhdueshme e kuadrit profesional dhe mjeteve për aktivitete parandaluese të qendrave, për të realizuar programe preventive.

Në numrin më të madh të qendrave, shpërfillet puna parandaluese dhe edukativo-këshilluese dhe kjo ndodh si rezultat i obligimeve tjera, edhe pse kohëve të fundit vihet re se për shkak të divorceve të shpeshta, marrëdhënieve konfliktuale të prindërve, të cilat më

së shumti i ndjejnë fëmijët, si dhe denoncimeve gjithnjë e më të shpeshta të dhunës në familje dhe llojeve tjera të dhunës e abuzimeve të fëmijëve, qendrat gjithnjë e më shpesh e zbatojnë këtë metodë të punës, por nuk ka në të gjitha qendrat persona të trajnuar profesionistë, të cilët do ta kryenin punën konsulente dhe këshillimore për familjet dhe fëmijët. Zhvillimi i dobët i punës parandaluese sociale i referohet mosekzistimit të protokolleve për bashkëpunim midis institucioneve relevante në nivel lokal. Përkatësisht, **Ligji për mbrojtje sociale** parashikon që puna parandaluese të realizohet në qendrat për punë sociale, në bashkëpunim me komunat, institucionet parashkollë, shkollat, institucionet shëndetësore dhe organet e tjera shtetërore, personat juridikë dhe fizikë dhe shoqatat civile, si në nivel qendror ashtu edhe në nivel lokal. Numri më i madh i njësive të pushtetit lokal nuk kanë në dispozicion kapacitete për detektimin e problemeve themelore sociale nëpër komunat e tyre dhe ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve efikase. Në sistematizimin e një numri të madh të administratave komunale nuk parashikohet formimi i sektorëve, e as seksioneve për mbrojtje sociale. Pjesa më e madhe e komunave nuk kanë të punësuar asnjë punonjës social.

Gjithashtu, në realizimin e punës parandaluese, thelbësor është bashkëpunimi midis qendrave dhe shkollave, me ç'rast si raste pozitive janë ndryshimet e ligjeve për arsim fillor dhe të mesëm me të cilët parashikohet që, për fëmijët të cilët janë problematikë në shkollë, të zbatohen këshillime të prindërve në shkolla, për çka nevojitet edhe përforsim i shërbi- meve pedagogjike-psikologjike nëpër shkolla, ndërkohë që është paraparë edhe obligimi që, kur shkolla nuk arrin ta tejkalojë problemin, ta informojë qendrën për punë sociale. Njëherësh, parashikohet punësimi i punonjësit social nëpër shkolla, por kjo dispozitë, për shkak të mungesës së mjeteve materiale, nuk është implementuar.

Po ashtu, një numër i madh i institucioneve shëndetësore, sidomos në komunat më të vogla, nuk kanë në dispozicion kuadër profesional për ta kryer parandalimin social dhe shëndetësor. E gjithë kjo i redukton potencialet e komunave për kryerjen e punës parandaluese sociale. Progres simbolik vërehet tek bashkëpunimi i qendrave dhe policisë, veçanërisht me miratimin e Ligjit për të drejtat e të miturve, i cili parashikon formimin e Këshillit Shtetëror dhe këshillave komunal për parandalimin e delikuencës tek të miturit, mirëpo Këshilli Shtetëror është formuar dhe funksionon tanimë dy vjet, ndërkaq komunat edhe pse e kanë obligim ligjor, vetëm disa prej tyre kanë filluar me formimin e këshillave komunal për parandalimin e delikuencës tek të rinjtë.

Gjithashtu, me Ligjin për arsim fillor dhe Ligjin për arsim të mesëm ndalohet keqtrajtimi i nxënësve nëpër shkolla, por pa përpunim të mëtutjeshëm, ndërkohë që janë paraparë dënime për kundërvajtje për mësimdhënësit të cilët ushtrojnë dhunë por edhe për shkollën, gjithashtu këto dënime shqiptohen rrallë.

Me këto ligje, janë përcaktuar objektivat kryesore të arsimit, me ç'rast çdo fëmijë ka të drejtë, por edhe obligim për arsim fillor dhe të mesëm, ndalohet diskriminimi mbi çfarë do qoftë baze, fitohen njohuri të cilat janë të zbatueshme në jetën e përditshme ose nevojiten për arsimimin e mëtutjeshëm dhe zhvillohet vetëbesimi dhe vetëdija tek fëmijët për individualitetin personal, por edhe për përgjegjësi për veprimet e tyre, fëmijët edukohen për tolerancë dhe respektim të ndërsjellë të të drejtave dhe lirive.

Roli i sistemit arsimor në procesin e parandalimit dhe zbulimit të abuzimit dhe eksploatimit seksual të fëmijëve

Për shkak të kohës, të cilën fëmija e kalon në shkollë ose në institucion parashkollor dhe kontakteve të shpeshta me familjen, mundësia e sistemit arsimor në parandalimin dhe zbulimin e hershëm të rasteve të abuzimit seksual është e madhe. Sistemi arsimor, në masë të madhe u ndihmon prindërve, sa i përket edukimit dhe rritjes së fëmijëve, gjë që paraqet aktivitet të rëndësishëm parandalues, të cilin e ka në dispozicion sistemi arsimor. Ligjëratat për nxënësit dhe prindërit, të cilat kanë të bëjnë me identifikimin dhe zbulimin e çdo forme



të abuzimit seksual dhe eksploatimit seksual të fëmijëve, do të kontribuojnë për sensibilizim më të madh në lidhje me fenomenin e abuzimit dhe eksploatimit seksual.

Ekipet psikologjike-pedagogjike në shkolla kanë në dispozicion më tepër mundësi të cilat janë në funksion të parandalimit, duke filluar nga realizimi i programeve të caktuara të dedikuara për fëmijët, punën me kuadrin mësimdhënës, përgatitjen dhe botimin e materialeve dhe broshurave përkatëse për abuzimin seksual, përmes këshillimeve dhe dhënies ndihmë prindërve në procesin e edukimit të fëmijëve, punës individuale me fëmijët e familjeve problematike dhe deri në orientimin dhe ridërgimin e fëmijëve dhe familjeve në institucione tjera kompetente (qendra për punë sociale, institucione shëndetësore, polici dhe institucione tjera relevante), me qëllim të sigurimit të ndihmës për të cilën kanë nevojë fëmijët dhe familja.

Mundësia për parandalimin dhe zbulimin e hershëm të rasteve të abuzimit seksual të fëmijëve, nga ana e kuadrin edukativo-arsimor në institucionet parashkollore dhe shkollore, është mjaft e madhe por edhe mësimdhënësit dhe edukatorët duhet të jenë më të ndjeshëm, të aftë, të ditur dhe të shkathët për t'i vërejtur ndryshimet në sjelljen e fëmijës (lënia pas dore e mësimin, dobësimi i përqendrimit gjatë orës së mësimin, rritja e nivelit të agresivitetit ose simptoma tjerë). Këto sinjale dhe simptoma do të duhej të ishin shkas që mësimdhënësit dhe edukatorët të kenë kujdes për atë fëmijë dhe në bashkëpunim me ekipet psikologjike-pedagogjike të provojnë t'i zbulojnë shkaqet e sjelljes së këtyllë të fëmijës, si dhe të ndër-marrin masa të mëtutjeshme për pengimin e keqpërdorimit eventual të fëmijës, si dhe masa për ndihmë dhe mbrojtje. Njëkohësisht, për mbrojtje më të madhe nga abuzimi i këtyllë i fëmijëve nevojitet ngritja e vetëdijes tek fëmijët për rreziqet nga mjedisi i drejtpërdrejt, si dhe pajisja e tij me dije dhe shkathtësi për t'i identifikuar shkeljet dhe për t'u vetëmbrojtur. Kjo e imponon nevojën për përfshirjen në plan-programin mësimor të përmbajtjeve për të drejtat e fëmijës, edukimin me shkathtësi të jetësore për identifikimin e kërcënimeve të mundshme, për shkeljen dhe keqpërdorimin e të drejtave të tyre, si dhe për mekanizmat për ndihmë dhe mbrojtje.

Roli i sistemit shëndetësor në procesin e parandalimit dhe zbulimit të abuzimit dhe eksploatimit seksual të fëmijëve

Sistemi shëndetësor, përkatësisht punonjësit shëndetësorë luajnë rol të rëndësishëm dhe specifik në të gjitha fazat e mbrojtjes së fëmijëve nga abuzimi dhe eksploatimi seksual, si në aspekt të parandalimit, zbulimit dhe diagnostifikimit e deri në trajtimin, ndjekjen e rastit dhe evaluimin.

Institucionet e sistemit shëndetësor kanë mundësi ta njoftojnë publikun e gjerë me problemet dhe nevojën e parandalimit të abuzimit seksual të fëmijëve përmes: organizimit të tribunave publike, ligjëratave dhe seminareve për personat profesionistë të shkollave, qendrave për punë sociale, policia, organeve të jurisprudencës dhe ngjashëm ose për publikun më të gjerë. Së këtejmi, këto tribuna do të orientoheshin në kontekst të informimit për shtrirjen e abuzimit seksual, llojet, shenjat dhe pasojat nga abuzimi seksual, si dhe botimin e publikimeve, fletëpalosjeve etj.



MBROJTJA E FËMIJËVE-VIKTIMA NGA INFORMATAT E DËMSHME PËR ZHVILLIMIN E TYRE DHE TË CILAT KRYEJNË VIKTIMIZIM PLOTËSUES TË VIKTIMËS

Në pjesën e përforcimit të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, nevojitet mbrojtja e identitetit të të gjithë atyre të cilët rastësisht janë ndodhur aty dhe janë bërë viktime të eksploatimit seksual dhe abuzimit seksual. Në këtë kuptim, duhet të mbrohet privatësia dhe të mos publikohen informata për fëmijën-viktimë ose për kryerësin e veprës penale me të cilat do të preket privatësia e tyre, reputacioni, nderi, dinjiteti dhe viktimizimi plotësues.

Përkatësisht, në përputhje me Konventën, duhet të ndërmerren të gjitha masat e domosdoshme për mbrojtjen e fëmijës nga informatat dhe materialet, të cilat i reklamojnë veprat e këtilla, me ç'rast veçanërisht mjetet e informimit publik duhet të japin informata përkatëse në lidhje me këtë fenomen (Neni 9 i Konventës).

Në kontekst të kësaj, konform **Ligjit për të drejtat e të miturve**, gjykatat dhe organet, të cilat marrin pjesë në procedurë, e kanë për detyrë ta sigurojnë privatësinë e personit të mitur dhe familjen e tij, ndërsa kur gjykohet i mituri gjithmonë përjashtohet publiku.

Po ashtu, mbrojtje e veçantë e fëmijëve, nga informatat e dëmshme për zhvillimin psikofizik të tyre, sidomos përmes mediave elektronike, është parashikuar me **Ligjin për veprimtari radiodifuzive**.

Sipas dispozitave të këtij Ligji (neni 70) programet e radiodifuzerëve nuk guxojnë të përmbajnë pornografi, dhunë të tepërt ose programe tjera të cilat mund ta rrezikojnë seriozisht zhvillimin fizik, psikologjik dhe moral të fëmijëve dhe të rinjve. Dhunë të tepërt paraqet përhapja e mesazheve tekstuale, verbale dhe vizuale me të cilat, programet transmetohen në kohën kur janë të arritshme për të miturit, glorifikohen format fizike, psikologjike të sadizmit ose lloje tjera të ngjashme të dhunës e që në asnjë mënyrë nuk mund të arsyetohen as përmes kontekstit të zhanrit, e as përmes motiveve të veprimit dramatik të transmetimit të programit. Serviset programore me përmbajtje pornografike, rrjetet publike komunikuese mund t'i transmetojnë vetëm në formë të koduar. Më tej, sipas këtij Ligji, përmbajtjet programe të cilat mund ta rrezikojnë zhvillimin fizik, psikologjik dhe moral të fëmijëve dhe të rinjve mund të emitohet vetëm gjatë periudhës kohore nga ora 24:00 deri në ora 05:00. Këto programe duhet të mbajnë shenjën përkatëse para fillimit të transmetimit të tyre, me paralajmërim vizual dhe akustik se nuk rekomandohen për kategori të caktuara të publikut.

NDALIM PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT QË KA LIDHJE ME FËMIJË, PËR KRYERËSIT E VEPRAVE PENALE TË CILAT KANË TË BËJNË ME ABUZIMIN SEKSUAL DHE EKSPLOATIMIN SEKSUAL TË FËMIJËVE

Në nenin 5 të Konventës të Këshillit të Evropës parashikohet gjetja e mekanizmave me të cilët personat, të cilët janë dënuar për abuzim seksual dhe eksploatim seksual të fëmijëve, pasi të jenë dënuar, të mos kenë qasje në kryerjen e profesioneve në të cilat vihen në kontakt me fëmijë.

Sipas **Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë** gjykata mundet, kryerësit të cilit i ka shqiptuar dënim me burgim ose dënim me kusht, me të cilin është përcaktuar dënimi me burgim, t'ia ndalojë ushtrimin e profesionit ose veprimtarinë e caktuar ose detyrën apo punën që ka të bëjë me veprën penale. Kohëzgjatja e ndalimit nuk mund të jetë më e shkurtër se një vit e as më e gjatë se dhjetë vjet. Kështu, për vepër penale "Sulm seksual mbi fëmijë" parashikohet që nëse veprimi seksual mbi të miturin, i cili nuk ka mbushur



moshën 14 vjeç, është kryer nga farefisi ose vëllai, përkatësisht motra, mësimdhënësi, edukatori, adoptuesi, kujdestari, mjeku ose person tjetër me keqpërdorimin e pozitës së tij, përveç dënimit me burgim i shqiptohet edhe ndalimi për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës. Gjithashtu, ndalimi i këtillë është paraparë edhe për kryerësin e veprës penale "Akt seksual me keqpërdorim të pozitës".

Me ligjet për arsim fillor dhe të mesëm për ushtrimin e keqtrajtimit fizik dhe psikik të nxënësit parashikohet gjobë për shkollën dhe mësimdhënësin për kundërvajtje të kryer, e cila mund të arrijë shumën nga 1500 euro për mësimdhënësin dhe prej 3500 deri më 4000 euro për shkollën por, për këtë veprim, në këto ligje nuk është paraparë ndalimi për ushtrimin e veprimtarisë, edhe pse vlerësojmë se për mësimdhënësin, i cili kryen shpesh çfarëdo qoftë dhune mbi fëmijët duhet të parashikohet një ndalim i tillë, për çka Avokati i Popullit disa herë ka dhënë propozim pranë organeve kompetente.

FINANCIMI DHE KRIJIMI I FONDEVE PËR PARANDALIM DHE MBROJTJE

Secila palë kontraktuese do të sigurojë financim, aty ku është i mundur krijimi i fondeve, për projekte dhe programe të realizuara nga shoqëria civile, qëllimi i të cilave është parandalimi dhe mbrojtja e fëmijëve nga eksploatimi seksual dhe abuzimi seksual (Neni 9, pika 4 e Konventës).

Në **Ligjin për të drejtën e të miturve**, në tekstin e tij fillestar, ishte parashikuar që, me qëllim të dëmshpërblimit të të miturit i cili është viktimë ose është i dëmtuar me vepra penale të dhunës dhe të akteve tjera të dhunës individuale ose grupore, të formohet fond për dëmshpërblim edhe atë në shumë prej 2% nga mjetet e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë që grumbullohen nga shqiptimi i dënimeve me para nga ana e gjykatave për vepra penale ose kundërvajtje, të arkëtuara nga viti paraprak. Kjo zgjidhje ligjore u pranua në kontekst të gjerë dhe u vlerësua si përfitim mjaft pozitiv për mbrojtjen dhe rehabilitimin e fëmijëve-viktima. Megjithatë, me ndryshimet e kryera (në vitin 2010) ky fond u ndërpre dhe u parashikua që për këtë dedikim të ndahen mjete në kuadër të Buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë për shfrytëzimin e të cilave Ministria, sipas mendimit paraprak të Këshillit Shtetëror për Parandalim të Delikuencës tek të Miturit, miraton program me të cilin i planifikon mjetet. Por, edhe këto dispozita ligjore akoma nuk implementohen në praktikë, përkatësisht nuk është miratuar programi nga Ministria e Drejtësisë, si dhe nuk është kërkuar paraprakisht mendimi nga Këshillit Shtetëror për Parandalim të Delikuencës tek të Miturit.

Me **Ligjin për mbrojtje sociale** parashikohet mundësia që shoqatat civile të kryejnë punë të mbrojtjes sociale nëse janë regjistruar për kryerjen e veprimtarive të këtilla. Qëllimet kryesore që duhet t'i arrijnë këto shoqata janë parandalimi social, zhvillimi dhe sigurimi i shërbimeve të mbrojtjes sociale të personave, familjeve, grupeve të qytetarëve të ekspozuar në rrezik social, zhvillimi dhe avancimi i mbrojtjes sociale (neni 152). Këto shoqata, në mënyrë dhe nën kushte të përcaktuara me ligj, gjithashtu, mund të realizojnë hulumtime të dukurive sociale, parandalim social, edukim, këshillim dhe përgatitje profesionale për personat e ekspozuar në rrezik social, të japin shërbime sociale, të kryejnë përkujdes shtëpiak, praniam ditor të kohëpaskohshëm të shfrytëzuesve të caktuar, të sigurojnë kushte për jetë të pavarur dhe të ndërmarrin masa për mbrojtjen e personave viktimë të dhunës në familje.

Me **Ligjin për familjen** parashikohet mundësia që shoqatat qytetare, të regjistruara për realizimin e qëllimeve dhe detyrave nga fusha e mbrojtjes sociale, vet ose në bashkëpunim me qendrën për punë sociale, të mund të ndërmarrin masa të caktuara për mbrojtje, siç përcaktohet me Ligj. Shoqata qytetare e ka për detyrë që për masat e ndërmarra, brenda 24 orësh, ta njoftojë qendrën për punë sociale, kompetente sipas vendit të jetesës të personit viktimë e dhunës në familje.



Qendra për punë sociale, pas marrjes së njoftimit, brenda 24 orësh, përgatitë zgjidhje përkatëse. Shoqata qytetare e ka për detyrë që, brenda 72 orësh, pasi të jenë ndërmarrë masat për mbrojtje, dokumentacionin e plotë t'ia dërgojë qendrës për punë sociale, me qëllim të veprimit të mëtutjeshëm të saj. Këto dispozita ligjore janë implementuar në praktikë sepse shoqata të caktuara civile kanë autorizim për të përkujdesur viktimat të dhunës në familje, fëmijë në rrugë ose kategori tjera të fëmijëve-viktima të dhunës në familje, siç janë fëmijët-viktima të trafikimit me njerëz.

MASA PËR BASHKËPJESËMARRJE DHE TENTATIVË PËR KRYERJEN E VEPRAVE TË CILAT KANË TË BËJNË ME ABUZIMIN SEKSUAL DHE EKSPLOATIMIN SEKSUAL

Sipas Konventës është i domosdoshëm inkriminimi dhe ndërmarrja e masave për veprime të kryera me dashje, ndihmë ose bashkëpjesëmarrje në kryerjen e veprave të cekura penale, si dhe masa të tjera ligjore për tentativë për kryerjen e veprave të cekura penale (Neni 24 e Konventës).

Sipas **Kodit Penal** kryerësi i cili me dashje do të fillojë kryerjen e veprës penale, por nuk do ta përfundojë, do të dënohet për tentativë për vepër penale për të cilën sipas Ligjit mund të shqiptohet dënimi me burgim prej pesë vjet ose dënimi më i rëndë, ndërsa për tentativë për vepër tjetër penale vetëm kur ligji, në mënyrë eksplicite, përcakton dënimi për tentativë. Nisur nga kjo, duke e marrë parasysh faktin se për pjesën më të madhe të veprave penale, të cilat kanë të bëjnë me abuzimin seksual dhe eksploatimin seksual të fëmijëve, janë parashikuar dënime më të larta se pesë vjet, ekziston mundësi ligjore edhe për dënimin për tentativë, përveç në raste të jashtëzakonshme të përcaktuara me Ligj kur bëhet fjalë për tentativë të papërshtatshme ose heqje dorë vullnetarisht (Neni 19, 20 dhe 21 i Kodit Penal).

Njëherësh, me **Kodin Penal** parashikohet edhe dënimi për bashkëpjesëmarrje në vepër penale, me ç'rast nëse më tepër persona, me pjesëmarrje në veprim për kryerje të veprës ose kontribut tjetër personal për kryerjen e veprës, e kryejnë bashkë veprën penale, secili nga këta persona do të dënohet me dënimi të paraparë për atë vepër (Neni 22 i Kodit Penal).

RRETHANA RËNDUESE

Sipas Konventës duhet të ndërmerren të gjitha masat ligjore dhe masat tjera për elemente të cilët konsiderohen si rrethana rënduese në përcaktimin e sanksioneve për vepra penale të parapara me Konventë (Neni 28 i Konventës).

Në mënyrë që të pengohen dukuritë e këtilla, të cilat janë inkriminuar në kornizën ligjore, është e domosdoshme të parashikohen edhe sanksione dhe dënime përkatëse efektive për kryerësit të cilët do të heqin dorë nga kryerja e veprave të këtilla (Neni 27 i Konventës), ndërkaq në rastet kur ekzistojnë rrethana rënduese të parashikohen dënime përkatëse më rigorozë, veçanërisht nëse me veprën janë shkaktuar lëndime të rënda mbi shëndetin fizik dhe psikik të viktimës, nëse viktimat i përket kategorisë të vulnerabile të fëmijëve, nëse vepra është kryer nga anëtarë i familjes ose person i afërm, i cili e ka keqpërdorur autoritetin e tij, nëse vepra

**është kryer nga më tepër persona, nëse kryerësi ka qenë i dënuar për vepra të natyrës së njëjtë (Neni 28 i Konventës).**

Në kontekst të këtyre dispozitave të Konventës, ndërkaq për shkak të dukurive gjithnjë e më të shpeshta të veprave penale që kanë të bëjnë me abuzimin seksual dhe eksploitim seksual të fëmijëve, në legjislacionin e Republikës së Maqedonisë në mënyrë drastike janë rritur dënimet për këto lloje të veprave penale, edhe atë: nga 8 vjet, ose 10 vjet burgim por edhe burgim të përjetshëm, kur ekzistojnë rrethana rënduese.

Në **Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë** parashikohen dënime më të rënda kur ekzistojnë rrethana rënduese gjatë kryerjes së veprës, në rastet kur janë shkaktuar dëmtime të rënda të shëndetit fizik dhe psikik të viktimës, nëse i ka parapri tortura ose dhuna e rëndë, nëse vepra është kryer ndaj viktimës vulnerable, nëse vepra është rezultat i dhunës në familje ose nëse vepra është kryer nga më tepër njerëz, të cilët kanë vepruar bashkërisht dhe nëse kryerësi paraprakisht ka qenë i dënuar për vepra të natyrës së njëjtë, siç është parashikuar në Nenin 28 të Konventës.

Kështu, për veprat penale: përdhunim, akt seksual mbi person të pafuqishëm, sulm seksual mbi fëmijë, incest, ndërmjetësim dhe involvim në prostitucion dhe vepra tjera penale të këtij lloji, në rast të rrethanave rënduese, përkatësisht nëse për shkak të veprës ka pasuar lëndim të rëndë trupor, vdekje ose pasoja tjera të rënda ose vepra është kryer nga më tepër persona ose në mënyrë jashtëzakonisht brutale ose përcmuese ose nëse vepra është kryer ndaj personave të kategorisë veçanërisht vulnerable të fëmijëve ose është kryer nga më tepër persona, janë parashikuar dënime më të larta.

Për shembull, për **“Sulm seksual mbi fëmijë”** për rrethana rënduese (lëndim i rëndë trupor, vdekje ose pasoja tjera të rënda ose vepra është kryer nga ana e më shumë personave ose në mënyrë jashtëzakonisht brutale dhe përcmuese, kryerësi do të dënohet me **më së paku 10 vjet burgim ose burgim të përjetshëm**.

Për veprën penale **Ndërmjetësim në ushtrimin e prostitucionit** nëse është kryer me mashtrim dhe dorëzimin e personit tek personi tjetër, me qëllim të ushtrimit të prostitucionit dhe me qëllim të përfitimit ose është kryer përmes kërcënimit me forcë fizike, ndërkaq me qëllim që të ketë dobi nga dhënia e shërbimeve seksuale, parashikohet **dënim me burgim nga pesë deri më dhjetë vjet**.

Për veprën penale **Manipulim dhe mundësim i veprimeve ose sulmeve seksuale mbi fëmijë dënim me burgim prej më së paku tetë vjet**.

Për paraqitjen e materialit pornografik personit të mitur, në të cilin viktimë është fëmija nën moshën 14 vjeç, **dënim me burgim prej gjashtë muaj deri tre vjet**, nëse vepra është kryer përmes shfrytëzimit të fëmijës-viktimë nën moshën 18 vjeç parashikohet **dënim me burgim prej tre deri pesë vjet**.

Për **Produksion dhe shpërndarje të pornografisë për fëmijë përmes sistemit kompjuterik** ku fëmija-viktimë është nën moshën 18 vjeç, për t'ia paraqitur personit tjetër ose për shpërndarje apo transferim, parashikohet **dënim me burgim prej tre deri në pesë vjet**.

Për manipulim për akt seksual ose veprim tjetër seksual mbi të miturin i cili nuk ka mbushur moshën 14 vjeç përmes mjeteve të komunikimit elektronik, me caktim të takimit ose në mënyrë tjetër, nëse i mituri i cili nuk ka mbushur moshën 14 vjeç manipulohet për akt seksual ose veprim tjetër seksual ose për produksion të pornografisë për fëmijë dhe nëse për qëllime të këtilla realizohet takim i drejtpërdrejt me të mitur parashikohet **dënim me burgim prej një deri pesë vjet**.

Për përdhunim parashikohet **dënim me burgim prej tre deri dhjetë vjet**, ndërsa për **Sulm seksual mbi person të pamundur dënim me burgim prej më së paku tetë, ose më së paku dhjetë vjet dhe mundësi për dënim me burgim të përjetshëm në rastet të cilat përfshijnë rrethana rënduese**.

Për sulm ose akt seksual mbi person të mitur, i cili nuk ka mbushur moshën 14 vjeç parashikohet **dënim me burgim prej më së paku tetë vjet ose më së paku**

dhjetë vjet me mundësi për dënim me burgim të përhershëm në rastet kur ekzistojnë rrethana rënduese.

Për sulm seksual ose akt seksual përmes keqpërdorimit të pozitës parashikohet **dënim me burgim prej më së paku pesë vjet, ndërsa për kryerësin e kësaj veprë penale mbi person të mitur dënim me burgim prej më së paku dhjetë vjet, etj.**

URGJENCA E PROCEDURAVE

Me qëllim të sigurimit të mbrojtjes së veçantë të fëmijëve-viktima, veç tjerash, është e domosdoshme që procedurat dhe hetimet që ndërmerren në lidhje me veprat e cekura, të zbatohen në interesin më të mirë të fëmijës dhe me respektimin konsekuent të të drejtave të tij, me ç'rast fëmija duhet të mbrohet nga traumat dhe viktimizimet e mëtutjeshme, ndërsa procedurat duhet të jenë urgjente dhe pa prolongime të panevojshme (Neni 30 i Konventës) dhe me respektimin e të drejtës për mbrojtje, gjykim të ndershëm dhe të paanshëm duke i mbrojtur të drejtat themelore të njeriut (Neni 30 i Konventës).

Çështjet që kanë të bëjnë me veprimin me fëmijët-viktima ose kryerës të veprave penale, para së gjithash, parashikohen me **Ligjin për të drejtën e të miturve**, me të cilin janë paraparë masa parandaluese dhe mbrojtëse për këtë kategori të fëmijëve. Përkatësisht, për të gjitha veprat penale nga Kodi Penal, në të cilat sipas përcaktimeve të ligjit, i mituri paraqitet si viktimë e veprës, gjykata dhe organet e tjera që marrin pjesë në procedurë e kanë për detyrë të ndërmarrin masa për ndihmë dhe mbrojtje dhe të veprojnë në atë mënyrë në të cilën do të shmangen pasojat e dëmshme për personin dhe zhvillimin e fëmijës.

Procedurat për këto vepra penale, ku viktimë është personi i mitur, janë urgjente. Me këtë rast parashikohet edhe mbrojtja e fëmijës në cilësinë e dëshmitarit, përkatësisht viktimë e mitur mund të dëgjohet si dëshmitarë vetëm nëse një gjë e tillë nuk ndikon dëmshëm mbi zhvillimin e tij psikofizik, ndërkohë që i njëjti mund të dëgjohet më së shumti dy herë, ndërsa me përjashtim tre herë, nëse këtë e kërkojnë rrethanat e posaçme të lëndës. Gjatë dëgjimit të të miturit si dëshmitar ose të dëmtuar, gjykata e ka për detyrë të mbajë llogari për cilësitë dhe karakteristikat personale të të miturit, për mbrojtjen e interesave të tij dhe për zhvillimin e drejt dhe në këtë kontekst dëgjimi i të miturit, varësisht nga mosha dhe zhvillimi i tij, kryhet në prezencë të psikologut, pedagogut ose personit tjetër profesionist. Po ashtu, nëse vlerëson se një gjë e tillë është e nevojshme, duke i marrë parasysh karakteristikat e veprës penale dhe veçoritë e personit të mitur, gjyqtari do të urdhërojë dëgjimin përmes përdorimit të mjeteve teknike për transmetimin e fotografisë dhe zërit. **Mirëpo, një pjesë e këtyre dispozitave në praktikë akoma nuk zbatohen në mënyrë përkatëse ose nuk zbatohen fare.** Dëgjimi zbatohet pa prezencën e palëve dhe pjesëmarrësve tjerë në procedurë, në ambient të veçantë, ndërsa pyetjet parashtrohen me ndërmjetësimin e pedagogut, psikologut ose personit tjetër profesionist (neni 138). Njëkohësisht, nëse si dëshmitarë dëgjohet viktimë e mitur, e cila për shkak të natyrës së veprës penale, pasojave ose rrethanave tjera është veçanërisht e ndjeshme, përkatësisht gjendja psikike është shumë e rëndë, gjyqtari vlerëson nëse ka nevojë për ballafaqim midis të miturit dhe të akuzuarit (neni 139).

Me qëllim të sigurimit të mbrojtjes së posaçme të të drejtave dhe interesave të fëmijës-viktimë, që nga dëgjimi i parë i të akuzuarit, viktimës duhet t'i sigurohet personi i autorizuar, ndërsa në rastet kur i mituri nuk ka të autorizuar, atë gjykata e cakton me aktvendim nga radhët e avokatëve të cilët janë të pajisur me dije të posaçme nga fusha e të drejtave të fëmijës dhe mbrojtja juridiko-penale e personave të mitur (Avokati e caktuar nga kryetari i gjykatës e ka për detyrë të ndjek trajnim të specializuar për delikuencën e të miturve prej



më së paku dhjetë ditë gjatë vitit, në vend ose jashtë tij). Shpenzimet e përfaqësimit bien mbi barrë të buxhetit gjyqësor (neni 40).

Sipas Konventës, kur fëmijët janë viktimë dhe dëshmitarë të veprave të cekura, ata duhet të njoftohen me të drejtat dhe shërbimet e tyre, duke u respektuar nevojat dhe dëshirat e tyre të posaçme. Duhet të njoftohen me aktakuzën, procesin e hetimit dhe epilogun e rasteve të tyre, me të drejtë që fëmijët ta refuzojë marrjen e këtyre informatave (Neni 31 i Konventës).

Gjithashtu, sipas Konventës, fëmijëve dhe familjeve të tyre duhet t'u mundësohet të dëgjohen, të paraqesin prova dhe t'i prezantojnë qëndrimet e tyre në mënyrë të cilën ata do ta zgjedhin, si dhe të ndërmerren masa për sigurimin e mbrojtjes nga frikësimi, hakmarrja ose viktimizimi i tyre, mbrojtjes së familjeve dhe dëshmitarëve të tyre, ndërsa kjo mund të arrihet edhe me shmangien e kontaktit mes viktimave dhe kryerësve, gjithnjë nëse kjo është në interesin më të mirë të fëmijës. Gjithashtu, fëmijëve-viktima duhet t'u sigurohet, sipas mundësisë, edhe ndihmë juridike falas (Neni 31 i Konventës).

Në lidhje me implementimin e këtyre dispozitave të Konventës do të cekim se në përputhje me **Ligjin për të drejtat e të miturve** për çdo fëmijë në rrezik miratohet program me të cilin njoftohet familja e fëmijës, përkatësisht prindërit e tij, të cilët e kanë për detyrë të veprojnë sipas këtij programi, me ç'rast monitorohen efektet tek fëmija, nga zbatimi i programit. Njëkohësisht, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të fëmijës, konform këtij Ligji, dëgjimi bëhet në ambiente të veçanta të përshtatura për këtë qëllim në qendra dhe shërbime policore, **por në praktikë këto qendra dhe shërbime policore akoma nuk kanë ambiente të këtuilla.** Gjithashtu, mbrojtësi doemos duhet të jetë i pranishëm gjatë gjithë procedurës, me ç'rast me ndryshimet plotësuese të këtij Ligji, detyrimisht caktohet avokat, nëse bëhet fjalë për vepër penale për të cilën parashikohet dënim me burgim prej më së paku pesë vjet, i cili duhet t'i mbrojtë të drejtat dhe interesat e fëmijës, po ashtu me ndryshimet, si zgjidhje me e pavolitshme, është paraparë që avokatin ta zgjedh familja, ndërsa nëse nuk e zgjedh, atëherë atë e zgjedh qendra ose gjykata, varësisht se kush e zhvillon procedurën por, me ndryshimet e ligjit, parashikohet që shpenzimet të bien mbi barrën e prindit, përveç nëse dëshmohet se është rast social dhe nuk ka mundësi t'i mbulojë ato shpenzime, e që sipas mendimit tonë kjo është e pavolitshme për fëmijët në rrezik sepse ata shpeshherë janë gjetur në gjendje të tillë për shkak të shpërfilljes dhe neglizhencës së prindërve, prandaj dhe nuk mund të pritët që prindi, i cili ndoshta edhe e ka keqpërdorur fëmijën e vet, të angazhojë avokat kualitativ dhe të trajnuar dhe ta paguajë për t'i mbrojtur të drejtat dhe interesat e fëmijës. Prindërit e të miturit, përkatësisht kujdestari mund të merr pjesë në të gjitha veprimet gjatë gjithë procedurës, përveç nëse gjyqi vlerëson se prania e tyre mund të ketë pasoja të dëmshme për zhvillimin e fëmijës.

Gjyqi mund të lejojë që në seancën kryesore të marrin pjesë edhe personat të cilët merren me mbrojtjen dhe edukimin e të miturve ose me luftimin e kriminalitetit tek të mitur, persona të afërm të të miturit, përfaqësues të organizatave për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, si dhe punonjës shkencorë (neni 85).

Në procedura, organet kompetente duhet të mbajnë llogari gjatë parashtrimit të pyetjeve drejtuar fëmijëve, përkatësisht një gjë e tillë duhet të bëhet pa zgjatje të paarsyeshme, në ambiente të përshtatura dhe të adaptuara dhe nga ana e personave të trajnuar profesionistë për këtë qëllim (gjyqtarë të trajnuar, prokurorë publikë, si dhe të parashikohet edhe mundësia që fëmijët si dëshmitarë të dëgjohen përmes video-regjistrimeve, ndërkaq video regjistrimet të pranohen si provë në procedurë gjyqësore (Neni 35 i Konventës).

Me **Ligjin për të drejtat e të miturve** parashikohet kapitull i veçantë për mbrojtjen e viktimave të mitur të veprave penale (neni 137).

Përkatësisht, në procedurën e cila zhvillohet për vepra penale në të cilat i mituri paraqitet si viktimë, gjykata, prokurorët publikë dhe personat zyrtarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, mund të veprojnë vetëm nëse posedojnë arsimim përkatës, njohuri dhe përvojë të posaçme nga fusha e të drejtave të fëmijës dhe për mbrojtjen juridiko-penale të të

miturve. Më tej, me këtë Ligji parashikohet obligimi që për të gjitha veprat penale, kur si viktimë paraqitet fëmija, gjykatat dhe organet tjera, të cilat marrin pjesë në procedurë, e kanë për detyrë të ndërmarrin masa për mbrojtje dhe ndihmë dhe të veprojnë në atë mënyrë me të cilën do të shmangen pasojat e dëmshme për personin dhe zhvillimin e tij, ndërkohë që derisa dëgjohej i mituri ose derisa prezantohen veprimet procesuale, me të cilat mund t'i shkaktohet dëm të miturit, gjyqi e përjashton publikun (neni 138).

Gjithashtu, me Ligjin e cekur parashikohet kapitulli i veçantë për parandalimin e delikuencës tek të miturit, me ç'rast për këtë qëllim është formuar organ i veçantë shtetëror, përkatësisht Këshilli Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës tek të Miturit, i cili është i pavarur dhe autonom në kryerjen e punës së vet, ndërsa anëtarët e tij i zgjedh Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, me ç'rast me Ligj është paraparë obligimi që në punën e këtij Këshilli të merr pjesë edhe përfaqësues nga Avokati i Popullit. Ky Këshill tanimë funksionon dhe ka miratuar Strategjinë Nacionale dhe Planin e Veprimit, ndërkohë që ka paraqitur edhe dy raporte vjetore për punën e tij pranë organeve kompetente, në mesin e të cilave edhe pranë Kuvendit të Republikës së Maqedonisë. Raporti shqyrtohet në seancë plenare të Kuvendit dhe përcaktohet shkalla e mbrojtjes së zbatimit të masave sipas Ligjit për të drejtat e të miturve, në aspekt të fëmijëve në rrezik, fëmijëve viktima dhe fëmijëve që bien ndesh me ligjin dhe jepen rekomandime për avancimin, parandalimin, mbrojtjen dhe rehabilitimin e mëtutjeshëm, si dhe parandalimin e fëmijëve për t'u shndërruar në viktima ose kryerës të veprave të ndëshkueshme.

Po ashtu edhe me **Ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve** viktimizeve u mundësohet përfshirje në programin për mbrojtjen e dëshmitarëve, për shkak të rrezikut të mundshëm që viktima t'i ekspozohet frikësimit, kërcënimit me hakmarrje ose rrezikut për jetë, shëndetit, lirisë, integritetit fizik ose pronës me përmasa më të mëdha. Masa mbrojtëse, sipas **Ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve** janë: ruajtja në fshehtësi e identitetit; sigurimi i mbrojtjes personale; ndërrimi i vendbanimit; përkatësisht vendqëndrimin, dhe ndërrimi i identitetit (neni 26).

Sipas **Ligjit për të drejtat e të miturve** (neni 86), i mituri nuk mund të gjykohej në mungesë. Gjatë kohës së prezantimit të provave të caktuara ose të deklaramëve të palëve, gjyqi mund të urdhërojë largimin e të miturit nga seanca, ndërsa gjatë ndërmarrjes së veprimeve, në të cilat merr pjesë i mituri, veçanërisht gjatë parashtrimit të pyetjeve, organet të cilat marrin pjesë në procedurë e kanë për detyrë të veprojnë me kujdes, duke mbajtur llogari për zhvillimin psikik të tij, ndjeshmërinë dhe karakteristikat individuale të të miturit, në mënyrë që procedura të mos ndikojë negativisht mbi zhvillimin e të miturit. Gjyqi, pasi paraprakisht ta ketë marrë mendimin nga ekipi profesionistë nga qendra, mund të vendos që të mos i parashtrrojë pyetje të miturin, po qe se vlerëson se një gjë e tillë mund të ketë pasoja të dëmshme mbi zhvillimin e tij.

Sipas këtij Ligji (Neni 94) parashikohet që në këto procedura të procedojnë njësi të specializuara gjyqësore për kriminalitetin e të miturve, të formuara në gjykatat themelore me kompetencë të zgjeruar, ndërkaq të cilat përbëhen nga gjyqtarë për të mitur, këshilla për të mitur dhe këshilltarë për të mitur. Në njësitë e specializuara gjyqësore për kriminalitetin e të miturve, të formuara në gjykatat themelore me kompetencë të zgjeruar, për kryerjen e punëve profesionale, kryetari i gjykatës përcakton më së paku nga një punonjës social, pedagog dhe psikolog nga lista të cilën e specifikon qendra.

Së këtëjmi, parashikohet obligimi që gjyqtari për të mitur, prokurori publik, avokati dhe personat e autorizuar zyrtarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, prej katër deri dhjetë ditë gjatë vitit, të ndjekin trajnim të specializuar për delikuencën tek të miturit brenda dhe jashtë vendit.

Këshilli për të Mitur në Gjykatën Themelore përbëhet nga gjyqtari për të mitur dhe dy gjyqtarë porotë, ndërsa gjyqtarët – porotë zgjidhen nga radhët e punonjësve arsimorë, psikologë, pedagogë, sociologë dhe persona tjerë të cilët kanë përvojë në edukimin dhe arsimimin e të rinjve (Neni 95).

Gjithashtu, edhe në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë formohet këshilli për të mitur, i cili përbëhet nga pesë gjyqtarë, e që vendos për mjete juridike të rregullta



dhe të jashtëzakonshme të përcaktuara me këtë Ligj, si dhe e ndjek dhe punon në avancimin e praktikës gjyqësore në këtë fushë dhe përgatitë analiza (Neni 96).

PARASHKRIMI

Me qëllim të ndërmarrjes me kohë të masave dhe veçanërisht dënimi i kryerësit të veprave të cekura, është e domosdoshme që afati i parashkrimit për fillimin e procedurës në lidhje me këto vepra, mundësisht të vazhdohet për një periudhë kohore e cila do të jetë e mjaftueshme për t'u siguruar fillimi efikas i procedurës, pasi viktima ta arrijë moshën madhore, ndërsa kjo periudhë të jetë proporcionale me rëndësinë e veprës konkrete (Neni 33 i Konventës).

PARASHKRIMI I NDJEKJES PENALE SIPAS LEGJISLACIONIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Me **Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë**, përcaktohen afatet e parashkrimit të ndjekjes penale, me ç'rast veprat penale, për të cilat mund të shqiptohet burgim i përjetshëm (dënimi i këtillë parashikohet për një pjesë të veprave për abuzim seksual dhe shfrytëzim seksual të fëmijëve me rrethana rënduese), ndjekja nuk mund të ndërmerret kur të kalojnë 30 vjet nga kryerja e veprës penale.

Për vepra penale, për të cilat parashikohet dënimi me burgim mbi 10 vjet, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret kur të kalojnë 15 vjet nga kryerja e veprës penale, ndërsa për vepra penale për të cilat parashikohet dënim me burgim mbi pesë vjet, ndjekja parashkruhet për dhjetë vjet (për pjesën më të madhe të veprave për abuzim seksual dhe shfrytëzim seksual të fëmijëve parashikohet dënim me burgim prej 10 vjet dhe dënim më i lartë se pesë vjet).

Për vepra penale, për të cilat parashikohet dënim me burgim mbi tre vjet, ndjekja parashkruhet për pesë vjet, ndërsa për vepra për të cilat shqiptohet dënim me burgim prej mbi një vit, parashkrimi është tre vjet, ndërsa dy vjet për vepra penale për të cilat mund të shqiptohet dënim me burgim prej një vit ose dënim me para.

Afate të njëjta të parashkrimit janë parashikuar edhe për ekzekutimin e dënimit.

Në **Ligji për të drejtat e të miturve** parashikohet që kur personi ka kryer ndonjë vepër penale si i mitur, ndërsa ndonjë si person i moshës madhore, do të zbatohet procedurë unike sipas Ligjit për procedurë penale, para kolegjit që i gjykon personat e moshës madhore (Neni 89).

Sipas këtij Ligji, dënimi me burgim për të mitur nuk mund të ekzekutohet nëse kanë kaluar:

- dhjetë vjet nga dënimi me burgim për të mitur mbi pesë vjet;
- pesë vjet nga dënimi me burgim për të mitur mbi tre vjet; dhe
- tre vjet nga dënimi me burgim për të mitur deri më tre vjet.

Dënimi me para nuk mund të ekzekutohet nëse kanë kaluar dy vjet nga gjykimi i dënimit me para.

Ekzekutimi i dënimeve ndalim për drejtim të automjetit dhe dëbim të personit të huaj nga vendi, parashkruhet kur do të kalojë koha për të cilën janë shqiptuar ato, ndërkaq nëse dëbimi është shqiptuar për çdoherë, kur do të kalojnë pesë vjet nga shqiptimi i tij.

Ekzekutimi i masës punë me dobi të përgjithshme, masave të sigurisë dhe sanksioneve për kundërvajtje, parashkruhen pasi të kalojë një vit nga dita e miratimit të vendimit të plotfuqishëm për shqiptimin e tyre (Neni 67).

GRUMBULLIMI I TË DHËNAVE DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Me qëllim të parandalimit dhe ndjekjes për veprat të cilat kanë të bëjnë me abuzimin seksual të fëmijëve është e domosdoshme të grumbullohen të dhëna, por edhe të sigurohet mbrojtja e të dhënave personale në lidhje me identitetin dhe profilin gjenetik të personave të dënuar për vepra të parapara me Konventën (Neni 37 i Konventës).

Në implementimin e këtyre dispozitave të Konventës, me Ligji për të drejtat e të miturve parashikohet se për zbatimin e masave për ndihmë dhe mbrojtje nga ana e qendrës ose gjykatës, qendra mban evidencë interne, ndërsa të dhënat e të gjitha qendrave i dërgohen Regjistrorit për zbatimin e masave të cilin e udhëheq Ministria e Punës dhe Politikës Sociale. Pasi i mituri t'í mbush 18 vjet, fshihen të dhënat nga Regjistri. **Regjistri tanimë është themeluar dhe në të evidentohet të dhënat e nevojshme.**

Në muajin janar të vitit 2012, u miratua **Ligji për regjistrin e veçantë të personave të dënuar për vepra penale për abuzim seksual të personave të mitur dhe pedofili.** Qëllimi i Ligjit dhe zbatimi i tij është sigurimi i mbrojtjes së fëmijëve nga abuzimi seksual dhe pedofilia përmes arritshmërisë së informatave për personat të cilët jetojnë në rrethin e tyre, ndërkaq të cilët janë dënuar për vepra penale që kanë të bëjnë me abuzimin seksual të personave të mitur dhe pedofili.

(Ueb-faqja për denoncimin e rasteve për abuzim seksual të fëmijëve dhe pedofili është: www.stop-pedofilija.org.mk)

Konform Ligjit të cekur mbahet Regjistri i veçantë për personat e dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm për vepra penale për abuzim seksual të personave të mitur dhe pedofili, përmes së cilit mundësohet qasje deri tek informatat e caktuara për të gjithë të dënuarit për këto vepra penale. Në këtë **Regjistër, i cili është i arritshëm për të gjithë** publikohet emri dhe mbiemri i kryerësit, data e lindjes, adresa ku jeton, vepra penale për të cilën është dënuar dhe fotografia. (www.registarnapedofili.mk).

Në përputhje me **Ligjin për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve**, duhet të respektohet personaliteti i njeriut, integriteti fizik dhe psikik, siguria dhe privatësia e personalitetit të pacientit. Konform **Ligjit për mbrojtje shëndetësore** punonjësit shëndetësorë e kanë për detyrë ta respektojnë dinjitetin e pacientëve, t'í përmbahen etikës mjekësore dhe ta ruajnë fshehtësinë profesionale. Së këtejmi, pacienti ka të drejtë për konfidencialitet (fshehtësi) të të dhënave personale dhe mjekësore, të cilat duhet të jenë sekret edhe pas vdekjes së tij, në përputhje me rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale, me ç'rast një nga obligimet e punonjësve shëndetësorë është ta sigurojnë fshehtësinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale dhe mjekësore të pacientit, të cilat kanë të bëjnë me statusin e pacientit, diagnozën mjekësore, përkatësisht diagnozën klinike, diagnozën, prognozën dhe trajtimin, si dhe të gjitha informatat që janë të natyrës personale, madje edhe pas vdekjes së tij. Po ashtu, pacienti ka të drejtë t'í mundësohen kushte të cilat do t'í sigurojnë privatësi gjatë ndërhyrjeve mjekësore dhe veçanërisht gjatë dhënies së përkudjes personale.

Për mospunimin e konfidencialitetit, fshehtësisë së të dhënave personale dhe mjekësore, përkatësisht për gjendjen klinike, diagnozën, prognozën dhe trajtimin, si dhe për dhënien e informatave tjera të natyrës personale, parashikohet edhe dënim për kundërvajtje, ndërkaq zbulimi i paautorizuar i fshehtësisë nga mjeku ose punëtorë tjetër shëndetësor, i cili e ka kuptuar gjatë kryerjes së punës dhe profesionit të tij, paraqet edhe



vepër penale.

Mbrojtja e të dhënave për gjendjen shëndetësore përcaktohet edhe me **Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Ligjin për mbrojtjen e popullsisë nga sëmundje ngjitëse**, në veçanti, të dhënat për sëmundje të caktuara ngjitëse, të cilat mund t'u jepen vetëm institucioneve të caktuara, me ç'rast në kontekst të denoncimit të sëmundjes së SIDA-s dhe infektimit me HIV, Ligji në mënyrë eksplicite përcakton se duhet të jenë anonime.

Gjithashtu, edhe sipas **Ligjit për policinë**, nëpunësit policorë e kanë për detyrë ta ruajnë fshehtësinë e të dhënave dhe informatave të cilat i kuptojnë gjatë kryerjes ose me rastin e kryerjes së punëve policore dhe të cilat, konform Ligjit ose rregullave tjera, paraqesin të dhëna personale ose informata të klasifikuara, në të cilat të dhëna gjithsesi bëjnë pjesë edhe të dhënat nga fusha shëndetësore, përkatësisht të dhënat mjekësore.

Mbrojtja juridiko-penale e fëmijëve-viktima të abuzimit seksual përshihet edhe me **Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë dhe Ligjin për procedurë penale**.

Normat, të cilat e rregullojnë procedurën e identifikimit, zbulimit, ndjekjes, grumbullimit të provave dhe prezantimin e tyre para gjykatës, si dhe shqiptimin e sanksioneve, janë përfshirë në Ligjin për procedurë penale dhe Ligjin për të drejtat e të miturve. Sistemi juridiko-penal duhet të sigurojë zbatim konsekuent të Ligjit për procedurë penale, i cili lejon biseda përmes video-lidhjes. Për këtë do të nevojitet sigurimi i ambientit të posaçëm në gjykata, pajisje përkatëse dhe trajnim për shfrytëzimin e tyre, **e që deri më tani nuk është siguruar.**

REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIMIN E KORNIZËS LIGJORE

Me qëllim të reduktimit dhe pengimit të abuzimit seksual dhe eksploatimit seksual të fëmijëve, edhe përkrah kornizës së mirë ligjore, e cila në princip është e harmonizuar me Konventën, megjithatë nevojitet:

- vëmendje e veçantë fillimisht t'i kushtohet parandalimit, përmes parashikimeve të masave ligjore konkrete dhe organeve të cilat e kanë për detyrë t'i zbatojnë ato masa për veprim parandalues dhe pengimin e grupeve të fëmijëve në rrezik të bëhen viktima;

- parashikim i obligimit ligjor për trajnim të vazhdueshëm të të gjitha subjekteve për të drejtat e fëmijëve dhe për mënyrat e mundshme të cenimit dhe keqpërdorimit të tyre, duke filluar nga fëmijët përmes sistemit arsimor, prindërve përmes këshillimoreve dhe mënyrave tjera, personave zyrtar në organet të cilat punojnë me fëmijët, punonjësve arsimor, gjyqtarëve, prokurorëve publikë dhe të gjithë personave të tjerë të cilët në mënyrë të drejtpërdrejt ose të tërthortë vendosin për të drejtat e fëmijëve, sigurojnë mbrojtje të të drejtave të tyre ose kryejnë rehabilitimin e fëmijëve-viktima;

- parashikim i teknikave të veçanta dhe kushteve për të zhvilluar bisedë me fëmijët dhe zbatimin e kësaj bisede një deri dy herë;

- parashikim i masave ligjore përkatëse të detyrueshme dhe mënyrave për rehabilitimin e të gjithë fëmijëve-viktima të veprave penale dhe kushte për dëmshpërblimin e tyre;

- parashikim i mundësisë ligjore në të gjitha procedurat dhe para të gjitha organeve në mënyrë që fëmijët-viktima të fitojnë ndihmë juridike falas nga avokatë të trajnuar, pa varësisht gjendjes ekonomike të prindërve dhe sidomos nëse prindërit në mënyrë joadekuate e kryejnë të drejtën prindërore, dhe si rrjedhojë e kësaj fëmijët vihen në rrezik të bëhen viktima ose kryerës të veprave ndëshkuese;

- ndërmarrja e të gjitha masave të mundshme, në mënyrë konsekuente të implementohet dhe zbatohet korniza ligjore, ndërsa në këtë kontekst të sigurohen kushte financiare, kadrovike dhe teknike në të gjitha institucionet dhe organet relevante.

ANALIZA E TË DHËNAVE, PËRGJIGJEVE DHE INFORMATAVE TË PRANUARA SIPAS PYETËSORËVE

PËRSHKRIMI I NOCIONIT ABUZIM SEKSUAL DHE EKSPLOATIM SEKSUAL I FËMIJËVE (Pyetja nr. 1)

Gjykatat

Në kontekst të kuptimit të këtij nocioni nga ana e gjykatave u konstatua se rreth gjysma e gjykatave të anketuara nuk kanë dhënë kurrfarë përgjigje në këtë pyetje.

Një pjesë e gjykatave nocionin abuzim seksual dhe eksploatim seksual të fëmijëve e trajtojnë vetëm nëse vepra është kryer mbi fëmijën nën moshën 14 vjeç, që do të thotë se fëmijët mbi moshën 14 vjeç nuk i përfshijnë në këtë nocion.

Vetëm një numër shumë i vogël i gjykatave kanë dhënë përkufizim përafërsisht adekuat për këtë nocion dhe i kanë përfshirë shumicën e llojeve të abuzimit seksual dhe eksploatimit seksual të fëmijëve deri në moshën 18 vjeç.

Pjesa tjetër e gjykatave kanë dhënë vetëm definicion të pjesshëm dhe të shkurtër për këtë nocion (më së shpeshti bëhet fjalë për çdo formë të shfrytëzimit seksual të fëmijëve ose se këtë nocion e nënkuptojnë konform inkriminimit të veprave penale, të parashikuara me Kodin Penal, pa i dhënë perceptimet e tyre për këtë nocion).

Marrë në përgjithësi, gjykatat këtë nocion e përkufizojnë si ndërmarrje të aktiviteteve në të cilat përdoret forca ose kërcënim, me keqpërdorimin e gjendjes, me mundësinë që të ndikohet mbi fëmijët, veçanërisht nga ana e personave të cilët kanë autoritet të caktuar dhe fëmijët kanë besim tek abuzuesi.

Prokuroritë publike

Për dallim prej gjykatave, vetëm një numër i vogël i prokurorive publike nuk kanë dhënë përgjigje në këtë pyetje.

Megjithatë, pjesa më e madhe e prokurorive kanë dhënë përgjigje të shkurtër se bëhet fjalë për çdo formë të abuzimit seksual të fëmijëve dhe se këtë nocion e nënkuptojnë konform veprave të parapara penale në Kodin Penal.

Vetëm një numër i vogël i prokurorive publike e kanë përshkruar drejtë dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse se çka në të vërtetë nënkuptojnë me nocionin abuzim seksual dhe eksploatim seksual të fëmijëve.

Në përgjithësi, prokuroritë publike këtë nocion e kuptojnë si manipulim ose detyrim të fëmijëve për të marrë pjesë në aktivitete të paligjshme seksuale, shfrytëzim me eksploatim të fëmijëve në prostitucion, shfrytëzim me eksploatim të fëmijëve në paraqitje dhe revista pornografike dhe ngjashëm.

Persona profesionistë të policisë

Rreth gjysma sektorëve policorë të anketuar nuk dhanë përgjigje në pyetjen e parash-truar se si e kuptojnë abuzimin seksual dhe eksploatimin seksual të fëmijëve.

Vetëm disa sektorë kanë dhënë përgjigje adekuate dhe gjithëpërfshirëse për këtë nocion, ndërsa pjesa më e madhe e sektorëve kanë dhënë vetëm sqarim të shkurtër se ky është çdo aktivitet i orientuar drejt abuzimit seksual dhe eksploatimit seksual të fëmijëve nga ana e të rriturve përmes shfrytëzimit të pamundësisë së fëmijës për ta kuptuar domethënien e aktiviteteve seksuale të kryera mbi të dhe duke mos pasur mundësi për ta refuzuar ose për të dhënë pëlqim për aktivitete të tilla për shkak të lajthitjes, mashtrimit dhe ngjashëm.



Persona profesionistë të qendrave për punë sociale

Pothuajse të gjitha qendrat dhanë përgjigje në pyetjen për nocionin e abuzimit seksual dhe eksploatimit seksual të fëmijëve. Megjithatë, një numër i vogël i tyre kanë dhënë përafërsisht përkufizim gjithëpërfshirës dhe të drejtë për këtë nocion, një pjesë e tyre këtë abuzim e lidhin vetëm me fëmijët nën moshën 14 vjeç, ndërsa pjesa më e madhe e përkraujnë vetëm me arsytim të shkurtër se me të nënkuptohet çdo lloj i aktivitetit seksual të të rriturit ose adoleshentit me fëmijë dhe se është një "akt i neveritshëm" dhe e keqja më e madhe që bëhet mbi fëmijët është mënyra më flagrante e cenimit të të drejtave të fëmijës të cilat lënë pasoja të përhershme të dëmshme dhe ngjashëm.

Persona profesionistë të sektorit civil (OJQ)

Vetëm katër nga gjithsej nëntë organizata joqeveritare, të përfshira në hulumtim, dhanë përgjigje në pyetjen se si e kuptojnë nocionin abuzimi seksual dhe eksploatim seksual të fëmijëve.

Nga përgjigjet e dhëna mund të konstatohet se sektori joqeveritar përafërsisht e kupton drejtë këtë nocion dhe përfshinë më tepër forma të llojeve të këtylla të abuzimit dhe eksploatimit të fëmijëve. Në të shumtën e rasteve, këtë nocion e përkufizojnë si aktivitetet të shkaktuar me forcë ose kërcënim për kontakt seksual me fëmijën (prekje, ledhatim në vende të papërshtatshme), marrëdhënie seksuale me fëmijën, detyrim në prostitucion, të treguarit e pjesëve intime të trupit përpara fëmijës, martesë të detyrueshme ose të kontraktuara dhe ngjashëm.

Pyetësi iu dërgua edhe Organizatës Botërore të Shëndetësisë, e cila nuk e plotësoi Pyetësin, por na informoi se ka zbatuar hulumtim të ngjashëm përmes anketimit të fëmijëve, ndërsa në tekstin në vijim do tua prezantojmë konstatimet dhe rekomandimet.

CILI ËSHTË PROFILI I VIKTIMAVE TË ABUZIMEVE TË CEKURA? (Pyetja nr. 5)

Gjykatat

Pak më pak se gjysma e gjykatave të anketuara nuk kanë dhënë përgjigje në këtë pyetje, ndërsa ato që janë përgjigjur i kanë marrë parasysh vetëm rastet të cilat i kanë proceduar pa dhënë informata të përgjithshme, megjithatë duhet të theksohet se të gjitha gjykatat nuk iu përgjigjën të gjitha pyetjeve të parashtruara.

Sa i përket **gjinisë së viktimave** nga përgjigjet rezulton se në numrin më të madh të rasteve ato janë fëmijë-vajza, por gjithashtu ka edhe një numër të konsiderueshëm të fëmijëve-meshkuj viktimë të veprave të cekura penale.

Na aspekt të moshës së viktimave më së shpeshti ata janë fëmijë të moshës prej 14,15 dhe 16 vjeç, por ka edhe fëmijë-viktima me moshë akoma më të vogël, përkatësisht 7, 8, 9 ose 12 vjeç.

Fëmijët-viktima të veprave të cekura penale, në numër më të madh të përgjigjeve të dhëna të pjeseshme, në kontekst të **statusit arsimor**, janë me arsim fillor.

Në kontekst të **përkatësisë** etnike numri më i madh i viktimave janë të bashkësisë etnike maqedonase dhe rome, ndërsa në numër më të vogël janë të bashkësive etnike shqiptare, turke ose ndonjë bashkësie tjetër etnike.

Viktimat, në të shumtën e rasteve vijnë nga **familje disfunktionale, të rrezikuara sociale, të varfra** ose familje nga mjedise rurale, të papunësuar, ndërsa numër më i vogël nga familjet me një prind ose nga prind të divorcuar.

Në aspekt të **hendikepit dhe mos-zhvillimit mendor** vetëm një numër i vogël i gjykatave kanë potencuar se viktimë të këtyre veprave penale janë nga kjo kategori e fëmijëve.



Prokuroritë publike

Nga të dhënat e prokurorive publike mund të vërehet se vetëm një numër i vogël nuk kanë dhënë përgjigje në këtë pyetje, por të gjitha prokuroritë nuk u janë përgjigjur të gjitha pyetjeve të parashtruara. Nga përgjigjet shihet se numri më i madh i viktimave, sa i përket **strukturës gjinore** janë të gjinisë femërore, ndërsa numër i vogël janë fëmijë-viktima meshkuj.

Në aspekt të **moshës** ata janë fëmijë të moshës prej 13 dhe 14 vjeçare, por gjithashtu sipas të dhënave të prokurorive ka edhe fëmijë-viktima të moshave më të vogla, përkatësisht të moshës 8 vjeç, madje edhe fëmijë 3 vjeç.

Fëmijët viktima të veprave të cekura penale, në numrin më të madh të përgjigjeve të dhëna të pjeshme në kontekst të **statusit arsimor** janë me arsim fillor ose arsim të papërfunduar.

Në aspekt të **përkatësisë etnike njësor, sikurse edhe tek përgjigjet e gjykatave** numri më i madh i viktimave janë të bashkësisë etnike maqedonase dhe rome, ndërsa numër më i vogël të bashkësisë etnike shqiptare, turke ose bashkësive tjera etnike.

Viktimat, në të shumtën e rasteve vijnë nga **familje** të rrezikuara sociale, të varfra dhe të papunësuar dhe vetëm nga një prokurori publike është cekur edhe **alkoolizmi**.

Në kontekst të **hendikepit dhe mos-zhvillimit** mendor gjithashtu, sikurse edhe gjykatat, prokuroritë publike cekën se vetëm një numër i vogël i viktimave të veprave të cekura penale janë të kësaj kategorie të fëmijëve.

Policia

Sipas përgjigjeve të organeve policore **viktima më të shpeshta** janë fëmijët-femra, të moshës prej 11-16 vjeç, ndërkaq sa i përket statusit arsimor në numër më të madh janë fëmijët me arsim fillor ose pa arsim.

Sa i përket përkatësisë etnike, numri më i madh i viktimave janë të bashkësisë etnike maqedonase dhe rome, ndërsa numër më i vogël i bashkësisë etnike shqiptare, ose nga bashkësitë e tjera etnike.

Viktimat, në të shumtën e rasteve rrjedhin nga familjet e rrezikuara ekonomisht, të papunësuar, të varfra, disfunktionale dhe familje të paorganizuar. Si viktima paraqiten edhe fëmijët të cilët vijnë nga familje në të cilat ka pasur dhunës.

Qendra për punë sociale

Në lidhje me këtë pyetje, thuaja se të gjitha qendrat kanë dhënë përgjigje të ngjashme, përkatësisht kanë cekur se viktima më të shpeshta, sipas informatave të tyre, janë fëmijët të cilët nuk e kanë mbushur moshën 14 vjeç.

Në aspekt të përkatësisë etnike theksohen fëmijë të bashkësisë maqedonase dhe rome, por në numër më të vogël edhe fëmijët e bashkësisë shqiptare dhe turke.

Njëherësh, si viktima paraqiten fëmijët e shpërfillur nga aspekti edukativ, arsim dhe psikologjik ose pa kujdes prindëror, fëmijët në rrugë, si dhe fëmijët të cilët jetojnë në kushte të vështira socio-ekonomike, ose që e kanë prejardhjen nga familje disfunktionale ose prindërit e të cilëve janë me arsim të ulët.

Po ashtu, sipas përgjigjeve të një pjese të qendrave, si viktima paraqiten fëmijët me përvojë seksuale paraprake, që kanë qenë viktima të eksploatimit seksual ose kanë qenë të ekspozuar në dhunë familjare, por konsiderohet se **të gjitha kategoritë e cekura në pyetësor në mënyrë të barabartë janë të ekspozuar në rrezik**.

Organizata joqeveritare

Sipas përgjigjeve të organizatave joqeveritare, kategoritë më të rrezikuara të fëmijëve, të cilët mundet dhe janë viktima të eksploatimit seksual, janë fëmijët në rrugë, fëmi-



jët femra dhe meshkujt në mënyrë të barabartë dhe më së shpeshti këta janë viktimë të bashkësisë etnike maqedonase, por edhe rome, për shkak se numri më i madh i fëmijëve në rrugë janë të bashkësisë etnike rome.

Pastaj, më të rrezikuar janë fëmijët të cilët jetojnë në familje me marrëdhënie të çrregulluara familjare, në familje ku ka pasur dukuri të dhunës në familje dhe në familje me status të ulët ekonomik.

A KA QENË FËMIJA I NJËJTË DY OSE MË SHUMË HERË VIKTIMË DHE A ËSHTË PARAQITUR KRYERËSI PËRSËRI NË ROLIN E NJËJTË? (Pyetja nr. 6)

Gjykatat

Rreth gjysma e gjykatave nuk ka dhënë përgjigje në këtë pyetje, ndërsa prej atyre që kanë dhënë vetëm një gjykatë është përgjigjur se një fëmijë i njëjtë disa herë ka qenë viktimë nga kryerës të ndryshëm dhe një gjykatë është përgjigjur se gjatë periudhës së përmendur vetëm një person i njëjtë dy herë është paraqitur si kryerës, ndërsa gjykatat e tjera janë përgjigjur se nuk kanë pasur raste të këtilla.

Prokuroritë publike

Vetëm një numër i vogël i prokurorive nuk kanë dhënë përgjigje në këtë pyetje, me ç'rast nga ato që janë përgjigjur, vetëm në një rast fëmija i njëjtë ka qenë dy herë viktimë nga kryerës të ndryshëm, ndërsa sipas prokurorisë tjetër një fëmijë i njëjtë 11 herë ka qenë viktimë, por nuk është cekur se a ka qenë kryerësi i njëjtë (Shtip), ndërkaq prokuroritë e tjera janë përgjigjur se nuk kanë pasur raste të tilla.

MASA PËR NDIHMË DHE MBROJTJE TË FËMIJËS DËSHMITAR (Pyetja nr.7)

Gjykatat dhe prokuroritë publike

Në lidhje me pyetjen nëse dhe çfarë masash ndërmarrin gjykatat dhe prokuroritë publike për ndihmë dhe mbrojtje, kur fëmija paraqitet si dëshmitar, është përgjigjur vetëm një numër i vogël i gjykatave dhe më pak se gjysma e prokurorive publike, ndërkaq një pjesë e tyre janë përgjigjur se nuk kanë ndërmarrë kurrfarë masa për ndihmë dhe mbrojtje, ndërkaq numri më i madh i gjykatave dhe prokurorive publike u përgjigjën se seanca dëgjimore mbahet në prezencën e prindit, ekipit të qendrës për punë sociale (psikologut ose psikiatrit), personave tjerë specialistë, në praninë e personit të autorizuarit, përkatësisht mbrojtësit, pa prezencën e të akuzuarit dhe pa praninë e publikut. Njëra prej gjykatave vetëm i ka cituar dispozitat e Ligjit për drejtat e të miturve që kanë të bëjnë me këtë çështje, pa dhënë sqarime se si dhe sa zbatohen ato në praktikë. Një prokurori është përgjigjur se seanca **dëgjimore është kryer në ambient të veçantë, e jo në sallën e gjyqit, si shembull pozitiv për qasje përkatëse ndaj fëmijës.**

Policia

Shërbimet policore gjithashtu, këtë pyetje e kanë kuptuar sikurse edhe gjykatat dhe prokuroritë dhe kanë dhënë përgjigje sidomos në aspekt të mënyrës së marrjes në pyetje të fëmijës, por nuk ceken masat e tjera për ndihmë dhe mbrojtje të fëmijëve. Kështu, sipas përgjigjeve të policisë, për çdo rast veç e veç njoftohet qendra për punë sociale, ndërsa gjatë marrjes në pyetje të fëmijës merr pjesë prindi-kujdestari, psikologu i qendrës për punë so-

cialë, ndërkohë fëmijës pyetjet i parashtrohen në ambient special të pajisur për fëmijë, por ambient të këtillë ka vetëm në Shkup, por jo edhe në organet e tjera policore nëpër Republikë. Bisedën me fëmijët-viktima e zhvillon inspektor i trajnuar.

Sipas **përgjigjeve, policia zyrtarisht nuk ka pranuar informatë kthyesë nga gjykatat, në lidhje me atë se çka ka ndodhur me denoncimin** dhe as vendim gjyqësorë. Në të gjitha rastet, policia vepron me urgjencë dhe pa prolongim dhe ndërmerr masa që me fëmijët të bisedohet vetëm një herë, të mbahet llogari për nevojat e fëmijës me qëllim që të mbrohet nga viktimizimi i sërishëm.

KATEGORITË E FËMIJËVE TË CILËT VEÇANËRISHT I EKSPOZOHEN RREZIKUT (Pyetja nr. 8)

Gjykatat dhe prokuroritë publike

Sipas përgjigjeve të gjykatave dhe prokurorive publike, mund të konstatohen përgjigje përafërsisht të njëjta, nga të cilat mund të vërehet se më të ekspozuar në rrezik për abuzim seksual janë fëmijët pa kujdes prindëror, përkatësisht fëmijët e neglizhuar, fëmijët e familjeve të varfra, fëmijët në rrugë, fëmijët përdorues të drogës, ndërsa në numër më të vogël fëmijët e ekspozuar në dhunë familjare, fëmijët jashtë arsimit dhe fëmijët me nevoja të veçanta. Një pjesë e gjykatave dhe prokurorive publike kanë deklaruar se **të gjitha kategoritë e fëmijëve në mënyrë të barabartë janë të ekspozuar në rrezik.**

Policia

Sipas përgjigjeve të policisë, rezulton se të gjitha kategoritë e cekura të fëmijëve mund të jenë viktima, por si kategori më e rrezikuar e fëmijëve janë ata të cilët jetojnë në nivelin e varfërisë, fëmijët pa prindër dhe kujdes prindëror, fëmijët të cilët kanë rrezik të caktuar social dhe kategoritë e tjera të fëmijëve.

Qendra për punë sociale

Në lidhje me këtë pyetje, pothuajse të gjitha qendrat kanë dhënë përgjigje të ngjashme, përkatësisht kanë cekur, se viktima më të shpeshta, sipas informatave, janë fëmijët: të cilët nuk kanë mbushur moshën 14 vjeç, ndërsa në kontekst të përkatësisë etnike janë fëmijët e bashkësisë etnike maqedonase dhe rome, ndërkaq në numër më të vogël ka edhe fëmijë nga bashkësia shqiptare dhe turke. Njëkohësisht, si viktima paraqiten fëmijët e neglizhuar nga aspekti psikologjik, edukativ, arsimor ose pa kujdes prindëror, fëmijët në rrugë, si dhe fëmijët të cilët jetojnë në kushte të këqija socio-ekonomike, ose të cilët rrjedhin nga familje disfunktionale ose prindërit e të cilëve janë me nivel të ulët arsimor. Po ashtu, sipas përgjigjeve të një pjese të qendrave, si viktima të eksploatimit seksual paraqiten edhe fëmijët me përvojë paraprake seksuale, të cilët kanë qenë viktima të eksploatimit seksual, ose kanë qenë të ekspozuar në dhunë familjare, si dhe **ajo se të gjitha kategoritë e fëmijëve të cekur në Pyetësor në mënyrë të barabartë i ekspozohen rrezikut.**

Organizatat joqeveritare

Organizatat joqeveritare konsiderojnë se **të gjithë fëmijët në mënyrë të barabartë janë të ekspozuar në rrezik** dhe veçanërisht fëmijët të cilët e kanë braktisur shkollën, fëmijët e ekspozuar në dhunë familjare dhe të cilët paraprakisht kanë pasur përvojë me eksploatim seksual, fëmijët të cilët jetojnë dhe punojnë në rrugë, fëmijët me zhvillim të pamjaftueshëm mendor, fëmijët pa kujdes prindëror ose nëse jetojnë në nivelin e varfërisë, fëmijët përdorues të drogës, fëmijët të bashkësive të vogla etnike, fëmijët e migrantëve.



BASHKËPUNIMI NDËRMJET INSTITUCIONEVE

Në pyetjen se me cilat shërbime/organizata kanë bashkëpunuar organet dhe organizatat e anketuara, **gjykatat** u përgjigjën se më së shpeshti bashkëpunojnë me: qendrat për punë sociale, policinë dhe prokurorinë publike, me organizatat joqeveritare dhe me organet e organizatat e tjera. **Prokuroria publike**, më së shpeshti bashkëpunon me qendrat për punë sociale dhe me policinë, ndërsa edhe policia më së shpeshti bashkëpunon me qendrat për punë sociale, me institucionet arsimore, por edhe me këshillimoret për prindër dhe fëmijë, Entin për Shëndet Mendor, gjykatat dhe me organet e tjera. Këto organe cekin se kanë bashkëpunim të mirë me të gjitha organet dhe institucionet dhe se nuk kanë kurrfarë probleme gjatë bashkëpunimit të ndërsjellë.

Nga përgjigjet e pranura nga **qendrat për punë sociale** rezulton se qendrat më së shumti kanë bashkëpunim të mirë me: policinë, gjykatat dhe prokuroritë publike, ndërsa nuk është në nivel të kënaqshëm bashkëpunimi me pushtetin lokal, me institucionet shëndetësore dhe arsimore edhe pse një pjesë e qendrave theksojnë se kanë bashkëpunim të mirë me shërbimet psikologjike-pedagogjike të shkollave, gjë që është shembull pozitiv. Gjithashtu, qendrat kanë bashkëpunim të mirë edhe me organizatat joqeveritare, por si anë të dobët, në kontekst të bashkëpunimit dhe nevojës për ndihmë dhe mbrojtje të viktimave nga institucionet e veçanta profesionale, theksohet mospasja e këshillimoreve përkatëse për trajtimin dhe rehabilitimin e viktimave. Po ashtu, qendrat i vënë në pah dukuritë negative në procedurat gjyqësore, për shkak të rasteve kur fëmijët merren në pyetje më shumë herë, me çka në mënyrë plotësuese traumatizohen dhe viktimizohen.

Organizatat joqeveritare në dhënien e ndihmës viktimave, më së shpeshti bashkëpunojnë me qendrat për punë sociale, gjykatat dhe policinë, si edhe me Avokatin e Popullit.

PJESËMARRJA E PERSONAVE PROFESIONISTË NË PROGRAMET PËR PARANDALIM

Nga përgjigjet e **gjykatave** u konstatua se vetëm një gjykatë ka marrë kanë marrë pjesë në programin për parandalim, por nuk është theksuar në cilin, ndërsa njëra nga gjykatat kërkoi që Avokati i Popullit të organizojë aktivitete të këtilla në të cilat do t'i përfshijë edhe gjyqtarët.

Prokuroritë publike u përgjigjën se një pjesë e tyre kanë marrë pjesë në trajnime për dhunë në familje përmes Akademisë për Trajnimin e Prokurorëve Publikë, ndërkaq një numër i vogël kanë marrë pjesë në pushtetin lokal përmes trajnimeve të organizuara nga organizata joqeveritare dhe nga këshillat për parandalim në komuna.

Organet policore theksuan se janë hartuar projekte për luftë kundër dhunës në familje, me ç'rast janë mbajtur punëtori dhe takime me nxënës. Programet parandaluese, në përputhje me sistematizimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, i zbaton dhe organizon Seksioni i veçantë për parandalim, ndërkaq inspektorët për delikucencë të të miturve ekskluzivisht punojnë në dokumentimin e të dhënave për veprimin sipas denoncimeve dhe ngjarjeve për vepra përkatëse penale. Më tej, nëpunësit policorë, në kuadër të projekteve me titull: "Parandalimi nga trafikimi me fëmijë" dhe "Përmes sportit për tolerancë pa dhunë", janë përfshirë në trajnime për abuzimin seksual dhe eksploatimin e fëmijëve.

Shumica e **qendrave për punë sociale** nuk kanë marrë pjesë në programet për parandalim dhe vetëm një numër i vogël i tyre ka marrë pjesë në programe të caktuara si: "Stop dhunës". Shumica e qendrave për punë sociale kanë marrë pjesë në Programin e Ministrisë për Punë dhe Politikë Sociale, Kryqit të Kuq dhe Entit për Veprimtari Sociale me temë: "Me edukim dhe dije deri te parandalimi nga abuzimi seksual dhe pedofilia", përmes më tepër punëtorive dhe tribunave. Këto programe dhe tribuna janë prezantuar edhe përmes fushatave dhe ligjëratave në shkollat fillore dhe të mesme, me titull: "Me edukim dhe dije deri te

parandalimi nga abuzimi seksual”, në organizim të Kryqit të Kuq. Gjithashtu, është bërë edhe prezantimi dhe informimi i të rriturve nëpër shkolla, prindërit dhe këshillat prindërore.

Një pjesë e organizatave joqeveritare, sidomos organizata joqeveritare e cila strehon viktimat të trafikimit me njerëz, ka zhvilluar program kompleks për parandalimin e trafikimit me njerëz, i cili përfshinë grupe të ndryshme: “grupet në rrezik”, persona të rinj, persona të papunë, persona me status të ulët social, fëmijët në rrugë, fëmijët pa kujdes prindëror, grupe të marginalizuara dhe persona të trafikuar. Kjo organizatë zbaton metoda të ndryshme të parandalimit gjatë punës me këto grupe edhe atë përmes leksioneve preventive, punëtorive, ushtrimeve, forumeve, teatrit, shpërndarjes së materialeve parandaluese, konsultimeve me internet, përmes linjës telefonike SOS për parandalimin e trafikimit me njerëz. Gjithashtu, një pjesë e organizatave joqeveritare janë anëtare të Trupit Koordinues Nacional për zbatimin e Planit të Veprimit për parandalimin dhe luftimin e abuzimit seksual të fëmijëve dhe pedofilisë dhe në këtë rol kanë hartuar udhërrëfyes për prindërit dhe mësimitdhënësit, me qëllim që të pajisen me dije dhe shkathtësi se si t’i mbrojnë fëmijët nga abuzimi seksual, ndërkohë që zbatojnë edhe fushatë për grumbullimin e mjeteve nga qytetarët dhe kompanitë për krijimin e fondit për mbështetjen e fëmijëve dhe të rinjve-viktima të abuzimit seksual. Po ashtu, organizatat joqeveritare realizojnë edhe trajnime në temë: “Përfaqësimi kur fëmijët janë viktimat të abuzimit seksual dhe lobimi për ndëshkim më të rigoroz të pedofilëve”, ndërkaq është hartuar edhe studimi me temë: “Fëmija-dëshmitarë dhe abuzimi seksual mbi fëmijët”.

SI KA MBËRRITUR FËMIJA DERI TEK QENDRA PËR PUNË SOCIALE OSE DERI TEK ORGANIZATA JOQEVERITARE?

Në lidhje me këtë pyetje u përgjigjën pjesa më e madhe e qendrave, ndërsa nga përgjigjet e tyre rezultoi se në numrin më të madh të rasteve viktimat ka mbërritur në qendër sipas denoncimit të policisë, pastaj sipas denoncimit të policisë dhe prindit apo familjarit, ndërsa një pjesë më e vogël në qendër kanë mbërritur me kërkesë të gjyqit dhe prokurorisë publike ose janë dërguar nga policia dhe organizatat joqeveritare.

Organizatat joqeveritare potencuan se në të shumtën e rasteve tek ato, viktimat i dërgon Njësia për luftë kundër trafikimit me njerëz pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, Mekanizmi Nacional për Referim pranë Ministrisë për Punë dhe Politikë Sociale, si dhe nga qendrat për punë sociale. Organizatat joqeveritare sa u përket viktimave për këtë njoftohen më së shpeshti përmes linjës SOS për fëmijë dhe të rinj ose përmes vizitës së drejtpërdrejt të viktimës në organizatën joqeveritare, e cila posedon linjë të këtyre telefonike, por rrallëherë viktimat paraqiten vet, përkatësisht më së shpeshti rastin e denoncojnë prindërit ose persona të afërm, të cilët kanë qenë dëshmitarë të veprës së këtyre ose dyshojnë se fëmija është viktimë e eksploatimit seksual.

INDIKATORËT PËR VLERËSIMIN SE FËMIJA ËSHTË VIKTIMË E ABUZIMIT SEKSUAL DHE EKSPLOATIMIT SEKSUAL

Sipas përgjigjeve të cilat i kanë dhënë gjysma e qendrave të anketuara (qendrat e tjera nuk kanë dhënë përgjigje në këtë pyetje), mund të konstatohet se qendrat këtë vlerësim, në numrin më të madh të rasteve, e kryejnë në bazë të shenjave të cilat i manifeston fëmija, përkatësisht kur vërejnë ose kur marrin informata se fëmija është më i tërhequr, depresiv, me vëmendje dhe përqendrim të zvogëluar, bëhet agresiv, nevrik, ikë nga mësimi, ndjen turp, hidhërim ose ndryshime të tjera në sjelljen e fëmijës, siç është edhe sjellja delikvente, bëhet përdorues i drogës ose ka ide suicide ose probleme tjera fizike dhe psikike. Në bazë të këtyre shenjave, qendrat vlerësojnë se me fëmijën po ndodhë diçka dhe se bëhet fjalë për abuzimin e tij. Disa nga qendrat kanë deklaruar se këtë e kanë vlerësuar vetëm në



bazë të kontrollit mjekësor.

Organizatave joqeveritare në lidhje me këtë çështje janë përgjigjur se gjithashtu si indikatorë për vlerësimin se fëmija është viktimë, janë shenjat të cilat i manifeston fëmija, siç është tërheqja, depresioni, njohuritë për seksin dhe sjelljen seksuale mbi nivelit të pritshëm për moshën e tij, ndryshimet e disponimit, ankthe, urinim në krevat, probleme në shkollë, reagime agresive, por në raste të caktuara edhe kur fëmija ka plagë, përkatësisht lëndime sidomos në zonën gjenitale.

PUNA KONKRETE E QENDRAVE ME RAST TË CAKTUAR

Në këtë pyetje, përgjigje kanë dhënë rreth gjysma e qendrave, ndërsa nga përgjigjet e tyre rezulton se i ndërmarrin këto masa për ndihmë dhe mbrojtje të fëmijës-viktimë të abuzimit seksual dhe eksploatimit seksual:

- ndihmë për mjekimin dhe sanimin e lëndimeve (mbrojtje shëndetësore), siguri mi i mbrojtjes gjatë procedurës gjyqësore, mbështetje psikologjike-sociale me bisedë dhe ndërmjetësim për sigurimin e ndihmës profesionale, terapisë, motivimit, mbështetjes financiare dhe ndihmë me qëllim të ndryshimit të mjedisit sipas nevojës, ndihmë për ndjekje të rregullt të mësimi, risocializim, intervistë dhe bisedë, grumbullim i informatave të nevojshme, mes të cilave edhe provat mjekësore, njoftimet e policisë, punën me familjen dhe me fëmijën përmes planit individual, ndjekjen dhe evaluimin e aktiviteteve të planifikuara. Nëse fëmija nuk ka prindër ose prindërit e kanë keqpërdorur, qendra e vendos fëmijën në institucion për mbrojtje sociale, ndërsa nëse fëmija nuk ka dokumentacion personal ose dokumentacion tjetër i ndihmohet që të pajiset me të. Po ashtu, qendrat i japin viktimës dhe familjes ndihmë profesionale këshillëdhënëse, kryejnë mbikëqyrje mbi të drejtën prindërore, sipas nevojës bëjnë vendosjen e fëmijës në institucion përkatës, japin ndihmë gjatë realizimit të të drejtave të natyrës materiale, bashkëpunojnë me institucione tjera, e njoftojmë shkollën dhe kryejnë punë edukative këshillëdhënëse përmes psikologut, ndërkohë që sigurojnë edhe mbështetjen e viktimës dhe prindërve dhe ndërmarrin masa për pengimin e viktimizimit sekondar.

PUNA KONKRETE E ORGANIZATËS JOQEVERITARE ME RAST TË CAKTUAR

Sipas sqarimit të organizatave joqeveritare, kur është paraqitur fëmija ose person tjetër në linjën SOS dhe kanë deklaruar se bëhet fjalë për abuzim seksual, shpeshherë e kanë potencuar edhe faktin se institucionet rastin ia bartin njëri tjetrit, ndërsa gjatë kësaj kohe kryerësi i veprës është në liri, me çka fëmija traumatizohet në mënyrë plotësuese. Për rastet e kësaj, organizatat joqeveritare i kanë njoftuar organet kompetente, më së shpeshti qendrat për punë sociale dhe policinë, ndërsa shumë shpesh edhe Avokatin e Popullit.

REKOMANDIME TË DHËNA NGA ORGANET DHE ORGANIZATAT E ANKETUARA (Pyetja nr. 11)

Gjykatat

Pjesa më e madhe e gjykatave kanë dhënë rekomandime dhe propozime për përmirësimin e gjendjes dhe tejkalimin e problemeve, në mesin e të cilave dominojnë rekomandimet si vijojnë:

- Edukim dhe trajnim i personave zyrtarë, sidomos të punonjësve socialë, pedagogëve

dhe psikologëve, fëmijëve, mësimeve, përfaqësuesve të mediave, edukim të prindërve veçanërisht të familjeve të rrezikuara dhe të publikut të gjerë;

- Emisione në mjetet e informimit publik dhe fushata për ngritjen e vetëdijes publike;
- Përforsim i familjes dhe forsim i rolit edukativ i prindërve, por edhe i punonjësve arsimorë;
- Përforsim i dënimeve dhe shqiptim i dënimeve të përcaktuara;
- Inkorporim i programeve përkatëse për mbështetje dhe formimi i ekipeve mobile profesionale, të cilët do të jenë në dispozicion 24 orë, si dhe instalimi i linjës telefonike falas për denoncimin e rasteve të këtilla nga ana e fëmijëve dhe nxitja për t'i denoncuar dukuritë e këtilla;
- Veprim parandalues dhe ngritja e vetëdijes publike edhe përmes organizimit të tribunave dhe përforsimi i mjeteve të informimit publik;
- Hapja e këshillimoreve për punë me familjen në ose jashtë qendrave për punë sociale dhe aktivitet më i madh proaktiv dhe aktivitet mbrojtës të qendrave për punë sociale;
- Ndëshkim i kryerësve me dënime përkatëse, veçanërisht nëse janë anëtarë të familjes;
- Përforsim i kapaciteteve institucionale dhe njerëzore me qëllim që viktimave t'u jepen shërbime efektive.

Siç mund të shihet nga përgjigjet e gjykatave, edhe pse ato deri më tani fare nuk kanë marrë pjesë në kurrfarë trajnime, në rekomandimet e tyre propozohet edukimi i të gjithë profesionistëve tjerë, por asnjëra gjykatë nuk ka rekomanduar se ka nevojë për trajnimin edhe të gjyqtarëve.

Prokuroritë publike

Sikurse gjykatat ashtu edhe prokuroritë publike, rol të veçantë i japin parandalimit përmes edukimit të fëmijëve, por edhe edukimit dhe trajnimit të punonjësve arsimorë, personave zyrtarë të qendrave për punë sociale, policisë, prokurorive publike, gjykatave, por edhe prindërve dhe publikut të gjerë.

Në këtë kuptim, veç tjerash propozojnë:

- Parandalim dhe mbrojtje të fëmijëve-viktima në bashkëpunim të ndërsjellë të të gjitha institucioneve (MPB, QPS, gjykatat, prokuroritë);
- Edukim të fëmijëve, prindërve, mësimeve;
- Emisione mediatike për këtë problem, me qëllim të informimit më të madh mediatik për këtë dukuri dhe ngritje të vetëdijes publike;
- Zbatim të fushatave dhe promovim të qëndrimeve me qëllim të edukimit të të gjithë subjekteve për identifikimin e dukurive të këtilla dhe inkurajimin për t'i denoncuar të njëjtat;
- Sistem efikas parandalues për pengimin e fëmijëve për t'u bërë viktima, procedura të shpejta dhe të koordinuara nga të gjitha organet kompetente, rehabilitim dhe riintegrim të fëmijës-viktimë përmes praktikimit të procedurës së mirë midis të gjitha institucioneve (qendrave për punë sociale, institucioneve shëndetësore, institucioneve arsimore, shërbimeve policore, organeve gjyqësore);
- Angazhim më i madh i fëmijëve në aktivitete fizike, kulturore dhe aktivitete tjera;
- Rritje më aktive e punës dhe veprimit të qendrave, e jo vetëm pasi të ndodh problemi;
- Kujdes i shtuar ndaj fëmijëve edhe atë nga prindërit, punonjësit arsimor dhe qendrave për punë sociale, me qëllim të reagimit me kohë dhe kritere më të rrepta gjatë zgjedhjes dhe angazhimit të personave të cilët punojnë me fëmijë;
- Politikë më e ashpër ndëshkuese, shqiptim i dënimeve më të rrepta dhe sistem më



efikas juridik.

Policia

Organet policore, rekomandojnë realizimin e më tepër projekteve, në të cilët do të përfshihen nxënësit e shkollave të mesme dhe nxënësit e shkollave fillore, të cilëve do t'u sqarohen procedurat, indikatorët dhe në përgjithësi do të njihen me problemin, me qëllim të detektimit dhe aftësimit për vetëmbrojtje dhe inkurajimin e fëmijëve për t'i denoncuar këto dukuri. Organet policore, mes tjerash, rekomandojnë:

- Masa më rigoroze për dhunuesit, por edhe ndaj prindërve të cilët nuk kujdesen mjaftueshëm në edukimin e fëmijëve;
- Angazhim të përbashkët dhe bashkëpunim më të madh midis institucioneve të cilat janë kompetente për dhënien e mbrojtjes dhe ndihmës fëmijëve-viktima të eksploatimit seksual;
- Sensibilizim i publikut, për këtë problem dhe instalim i linjës telefonike;
- Projekte parandaluese për ngritjen e kapaciteteve të prindërve të disa familjeve në rrezik;
- Trajnim i kuadrit arsimor në shkolla dhe në institucione parashkollore, si dhe të shërbimeve psiko-sociale në të gjitha institucionet për detektimin e rasteve të dyshimta dhe për mënyrën e veprimit në raste të këtilla;
- Realizim i më tepër projekteve, në të cilat do të përfshihen nxënës të shkollave të mesme dhe fillore, të cilave do t'u sqarohen procedurat, indikatorët dhe në përgjithësi të njoftohen me problemin;
- Sensibilizimi i publikut dhe zbatimi i projekteve parandaluese për ngritjen e kapacitetit të prindërve të grupeve të caktuara të qytetarëve, trajnimin e kuadrit arsimor në shkolla dhe institucione parashkollore, për detektimin e rasteve të dyshimta dhe për mënyrën e procedimit të këtyre rasteve.

Qendrat për punë sociale

Numri më i madh i qendrave për punë sociale kanë dhënë rekomandimet e tyre për tejkalimin e këtij problemi, në mesin e të cilave:

- Formim i ekipit të veçantë profesional në çdo qendër, e cila do të punojë me grupe vulnerable dhe me fëmijë të cilët janë abuzuar dhe eksploatuar seksualisht dhe krijimin e ambienteve të veçanta për punë me këta fëmijë dhe rregullimi i tyre me audio dhe video pajisje;
- Respektim i protokolleve nga ana e institucioneve kompetente për veprim të drejtë dhe me kohë;
- Avancim i bashkëpunimit midis të gjitha institucioneve të cilat janë kompetente për zgjidhjen e çështjes për mbrojtjen e viktimave të eksploatimit seksual me qëllim të detektimit të problemit dhe ngritjes së vetëdijes në komunitet;
- Përfshirje në institucionet edukative-arsimore, edukimi i fëmijëve, kuadrit arsimor dhe shërbimeve psikologjike-pedagogjike në shkolla dhe inkorporimi nëpër në shkolla i edukatës seksuale;
- Ngritje e vetëdijes publike, sidomos tek profesionistët dhe bashkëpunim më i shpejtë dhe më i mirë midis institucioneve kompetente;
- Formim i këshillimoreve dhe mobilizim dhe kompletim i tyre me ekipe profesionale në qendra dhe nëpër shkolla;
- Zbulim efikas dhe i shpejtë i kryerësve dhe ndëshkimi i tyre më i rreptë;
- Organizim më i shpeshtë i takimeve (të organizuara dhe grupore) të prindërve të fëmijëve me kujdestarin e klasës dhe shërbimin pedagogjik-psikologjik në shkolla përmes

përmbajtjeve edukative për parandalimin e abuzimit seksual të fëmijëve;

- Përfaqësim i më tepër fushatave mediatike në lidhje me këtë dukuri;
- Detektim i hershëm i rastit, denoncimi i tij pranë institucioneve kompetente, punë dhe ndihmë për viktimën;
- Përforcim i sistemit juridik për mbrojtjen e fëmijëve – dëshmitarë të abuzimit seksual, dënime të larta për prindërit – kryerës të veprës, fushata informative nëpër shkolla;
- Hapje e linjës SOS në nivel lokal, pengimi i viktimizimit sekondar të fëmijëve-viktima, respektim i të drejtave të fëmijëve;
- Hapje e këshillimoreve për fëmijët-viktima me qëllim të trajtimit të tyre adekuat.

Organizata joqeveritare

Organizatave joqeveritare, mes tjerash, rekomandojnë se duhet:

- Të përforcohet sistemi i mbrojtjes së fëmijëve, sidomos me pro-aktivitet më të madh të institucioneve arsimore, të cilat kanë rol të madh në mbrojtjen e fëmijëve, qendrave për punë sociale të cilat duhet të zbatojnë aktivitete të ndryshme për parandalim dhe në mënyrë plotësuese duhet t'i përkushtohen punës individuale me familjet me qëllim të përforcimit të tyre;
- Sensibilizimi i publikut të gjerë për këtë dukuri negative;
- Inkorporimi i masave dhe programeve për risocializimin e fëmijëve-viktima, por edhe të personave të dënuar për këto vepra gjatë ekzekutimit të dënimit dhe pas përfundimit, me qëllim të pengimit të përsëritjes së veprës;
- Vendosija e mekanizmave për koordinimin dhe bashkëpunimin e të gjitha subjekteve të involvuara dhe mposhtjen e abuzimit seksual të fëmijëve;
- Rritja e dënimeve për kryerësit, varësisht nga vepra të cilën e kanë kryer;
- Instalimi i sistemit për monitorimin e kryerësve të këtyre veprave pas vuajtjes së dënimit, me qëllim që të pengohet përsëritja e veprës;
- Edukimi i vazhdueshëm i personave profesional për identifikimin dhe ndërmarrjen e masave të mbrojtjes, përkatësisht trajnimi intensiv i profesionistëve nga të gjitha institucionet dhe organizatat relevante;
- Aktivitete parandaluese në shkolla duke promovuar vazhdimisht shërbimet e mbrojtjes të cilat i kanë në dispozicion fëmijët;
- Shteti, të përgatit programe të veçanta për tejkalimin e rrezikut social tek grupet veçanërisht vulnerable të popullatës rome;
- Forcimi i partneritetit ndërmjet autoriteteve lokale dhe shoqërisë civile, me qëllim të sigurimit të qasjes multidisiplinare në nivel lokal, në drejtim të ndërmarrjes së aktiviteteve për parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie;
- Të realizohen hulumtime me qëllim të fitimit të bazës solide empirike për përcaktimin e principeve dhe faktorëve të cilët kontribuojnë për vulnerabilitetin e veçantë të popullatës rome dhe organizimit të fushatave për ngritjen e vetëdijes tek popullata rome për këtë fenomen.

KONSTATIME DHE REKOMANDIME NË BAZË TË PËRGJIGJEVE TË PRANUARA

Në bazë të analizës së përgjigjeve të pranuar sipas pyetjeve të përgjithshme të parashtruara në pyetësorë, pranë të gjitha organeve dhe organizatave të përfshira, mund të konstatohet si vijon:

- Organet kompetente në mënyrë të pamjaftueshme e kuptojnë nocionin eksploatim seksual dhe abuzim seksual të fëmijëve dhe nuk i kuptojnë të gjitha llojet e mundshme të



keqpërdorimit dhe shfrytëzimit të këtyre të fëmijëve;

- Në Kontekst të profilin të fëmijëve-viktima të eksploatimit seksual dhe abuzimit seksual të fëmijëve, më shesh hasen fëmijët femra, por nuk mund të shpërfilllet edhe numri i fëmijëve meshkuj. Gjithashtu, sipas të gjitha organeve, si viktima më së shpeshti paraqiten fëmijët e moshës nga 14 deri më 16 vjeç, ndërsa në numër më të vogël paraqiten edhe fëmijë të moshës më të vogël. Më së shpeshti viktimat janë të nacionalitetit maqedonas dhe romë, me arsim fillor ose pa arsimim dhe se rrjedhin nga familje të varfra, disfunksionale, konfliktuoze dhe familje të rrezikuara sociale, ndërsa një pjesë e vogël edhe e familjeve ku ka dukuri të dhunës në familje;

- Si kategori të fëmijëve, të cilët janë më të ekspozuar në rrezikun për t'u bërë viktimë, janë fëmijët pa prindër dhe kujdes prindëror përkatësisht fëmijët e neglizhuar, fëmijët në rrugë, fëmijët përdorues të drogës, fëmijët e varfër dhe fëmijët me probleme edukative-sociale, të cilët janë jashtë sistemit arsimor;

- Në lidhje me bashkëpunimin dhe koordinimin midis institucioneve, mund të konkludohet se ekziston bashkëpunim i mirë vetëm ndërmjet disa institucioneve (qendrave për punë sociale, policisë, organeve të jurisprudence), por se nuk ka bashkëpunim përkatës me institucionet arsimore dhe shëndetësore dhe me organet e organizata tjera përkatëse, si dhe me pushtetin lokal, bashkëpunim dhe koordinim i cili është i domosdoshëm për luftimin e suksesshëm të këtyre dukurive dhe sigurimin e ndihmës dhe mbrojtjes së fëmijëve;

- Organet dhe organizatat kompetente në masë të pamjaftueshme marrin pjesë në programet për parandalim, të cilët kanë rol të rëndësishëm për pengimin dhe reduktimin e keqpërdorimeve dhe shpërfilljeve të cekura të fëmijëve. Personat profesionistë, të cilët punojnë me fëmijë, nuk janë sa duhet të trajnuar dhe të aftësuar për të drejtat e fëmijëve dhe për detektimin e të gjitha llojeve të cenimeve dhe keqpërdorimeve të të drejtave të fëmijëve, gjë që është e domosdoshme për parandalimin e drejtë dhe efikas, si dhe për mbrojtje dhe rehabilitim;

- Fëmijët, rrallëherë e denoncojnë vet veprën. Më së shpeshti këtë e bëjnë persona të tjerë ose rasti kuptohet në bazë të informatave tjera. Kjo sugjeron në nevojën për edukimin e fëmijëve për të drejtat e tyre, identifikimin e keqpërdorimeve të atyre të drejtave dhe inkurajimin për t'i denoncuar shkeljet dhe keqpërdorimet pranë organeve kompetente, për atë se ku dhe si mund t'i denoncojnë rastet e këtyra;

- Si supozim kryesor për veprim parandalues është edukimi i fëmijëve përmes sistemit arsimor, por edhe i prindërve, personave zyrtarë dhe publikut të gjerë përmes trajnimeve dhe tribunave të ndryshme edukative, programeve dhe fushatave të ndryshme mediatike. Po ashtu, si masë preventive, sipas organeve, është ndëshkimi më rigoroz i kryerësve, por edhe monitorimi dhe puna me ta në mënyrë që të mos e përsërisin veprën;

- Mekanizmat dhe mënyrat për parashikimin e rehabilitimit të viktimave nuk janë të mjaftueshme, përkatësisht të njëjtat nuk zbatohen në masë të mjaftueshme;

- Për ndërmarrjen e masave parandaluese, mbrojtëse ose rehabilituese, shpeshherë nuk paraqiten kushtet financiare, kadrovike dhe teknike në të gjitha organet dhe institucionet;

- Me qëllim të përcaktimit të shkaqeve të cilat sjellin deri te abuzimi seksual i fëmijëve, janë të domosdoshme hulumtime më të shpeshta. Konform të dhënave të pranuar nevojitet të ndërmerren masa për eliminimin ose reduktimin e shkaqeve të cilat shpijnë në abuzime dhe shfrytëzime të këtyra të fëmijëve.

ANALIZA E INFORMATAVE DHE KONSTATIMEVE TË PRANUARA NGA INTERVISTAT E FOKUS-GRUPEVE ME PROFESIONISTË

Intervistat e fokus-grupeve u mbajtën me profesionistë nga më shumë organe dhe organizata relevante, përkatësisht nga: gjykatat kompetente, qendrat për punë sociale, prokuroritë, policia, organizatat joqeveritare, përfaqësues të shkollave fillore dhe të mesme (pedagogë, psikologë, defektologë), nga institucione shëndetësore (psikiatër, fiziterapistë) dhe nga trupa nacional. Megjithatë, pjesa më e madhe e trupave kuvendore dhe qeveritare nuk iu përgjigjën ftesës dhe nuk morën pjesë në këto fokus-grupe.

U mbajtën katër fokus-grupe në tre qytete të ndryshme të Maqedonisë. Intervistat e realizuara me profesionistë patën për qëllim të merren përgjigje të drejtpërdrejta dhe personale, qëndrime dhe opinione në lidhje me abuzimin seksual të fëmijëve. Në intervistat me fokus-grupet, vëmendje e veçantë iu përkushtua sidomos tendencave dhe profilit të fëmijëve të abuzimeve të këtilla dhe masave për parandalim, si dhe se cilat dhe çfarë mekanizmash shfrytëzojnë, si profesionistë, për sigurimin e mbrojtjes dhe ndihmës fëmijëve-viktima të abuzimit dhe eksploatimit seksual.

Në pjesën më të madhe të intervistës, personat profesionistë i dhanë të gjitha konstatimet, si në përgjigjet me shkrim të pyetjeve sa i përket **profilin të fëmijëve si viktima më të shpeshta të eksploatimit dhe abuzimit seksual**. Bëhet fjalë për fëmijë që nuk kanë mbushur moshën 14 vjeç, shumica e tyre janë të bashkësisë etnike maqedonase dhe rome, ndërsa në numër më të vogël janë të bashkësisë etnike shqiptare; fëmijë të neglizhuar nga aspekti psikologjik, edukativ dhe arsimor; fëmijë të cilët jetojnë në kushte të këqija socio-ekonomike, shpeshherë në familje të cilat pranojnë ndihmë sociale; fëmijë të cilët vijnë nga familje jofunksionale, nga familje me prindër të divorcuar ose të cilët jetojnë me njerkun ose njerkin; fëmijë të prindërve të cilët kanë arsim të ulët dhe ngjashëm.

Po ashtu, sikurse edhe sipas të dhënave të dërguara statistikore, nga përgjigjet e profesionistëve rezultoi se **llojet më të shpeshta të eksploatimit seksual janë**: sulmi seksual mbi fëmijë, jeta jashtëmartesore me person të mitur, akti seksual, kënaqja e epsheve seksuale para personit tjetër, incesti dhe ndërmjetësimi gjatë ushtrimit të prostitucionit.

Në kontekst të **tendencës së denoncimit të dukurive të këtilla dhe profilit të viktimës dhe kryerësve**, në periudhën e përfshirë kohore, nga viti 2008 deri në mes të vitit 2011, si dhe sipas përgjigjeve të dhëna me shkrim në pyetësorin, rezultoi se për dallim prej më parë dukuritë e këtilla denoncohen më shpesh, ndonëse dukuri të këtilla kanë ekzistuar edhe më herët, prandaj dhe rritet numri i viktimave dhe kryerësve. Për eksploatimin seksual, gjithnjë e më tepër flitet në publikë dhe gjithnjë e më tepër publiku ndërgjegjësohet për këtë të keqe. Gjithashtu, rezultoi se zvogëlohet moshja e viktimave dhe se për dukurinë e shpeshtë të këtyre keqpërdorimeve të fëmijëve kontribuon edhe përdorimi dhe prania e fëmijëve në rrjetet sociale, sidomos në "Fejsbuk", me çka rritet liria seksuale tek fëmijët, por edhe rreziku nga keqpërdorimi. Po ashtu profesionistët theksuan se në numrin më të madh të rasteve, abuzuesit gjenden në afërsi të drejtpërdrejt të viktimës, përkatësisht fëmija i njëjti dhe ka besim tek ata dhe se shumë pak si kryerës paraqiten persona të panjohur të viktimës.

Sa i përket pyetjes nëse **profesionistët nga organet kompetente kanë marrë pjesë në programet dhe aktivitetet për mbrojtjen e fëmijëve-viktima, nëpunësit policorë** potencuan se me fëmijët-viktima kanë vepruar persona specialistë dhe të trajnuar dhe se bashkë me qendrën për punë sociale merren vesh se ku do të zhvillohet biseda me viktimën dhe pastaj e informojnë prokurorinë publike për zbatimin e mëtejshëm të procedurës.

Profesionistët nga qendrat për punë sociale janë përgjigjur se veprojnë konform Protokollit për eksploatim seksual dhe abuzim të fëmijëve, të miratuar nga Ministria për Punë dhe Politikë Sociale, protokoll ky ku janë përfshirë të gjitha instruksionet se si duhet të veprohet me viktimat. Megjithatë, ata theksuan se ka nevojë për trajnim plotësues dhe rol më aktiv të qendrave, veçanërisht kur ekziston dyshimi në lidhje me mbikëqyrjen e të drejtës prindërore, përkaëtsisht se diçka po ndodh me fëmijën. Me këtë rast, ekip special i të trajnuar dhe ambient special të përshtatur kanë vetëm një numër i vogël i qendrave.

Gjykatat theksuan se veprojnë në përputhje me Ligjin për të drejtat e të miturve



dhe në radhë të parë fëmijës i caktojnë person të autorizuar që në dëgjimin e parë, ndërsa dëgjimin e kryejnë gjyqtarë hetues, të cilët veprojnë me kujdes të madh dhe në prani të ekipit të formuar nga qendra për punë sociale, ndërkaq nëse ka nevojë nga person ekspert, atëherë edhe në prani të personit ekspert. Gjykata vepron në procedurë urgjente dhe i ndërmerr të gjitha masat e mundshme për fshehtësinë e procedurës dhe mbrojtjen e të dhënave personale dhe të identitetit të fëmijës-viktimit, edhe pse shpeshherë gazetaret, nga burime të ndryshme, kuptojnë për rastin dhe publikojnë informata jopërkatese në publik, me çka cenohet privatësia dhe shpesh jepen të dhëna përmes së cilave lehtësisht mund të zbulohet identiteti, gjë që paraqet viktimizim plotësues për fëmijën-viktimit..

Prokuroritë publike potencuan se veprojnë konform Ligjit për procedurë penale dhe Ligjit për të drejtat e të miturve dhe i zbatojnë me ligj masat e parashikuara për mbrojtjen e viktimave.

Profesionistët e shkollave potencuan se nëpër shkolla zbatohen fushata dhe shpërndahen fletëpalosje për fëmijët, ndërkohë që mbahen edhe takime me prindërit. Po ashtu, potencuan se në rast të abuzimit të këtyre të fëmijës, punojnë me fëmijën-viktimit dhe me prindërit e tij, ndërkaq shërbimi psikologjik-pedagogjik zhvillon ligjërata për këto dukuri dhe në këtë kuptim bashkëpunojnë edhe me organizatat joqeveritare.

Profesionistët e institucioneve shëndetësore theksuan se "i kurojnë" pasojat dhe se nuk kanë mundësi t'i mbrojnë fëmijët për të mos u shndërruar në viktime të abuzimit seksual. Këto institucione zbatojnë psikoterapi mbi viktimat, ndërkaq punojnë edhe me prindërit e tyre me qëllim të tejkalimit të traumave dhe krizës emocionale dhe për këtë qëllim zbatohen trajtime speciale mjekësore.

Profesionistët e **sektorit joqeveritar** japin vetëm ndihmë fillestare, ndërsa më pas fëmijët-viktima i dërgojnë në institucionet kompetente.

Në kontekst të **rekomandimeve nga personat e intervistuar profesionistë** janë konstatuar rekomandimet e njëjta sikur në pyetësor (paraprakisht janë cekur në raport).

Në lidhje me parandalimin, për çka nevojitet edhe pjesëmarrja e domosdoshme në trajnime dhe mënyra tjera për fitimin e dijes dhe shkathtësive për detektimin e këtyre dukurive, pothuajse të gjithë pjesëmarrësit e intervistave të fokus-grupeve deklaruan se kanë marrë pjesë në numër të caktuar të seminareve, punëtorive, fushatave nga institucione/organizata të ndryshme në temën për parandalimin e dhunës midis nxënësve, programeve të OSBE-së për shkolla të sigurta, programeve të UNIFEF-it për reduktimin e dhunës, fushata në tema të ngjashme të organizuara nga MPB-ja, të cilat janë mbajtur nëpër shkollat fillore dhe të mesme, si dhe fushata e debate të organizuara nga organizata joqeveritare. Mirëpo, asnjëri nga pjesëmarrësit e intervistave të fokus grupeve nuk ka qenë pjesëmarrës ose organizator i ndonjë seminari të caktuar, trajnimi ose ligjërata të cilat kanë të bëjnë me temën konkrete për abuzimin seksual të fëmijëve.

Së këtejmi, përshtypje e përgjithshme nga bisedat e zhvilluara me profesionistët është se tek numri më i madh i pjesëmarrësve ka dominuar mendimi se ndonëse ekzistojnë programe, protokolle për punë, plane të veprimit të miratuar nga institucione relevante të shtetit, ato nuk janë implementuar deri në fund dhe shfrytëzohen pamjaftueshëm në praktikë, ndërsa si një nga shkaqet është mungesa e resurseve financiare, kadrovike dhe teknike.

Gjithashtu, mund të konstatohej se një numër i madh i të punësuarve në institucione nuk janë sa duhet të aftësuar për punë në fushën e abuzimit seksual të fëmijëve, prandaj personave profesionistë, sidomos qendrave për punë sociale u nevojitet specializim më i madh në punë në këtë fushë dhe lirimi i tyre nga puna në fushat e tjera, për shkak se nuk mund t'i japin rezultatet e dëshiruara në trajtimet dhe sjelljen me fëmijët-viktima të eksploatimit seksual dhe nuk disponojnë me dije dhe shkathtësi të nevojshme se si t'i identifikojnë dhe si të veprojnë me fëmijët-viktima të abuzimit seksual.

Gjatë diskutimeve u potencua mungesa e qasjes sistematike në pengimin dhe luftimin e abuzimit seksual të fëmijëve nga ana e institucioneve të cilat duhet t'i identifikojnë dhe të veprojnë në rast të dyshimeve se është kryer abuzim seksual mbi fëmijën.



Sa u përket **mekanizmave për identifikimin dhe veprimin me fëmijët-viktima**, profesionistët e **shërbimeve policore** potencuan se më së shpeshti viktimat vet paraqiten ose policia vepron sipas informatave të fituara nga burime tjera dhe se nuk kanë probleme me identifikimin. Megjithatë, nëpunësit policorë vlerësojnë se duhet qartë të caktohet se cili institucion për çka është kompetent, ndërsa për këtë qëllim, veç tjerash, nevojitet promovim më i madh i Protokollit për veprimin me këtë kategori të fëmijëve të miratuar nga Ministria për Punë dhe Politikë Sociale.

Qendrat për punë sociale gjithashtu shpeshherë veprojnë sipas denoncimit të vet viktimave ose familjeve të tyre, policisë, shkollave ose organizatave joqeveritare, por ato veçanërisht kanë problem me identifikimin e fëmijëve-viktima të moshës nga 2 deri më 5 vjeç, sepse këta fëmijë nuk kanë mundësi të sqarojnë se çka në fakt u ka ndodhur. Gjithashtu, qendrat përballen me mungesën e kuadrit specialist, i cili do të specializohet në fusha të caktuara, përkatësisht kanë vëllim të madh të punës, ndërsa numër të vogël të të punësuarve.

Gjykatat dhe prokuroritë publike punojnë me viktimat dhe kryerësit e identifikuar paraprakisht dhe kanë bashkëpunim të mirë me organet dhe institucionet relevante, por në seancat e tyre nuk ka pasur të pranishëm pedagogë dhe psikologë edhe pse një gjë e tillë është e nevojshme. Prokuroritë publike, përveç mungesës së mjeteve financiare nuk kanë probleme tjera, por vlerësojnë se nevojiten trajnime të vazhdueshme për të gjithë personat të cilët punojnë me fëmijë, në veçanti me fëmijë-viktima.

Sipas profesionistëve të shkollave më së shpeshti rastin e denoncojnë prindërit ose ndonjëri nga mësimdhënësit, edhe atë në bazë të sjelljes së fëmijës, por vlerësojnë se duhet të ketë komunikim më të madh dhe më të mirë ndërmjet nxënësit-mësimdhënësit-prindit dhe shërbimit pedagogjik-psikologjik në shkollë.

Institucionet shëndetësore mbajnë evidencë në bazë ditore për të gjithë pacientët, por evidencë të veçantë në rast të fëmijëve-viktima të abuzimit seksual nuk mbajnë dhe nuk kanë në dispozicion të dhëna të tilla. Kjo nuk paraqet një praktikë pozitive, për shkak se institucionet shëndetësore duhet t'i evidentojnë këto raste dhe t'i denoncojnë në institucione tjera kompetente për ndihmë dhe mbrojtje të mëtutjeshme të fëmijëve-viktima. Në veçanti, institucionet shëndetësore si problem e theksojnë mungesën e mjeteve financiare, sidomos sa i përket ekzaminimit dhe ekspertizës, për shkak se të njëjtat vështirë mund t'i arkëtojnë dhe kanë probleme se kush do ta paguajë kompensimin për punën e kryer.

Marrë në përgjithësi të gjithë pjesëmarrësit në intervistat e fokus-grupeve konsiderojnë se shteti duhet të sigurojë resurse përkatëse (financiare dhe njerëzore). Ministria për Punë dhe Politikë Sociale duhet të sigurojë programe të disponueshme dhe efektive për parandalim, për shërim, rehabilitim dhe riintegrim të të gjithë fëmijëve-viktima të abuzimit seksual. Duhet të hartohet program i masave dhe aktiviteteve për mbrojtjen e viktimave të abuzimit seksual, i cili duhet të përfshijë inkorporimin e shërbimeve këshillëdhënëse, strehimore, si dhe qendra ditore për punë me viktimat dhe prindërit e tyre.

INTERVISTA TË DETAJUARA ME FËMIJË – VIKTIMA TË EKSPLOATIMIT SEKSUAL DHE ABUZIMIT SEKSUAL DHE KONSTATIME (STUDIME TË RASTIT)

Studimi i rastit 1

Viktima ka jetuar së bashku me prindërit të cilët kanë qenë me arsim të ulët dhe në gjendje të pasigurt ekonomike. Që në fillim të ditëve adoleshente, ka qenë mjaft rebele dhe është futur në situata të rrezikshme dhe akoma pa mbushur 16 vjeç, nën ndikimin e një gruaje më në moshë, nga qyteti i njëjtë, ka filluar ta shes trupin e saj për para. Pastaj, në



moshën 17 vjeç ka ikur nga shtëpia, si rrjedhojë e marrëdhënieve problematike në familje dhe dhunës në familje mbi nënën të cilën e ka ushtruar babai i viktimës. Pikërisht mosfunksionimi i marrëdhënieve midis anëtarëve të familjes e kanë detyruar viktimën ta braktisë shtëpinë dhe të shkojë në Shkup, me shpresë se aty do të gjejë ardhmëri më të mirë për veten e saj. Fill pas mbërritjes në Shkup i është afruar një njeri në moshë (taksist) dhe i ka ofruar punë në restorant. Nga momenti kur ka filluar të punojë si kameriere është abuzuar seksualisht nga pronari i restorantit, i cili pas një periudhe kohore të shkurtër ka filluar të gjejë edhe klientë të tjerë, miq të tij dhe e ka detyruar të ketë marrëdhënie seksuale me ta. Dy herë është përdhunuar në mënyrë të shumëfishtë nga pronari dhe dy miqtë e tij. Rasti është zbuluar kur policia, krejt rastësisht, e ka ndaluar atë dhe makronë e saj për tua kontrolluar dokumentet e udhëtimit. Në momentin e parë ajo nuk ka treguar asgjë, por pasi policia i ka ndarë në stacionin policor dhe i ka vendosur në ambiente të ndryshme, viktima e ka treguar tërë historinë e rastit të saj. Makroja është arrestuar menjëherë, ndërsa tre shokët e tij janë arrestuar gjatë disa ditëve të ardhshme. Për rastin është paraqitur kallëzim penal kundër të katërve dhe që të gjithë janë dënuar me dënim me burgim, të cilin vazhdojnë ta vuajnë.

Pas arrestimit, viktima është kthyer tek prindërit e saj dhe rasti është denoncuar në qendrën për punë sociale në qytetin ku jetonte dhe është dërguar për të biseduar me ekipin profesional. Edhe pse ishte i caktuar termini i takimit, ekipi profesional e pranoi në bisedë pas më shumë se katër orë dhe gjatë kësaj periudhe viktima e ka humbur besimin se ata do t'i ndihmojnë dhe do ta mbrojnë, ndërsa në mënyrë plotësuese edhe nga nëpunësit lokal policorë nuk ka pasur mbrojtje për të cilën ka pasur nevojë, dhe për këtë shkak ka vendosur që më të mos kontaktojë me ta. Mirëpo, pas një muaji nga denoncimi i rastit, me qëllim të sigurisë së saj është vendosur në qendrën (shelter) për viktima të trafikimit me njerëz në Shkup, ku ka qëndruar një vit e katër muaj dhe gjatë kësaj periudhe kohore, përveç mbështetjes psikologjike i është mundësuar ta përfundojë edhe arsimin e mesëm. Por, pas kthimit në vendin e lindjes për të ka pasur një periudhë e vështirë përplot me përgojime, akuzime dhe mospranim në mjedis, madje edhe nga shoqëria e deriatëhershme. Ka ngelur vetëm, pa miq për një periudhë kohe më të gjatë, por me mbështetjen e ekipit të qendrës shelter, me të cilin ka vazhduar rregullisht të jetë në kontakt, ia ka arritur t'i tejkalojë situatat e pakëndshme dhe të formojë rreth të ri të miqve. Por, edhe përkrah faktit se viktima i kishte kaluar disa traumat, dëshiron të largohet nga qyteti dhe të shkojë në Shkup ose në ndonjë qytet tjetër sepse do të ketë më shumë mundësi për ardhmëri më të mirë.

Nga biseda me viktimën mund të konstatohej se ajo nga pamja e jashtme është e rregullt, lë përshtypje se është e shqetësuar por megjithatë bashkëpunuese dhe bën përpjekje t'u përgjigjet të gjitha pyetjeve. Nga biseda fitohet përshtypje se edhe përkrah asaj që e ka përjetuar, viktima nuk ka mungesë të vetëbesimit në kontaktet sociale, por edhe pse tejet fragjile ajo agresivitetin e mban në formë latente, ka ndjenjë të rrezikimit dhe pasigurisë dhe nevojë të fuqishme për të qenë e pranuar nga mjedisi, por edhe prirje për t'u tërhequr në rastet nuk pranohet. Edhe më tej mendon se rrethanat ekzistuese janë të pakëndshme dhe ndihet e pafuqishme për të bërë diçka, në mënyrë që ta ndryshojë situatën në të cilën gjendet. Për këtë shkak dëshiron ta braktisë qytetin në të cilin jeton, ndonëse duke e pasur parasysh se integrimi i saj ka qenë i mirë në mjedis, ky vendim do të ishte kundërproduktiv për arsye se ekziston rreziku që përsëri të ekspozohet në përjetime dhe përvoja që shkaktojnë trauma.

Konstatim: Reagim i ngadaltë dhe joadekuat i qendrës për punë sociale në të cilën e ka humbur besimin se do t'i ndihmojë, në vend që pikërisht nga qendra ta sigurojë tërë ndihmën dhe mbrojtjen.

Studimi i rastit 2

Viktima ka lindur në një familje me pesë fëmijë. Ka jetuar me babanë dhe dy motrat e saj më të vogla, sepse para disa vitesh nëna e tyre kishte ndërruar jetë në aksident komunikacioni. I ati ishte i papunë tanimë disa vjet dhe në pjesën më të madhe të kohës ishte në gjendje të alkoolizuar. Midis anëtarëve të familjes asnjëherë nuk kishte pasur raporte të

afërta, e që padyshim i referohet gjendjes jostabile materiale dhe marrëdhënieve konfliktuoz të prindërve. Pas denoncimit të abuzimit, marrëdhëniet mes tyre janë përkeqësuar akoma më shumë dhe mbështetje e vetme e viktimës ka qenë nëna e saj. Ajo është akuzuar dhe gjykuar nga anëtarët e tjerë të familjes, sidomos nga motrat për atë që i ka ndodhur.

Përkatësisht, në moshën 15 vjeçare, viktimja është manipuluar dhe seksualisht është shfrytëzuar nga një person më në moshë, i cili ka qenë personalitet i njohur në qytetet. Pas një kohe, ai ka filluar t'i dërgojë edhe miqtë e tij për përmbushjen dhe kënaqjen e pasioneve seksuale me viktimën. Në këtë periudhë viktimja ka pranuar shumë kërcënime se do ta pësojë nëse i tregon dikujt se çka po ndodh me të. Abuzimi ka zgjatur thua se një vit, pas kësaj periudhe kohore viktimja ka vendosur që rastin ta denoncojë në polici, pa marrë parasysh pasojat. Megjithatë, pas denoncimit, nëpunësit policorë nuk i kanë besuar dhe e kanë akuzuar se po shpif kështu që nuk ka marrë kurrfarë mbrojtje e as ndihmë. Si rezultat i kësaj, ka vazhduar shfrytëzimi edhe disa muaj, kur ajo përsëri ka vendosur ta denoncojë abuzimin, me ç'rast ka pasur reagim nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe nga qendra për punë sociale. Për shkaqe sigurie viktimja është dërguar në Serbi tek farefisi i saj. Pas kthimit nga Serbia është vendosur në qendrën shelter për viktimja të trafikimit me njerëz, ku i është ofruar ndihmë psikologjike nga psikologu dhe i është mundësuar ta përfundojë arsimin e mesëm. Në këtë periudhë i vdes e ëma në aksident trafikun me çka viktimës në mënyrë plotësuese i përkeqësohet gjendja emocionale. Pas një viti ajo kthehet në shtëpi ku vazhdon agonja e saj për shkak të akuzimeve dhe gjykimeve nga motrat se ajo e ka turpëruar familjen.

Për shkaqe të njëjta nuk i ka vazhduar kontaktet me shoqërinë, ndërsa mungesën e miqve e ka kompensuar me gjetjen e partnerëve. Tani ajo bën punë praktike në një parukeri dhe bën përpjekje të fitojë mjete materiale për ta mbajtur familjen.

Procedura penale është hapur vetëm kundër kryerësit, i cili i pari e ka manipuluar dhe e ka detyruar të kryejë marrëdhënie seksuale. Në gjykim, të tjerët janë paraqitur vetëm si dëshmitarë, por nuk janë akuzuar e as dënuar. Kryerësi është dënuar, por akoma është në arrati dhe nuk e ka vuajtur dënimin e shqiptuar me burgim, ndërsa dëshmitarët kanë vazhduar të jetojnë në qytetin e njëjtë dhe viktimja i takon vazhdimisht në vendet ku qarkullon.

Nga biseda e zhvilluar me viktimën mund të konstatohet se ka nevojë të prezantohet si person i fuqishëm, e cila mund të luftojë vetë kundër botës. Por, është mjaft e shprehur ndjenja e pasigurisë dhe frikës për jetën e vet nga ajo që mund t'ia bëjnë njerëzit që janë të involvuar, e që nuk janë dënuar dhe akoma i takon. Si rezultat i kësaj përherë është në shoqëri të personave meshkuj të cilët duhet të kenë rolin e mbrojtësve të saj, edhe pse nuk ka nevojë për marrëdhënie intime me ta. Manifeston shenja të theksuara agresiviteti ndaj, të gjithëve dhe ka vetëbesim të ulët dhe frikë dhe për këtë shkak nuk inkurajohet për ta planifikuar ardhmërinë e saj. Përvoja e keqe e përjetuar dhe mospasja e mbështetjes, fillimisht nga familja, ka kontribuar që plotësisht ta humbas vetëbesimin në njerëz, ndërkohë që jeton në një vend të vogël ku pothuajse të gjithë njihen mes vete dhe rrethanat në të cilat ka vendosur të funksionojë e pamundësojnë ose së paku e ngadalësojnë riintegrimin e plotë në mjedisin ku jeton.

Konstatim: Pas kthimit të viktimës në familje nga ana e organeve kompetente nuk ka pasur kurrfarë ndihme dhe mbështetje e as trajtim për rehabilitim, dhe ky është shkak që ajo vazhdon të jetojë në frikë, pasiguri dhe pamundësi për t'u risocializuar dhe për tu përfshirë në mjedis.

Studimi i rastit 3

Fëmija-viktimë ka 13 vjet dhe është i gjinisë mashkullore. Ka lindur në familje me gjashtë fëmijë. Babai është dënuar me 12 vjet burgim për shkak të kontrabandës me drogë (tanimë gjashtë vjet e vuan dënimin), nëna është e varur nga droga, prind disfunksional, e papërgjegjshme dhe pa autoritet mbi fëmijët. Nga vëllezërit dhe motrat e njej vetëm vëllanë më të madh dhe njërin nga motrat sepse qysh në moshën e vogël është ndarë prej tyre dhe është vendosur në familje kujdestare. Fati i njëjtë i ka ndjekur edhe vëllezërit dhe motrat e tjerë. Nga kjo që u tha mund të vihet në përfundim se vitet e para të jetës i ka kaluar në



familje disfunkcionale në të cilën nuk ka marrëdhënie të afërta midis anëtarëve të saj, familja është me status të ulët social dhe me sjellje të rrezikshme të prindërve.

Sulmi seksual ka ndodhur në vitin 2009, kur fëmija ka pasur 10 vjet, në shkollën ku ka ndjekur mësimin. Më saktësisht, dy fëmijë meshkuj, nga klasat më të larta, në oborrin e shkollës me dhunë e kanë dërguar në toalet, në kabinetin për gjuhë angleze dhe organin seksual ia kanë vënë në gojë.

Veprim i njëjtë seksual ka ndodhur edhe një herë gjatë vitit të ardhshëm.

Për më tepër, dy fëmijët i janë kërcënuar se do ta pësojë keq nëse ia tregon dikujt këtë ndodhi. Por, edhe përkundër kërcënimeve, fëmija-viktimë, kur ka shkuar në shtëpi ndodhinë ia ka treguar fill e për pe prindit – kujdestar dhe së bashku e kanë denoncuar rastin në stacionin më të afërt policor. Për shkak se dy fëmijët kanë qenë të moshës nën 14 vjeç, nuk është hapur procedurë penale, por sanksionet e përcaktuara kanë qenë konform moshës së kryerësve. Nga ekipi, për sulm seksual mbi fëmijë, në Qendrën Ndërkomunale për Punë Sociale është zhvilluar bisedë këshillimore në të cilën fëmijës i është vënë në pah se ndodhitë e këtilla dhe të ngjashme duhet t'i denoncojë menjëherë tek prindi - kujdestari.

Vitin e ardhshëm, fëmija-viktimë nën ndikimin e shoqërisë së keqe, ka marrë pjesë në vjedhje dhe edhe pse pohonte se ka qenë i detyruar ta bëjë këtë, megjithatë i ka vuajtur pasojat e veprimit të tillë, përkatësisht është hequr nga familja kujdestare dhe është vendosur në IP për Përkujdesjen e Fëmijëve me Probleme Edukative – Sociale, ku qëndron akoma. Në vitin në vijim kishte bërë edhe tri vepra tjera më të vogla - vjedhje.

Nga biseda me fëmijën-viktimë u fitua përshtypja se është me pamje të rregullt fizike, i zhvilluar mirë për moshën e tij, ka të folme ekspresive të zhvilluar në mënyrë solide dhe është i socializuar. Bashkëpunues dhe u përgjigjet pyetjeve të parashtruara. Dëshiron të prezantohet me imazh të mirë por, kohë pas kohe, bën komente të kamufluara agresive të cilat vënë në dukje mllëfin e shtrydhur, sigurisht si pasojë e mungesës së komunikimit me familjen primare. Përvojën negative e ka shfrydhur thellë në vete, ndërsa qëndrimi në Ent i ka ndihmuar për t'u risocializuar dhe për të vendosur miqësi të reja. U beson njerëzve dhe ka relacione të afërta me dy fëmijë të Entit. Pasigurinë e tejkalon me planet për të ardhmen, edhe pse nuk investon shumë mund për t'i realizuar.

Konstatim: Nga analiza e rastit rezultojnë se bëhet fjalë për fëmijë-viktimë e cila vjen nga një familje disfunkcionale, përkatësisht se bëhet fjalë për fëmijë pa kujdes prindëror i cili për shkak të masave joadekuade dhe jo në kohë për rehabilitimin dhe risocializimin e tij, në vend që ta përmirësojë sjelljen e tij është shndërruar në delikuent dhe nuk stimulohet mjaftueshëm për të menduar pozitivisht për ardhmërinë edhe pse ka përmirësim pas vendosjes së tij në institucion.

Studimi i rastit 4

Fëmija-viktimë ka 14 vjet dhe jeton bashkë me nënën dhe vëllanë e vogël. Babai i ka braktisur kur ajo ka pasur 2 vjet dhe është larguar për të jetuar dhe punuar jashtë vendit. Fëmija-viktimë, nuk e mban mend fare babanë e vet biologjik. Nëna, pas dy vitesh rimartohet me njeri tjetër dhe që atëherë jetojnë në shtëpi të përbashkët në një parlagje të qytetit. Nëna është me arsim fillor dhe punon si pastruese, ndërsa njerku ka qenë me arsim të mesëm dhe ka punuar si punëtor ndërtimor. Në fillim, marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve kanë qenë të rregulluara dhe funksionale, por pas një periudhe të caktuar, është përkeqësuar komunikimi dhe janë ftohur marrëdhëniet. Fëmija-viktimë, qysh e vogël ka qenë një vajzë e turpshme dhe e tërhequr, e cila nuk ka pasur asnjë shoqe dhe kohën e ka kaluar me të ëmën e saj. Rasti i abuzimit seksual nga njerku është denoncuar para një viti nga ana e shoqes së saj të vetme, e cila gjithashtu është abuzuar seksualisht nga njerku i fëmijës-viktimë.

Ngjarja, të cilën e ka denoncuar shoqja e fëmijës-viktimë ka ndodhur në shtëpinë e fëmijës-viktimë, ku kanë qenë të dyja vogëlushet, me ç'rast njerku i viktimës është kthyer nga puna dhe i ka detyruar të dyja për marrëdhënie seksuale anale. Menjëherë porsa është

larguar nga shtëpia e shoqes, fëmijë-viktimë, ka shkuar në stacionin e parë policor dhe e ka denoncuar sulmin seksual. Atëherë, fëmija-viktimë e ka pranuar se njerku e ka detyruar në marrëdhënie seksuale anale që nga mosha e saj gjashtëvjeçare. Nëna ka deklaruar se në asnjë moment nuk ka dyshuar në asgjë. Kryerësi është arrestuar, ndërkaq është paraqitur edhe kallëzim penal, i cili akoma është në procedurë.

Në familje ka pasur edhe dukuri të dhunës në familje mbi fëmijët. Gjatë tre muajve të ardhshëm fëmija-viktimë shpeshherë ka ikur nga shtëpia dhe nuk është kthyer nga disa ditë. Disa herë, në bisedë me punonjësin social, i cili e ka mbajtur rastin e tyre, ajo ka thënë se nuk dëshiron të qëndrojë në shtëpi vetëm për shkak se shtëpia ia përkujton kujtimet e këqija. Së këtejmi, janë dërguar në Entin për Shëndet Mendor në bisedë me psikiatër për fëmijë. Janë këshilluar për ta ndërruar vendin e jetesës dhe i janë përshkruar medikamente për qetësim të cilat i ka ndërprerë pas dy muajsh, kur gjendja i është stabilizuar pak.

Pak kohë pas denoncimit të sulmit seksual nga njerku, ka filluar të takohet me një djalë shtatë vjet më të madh, me të cilin që nga fillimi ka qenë intime edhe atë në mënyrën e vetme të cilën e ka pasur të njohur, marrëdhënie seksuale anale. Ka pasur besim tek "i dashuri" dhe ai e mbështeste gjatë gjithë procesit. Familjet e të dyja palëve nuk i jepnin pëlqim lidhjes së tyre për shkak të përkatësive të ndryshme fetare. Përjashtim bënte nëna e cila e pranonte lidhjen duke mos gjetur mënyrë tjetër për ta mbajtur vajzës pranë vetes. Nga ana e policisë është paraqitur kallëzim penal edhe kundër "të dashurit" të fëmijës-viktimë për shkak të veprimeve seksuale me person më të ri se 14 vjeç, edhe pse ajo kishte deklaruar se kjo ka ndodhur me pëlqimin e saj. Në intervistë ka marrë pjesë edhe e ëma duke mos i lënë hapësirë fëmijës për ta treguar mendimin dhe ndjenjat e veta, duke u përgjigjur në emër të saj me justifikimin se ajo gjithsesi di çdo gjë që i ka ndodhur vajzës dhe se janë shumë të afërta.

Nga biseda u fitua përshtypja se fëmija është e tërhequr, edhe pse pa kundërshtim u përgjigjej pyetjeve. Mungesa e prindit mashkull, qysh në vitet e para, tek ajo ka shkakuar ndjenjën e të braktisurit dhe vlerës më të vogël që ka lidhje me ndjenjën e turpit për shkak të dallimeve me fëmijët e tjerë. Me partnerin e saj, më të madh në moshë, e plotëson figurën mashkullore të viteve të vegjëlisë. Gjithashtu, duke u rritur me nënën, e cila është sjellë në mënyrë tejet mbrojtëse ndaj saj, nuk i ka lejuar të ketë mendim dhe qëndrim të vet për punët që kanë ndodhur, gjë që ka ndikuar që ajo të tërhiqej akoma më shumë në vetvetë dhe të mos tregojë asgjë nëse nuk i shtrohen pyetje. Kjo e sqaron edhe heshtjen shumëvjeçare të abuzimit nga ana e njerikut. Qetësia e kamufluar dhe pamja e qetë e fytyrës në momente të caktuara vënë në pah zemërimin dhe tërbimin të cilin e ka ndrydhur thellë në vetë.

Konstatim: Edhe nga ky rast rezulton se bëhet fjalë për familje disfunktionale, përkatësisht për fëmijë që jeton vetëm me njërin prind biologjik dhe njerkun, i cili jo vetëm atë por edhe fëmijën tjetër e ka abuzuar seksualisht edhe atë mbi fëmijën-viktimë këtë e ka bërë qysh në moshën e vegjëlisë, ndërsa fëmija nuk ka guxuar t'i tregojë askujt. Edhe në rastin konkret mungon puna me fëmijën me qëllim të rehabilitimit dhe risocializimit për shkak se është futur në lidhje tjetër seksuale edhe pse nuk ka mbushur as moshën 14 vjeçare. Për fat të keq, një gjë të tillë e lejon nëna e saj, në vend që ajo dhe qendra për punë sociale të ndër marrin masa për përmirësimin e gjendjes dhe pengimin e fëmijës që edhe më tej të jetë viktimë e dikujt. Për këtë shkak nevojitet punë psiko-terapeutike për tejkalimin e ndjenjave negative tek fëmija por punë edhe me nënën.

Studimi i rastit 5

Fëmija-viktimë ka 14 vjet, ka lindur në familje me dy vëllezër më të mëdhenj prej të cilëve vetëm njëri jeton në bashkë me to. Vëllai më i madh është i varur nga droga dhe tanimë një periudhë më të gjatë kohore është në mjekim në një nga institucionet për trajtimin e varësive nga substancat psikotrope. Nëna u ka vdekur kur fëmija-viktimë ka pasur 5 vjet, ndërsa babai është rimartuar një vit më vonë. Edhe pse ai tanimë një herë ka qenë i dënuar për abuzim (përdhunim) seksual të mbesës së tij, për çka është denoncuar në polici nga ana e bashkëshortes dhe ka vuajtur dënim me burgim, megjithatë pas vdekjes së saj e ka fituar



kujdestarinë mbi të bijën. Anëtarët e familjes vazhdimisht u janë ekspozuar dhunës fizike dhe kërcënimeve nga ana e babait, sidomos në situata kur ka qenë në gjendje të alkoolizuar dhe të cilat kanë qenë shumë të shpeshta. Për shkak të marrëdhënieve të parregulluara dhe konfliktuozë familjare dhe mosfunksionimit të familjes, pas vdekjes së nënës, fëmija-viktimë shfaq shenja të pa dëgjueshmërisë dhe mosbesimit tek të rriturit.

Akti seksual ka ndodhur kur fëmija ka pasur 13 vjet. Atë natë, fëmija ka qenë bashkë me njerkin në shtëpi kur ka mbërritur babai në gjendje shumë të alkoolizuar. Me forcë e ka nxjerrë nga shtëpia, me pretekstin se dëshiron të shëtisin bashkë. Me makinë e ka dërguar në një vend të braktisur në afërsi të para-lagjes në të cilën jetojnë dhe me dhunë ia ka zhveshur pantallonat dhe mbi të disa herë ka kryer akt seksual. Ajo që i kujtohet është se ka ndërjerë dhimbje. Menjëherë pas kësaj e ka dërguar tek "mamia" për ta kontrolluar me këtë rast duke sqaruar se vajza ka qenë shumë e lirë me djem.

Kur janë kthyer në shtëpi fëmija e ka shfrytëzuar momentin e parë të përshtatshëm për të ikur nga shtëpia duke u drejtuar tek xhaxhai i saj. Por, ata e kanë përzënë me mosbesim dhe prandaj ka vendosur që vet ta denoncojë rastin në polici. Pas denoncimit të rastit babai është arrestuar dhe kundër tij është paraqitur kallëzim penal. Thua se pas një viti të kaluar në paraburgim, është dënua me 12 vjet burgim. Fëmija-viktimë mendon se babai i saj e ka sulmuar për shkak se ajo ngjan shumë me të ëmën e ndërjerë. Kujdestarinë mbi fëmijën e ka marrë Qendra Ndërkomunale për Punë Sociale dhe ajo është vendosur në IP për Përkujdesjen e Fëmijëve me Probleme Edukative-Sociale. Vetëm një javë pas qëndrimit në institucion ajo ka ikur dhe është kthyer në shtëpi tek njerka. Pastaj përsëri është kthyer dhe përsëri ka ikur. Sjellja e këtillë përsëritet gjatë gjithë vitit derisa ka qenë e vendosur aty. Edhe pse për momentin nuk është në Ent, ajo zyrtarisht akoma udhëhiqet si fëmijë me probleme sociale edukuese, e përkujdesur në këtë institucion publik. Në periudhën derisa ka qenë e vendosur në ent disa herë ka shfaqur sjellje të rrezikshme dhe është arrestuar për kryerje të veprës kriminale - vjedhje.

Nga biseda e zhvilluar u fitua përshtypja se fëmija-viktimë nuk ka pranuar ndihmë dhe mbështetje të cilën e ka pasur të nevojshme për periudhën kur ka qenë në gjendje më vulnerable. Edhe pse kryerësi është arrestuar dhe dënua me dënim me burgim shumëvjeçar, fëmija nuk ka arritur ta tejkalojë traumën e përjetuar. Kjo ka kontribuar të vazhdojë me sjelljen delikuede duke u shoqëruar me shoqëri të rrezikshme. Ka nevojë për hakmarrje për atë që i ka ndodhur dhe këtë e manifeston përmes sjelljes së saj. Nuk ka besim tek njerëzit dhe nuk dëshiron të ketë kontakte të afërta me rrethin. Kthehet në familjen primare për të fituar mbështetje dhe për ta zvogëluar dhimbjen që ndjen duke e ndarë me njerëzit e vetëm të cilët i konsideron të afërm.

Konstatim: Sikurse edhe në rastet paraprake edhe në këtë rast bëhet fjalë për fëmijë pa kujdes adekuat prindëror, ndërsa institucionet kompetente nuk kanë ndërmarrë masa për kapërcimin e traumave dhe për risocializimin dhe rehabilitimin e fëmijës-viktimit, e cila është bërë edhe delikuede në vend që ta përmirësojë sjelljen e vet. Për këtë shkak, rekomandohet të fillohet me trajtim afatgjatë psikologjik për tejkalimin e përvojës traumatike.

REKOMANDIME

Nga të gjitha rastet e analizuara, pakontestueshëm rezultojnë se fëmijët-viktima janë nga familje disfunkionale, pa kujdes adekuat prindëror dhe se organet kompetente nuk ndërmarrin masa përkatëse për parandalim, sidomos për rehabilitimin dhe risocializimin e fëmijëve-viktima, por i lëshojnë të gjendet si dinë vet, kështu që shndërrohen në delikuent. Së këtejmi rekomandimi themelor është se qendrat, para së gjithash, duhet të veprojnë në mënyrë parandaluese me qëllim që të pengohen abuzimet e këtilla të fëmijëve, të sigurojnë mbrojtje adekuate, kur më fëmijët janë bërë viktima. Është veçanërisht me rëndësi që me këta fëmijë dhe me familjet e tyre të punohet në drejtim të rehabilitimit të tyre adekuat, në mënyrë që të mbrohen nga abuzimet e më tutjeshme dhe ta përmirësojnë sjelljen e tyre me qëllim që të mos bëhen delikuent.

TË DHËNA STATISTIKORE SIPAS PYETËSORËVE NGA ORGANET KOMPETENTE

GJYKATA THEMELORE

Vepra penale	Numri i përgjithshëm i fëmijëve-viktima të eksploatimit seksual					Kryerës të veprës penale të moshës madhore														
						Paraqitja e kallëzimit penal					Ngritja e aktakuzës					Të dënuar				
	2008	2009	2010	2011	Gjithsej	2008	2009	2010	2011	Gjithsej	2008	2009	2010	2011	Gjithsej	2008	2009	2010	2011	Gjithsej
Përdhunim	10	6	10	3	29	7	4	7	2	20	19	11	12	6	48	12	7	11	5	35
Akt seksual (mbi person të pamundur)	2	3	3	4	12	1	2	3	2	8	4	3	4	2	13	6	2	3	1	12
Sulm seksual mbi fëmijë	13	21	33	14	81	6	8	22	8	44	13	22	40	13	88	15	16	32	9	72
Akt seksual me keqpërdorim të pozitës	2	4	3	1	10	1			1	2	1	1	2	1	5		1	2		3
Kënaqje e epsheve seksuale para fëmijës	4	2	2	2	10		1	2	1	4	1	3	2	1	7	1	1	2	1	5
Ndërmjetësim gjatë kryerjes së prostitucionit		5	1		6		4	1		5		4	3		7		4	3		7
Manipulim dhe mundësim të marrëdhënies seksuale me fëmijë		1	2	3	6		1		1	2	2	4	7	3	16	2	4	7	1	14
Shfaqje e materialit pornografik fëmijës	3		1		4	1		1		2	2		1		3	1		1		2
Prodhim dhe shpërndarja e pornografisë së fëmijëve përmes sistemit kompjuterik				1	1														1	1
Incest		1	3	1	5	1	4	5	1	11	1	4	5	1	11	1	4	5		10
Bashkësi jashtëmartesore me të mitur	3	15	5	5	28	2	12	10	5	29	2	12	11	1	26	2	11	13	4	30
Futja në prostitucion për shkak të neglizhencës nga ana e prindërve																				
Eksploatim seksual - trafikim me fëmijë																				
Gjithsej:	37	58	63	34	192	19	36	51	21	127	45	64	87	28	224	40	50	79	22	191

*Numri i përgjithshëm i fëmijëve -viktima sipas pyetjes së përgjithshme (2) - 236, që nuk i përgjigjet numrit sipas tabeleve të pyetësorit

Persona të dënuar të moshës madhore sipas veprës penale dhe sanksioni	Burgim				Dënim me para				I shpallur fajtor, por i liruar nga dënimi				Masa alternative Dënim me kusht				Lloj tjetër i masave alternative				Masa sigurie				
	2008	2009	2010	2011	Gjithsej	2008	2009	2010	2011	Gjithsej	2008	2009	2010	2011	Gjithsej	2008	2009	2010	2011	Gjithsej	2008	2009	2010	2011	Gjithsej
Përdhunim	19	7	7	5	38							1		1	2	1	1		4					1	1
Akt seksual (mbi person të pamundur)	3	2	3		8												1	1						1	1
Sulm seksual mbi fëmijë	13	12	31	8	64				1	1	3			3	1			1	1				1	2	4
Akt seksual me keqpërdorim të pozitës		1			1										1				1				1		1
Kënaqje e epsheve seksuale para fëmijës		1	1		2		1			1					1				1						
Ndërmjetësim gjatë kryerjes së prostitucionit	1	4	4		9										1				1						
Manipulim dhe mundësim të marrëdhënies seksuale me fëmijë	2	4	7	1	14										3				3						
Shfaqje e materialit pornografik fëmijës	1		1		2																				
Prodhim dhe shpërndarja e pornografisë së fëmijëve përmes sistemit kompjuterik																									
Incest		1	1		2																				
Bashkësi jashtëmartesore me të mitur	3	2	1		6		1	1		2					3	10	15	3	31						
Futja në prostitucion për shkak të neglizhencës nga ana e prindërve																									
Eksploatim seksual - trafikim me fëmijë																									
Gjithsej:	39	35	57	15	146	2	1	1	4	3	1	4	6	12	21	4	43	1	1	2	3	1	3	7	



PROKURORI THEMELORE PUBLIKE

Vepra penale	Numri i përgjithshëm i fëmijëve-viktima të eksploatimit seksual					Kryerës të veprës penale të moshës madhore														
						Paraqitja e kallëzimit penal					Ngritja e aktakuzës					Të dënuar				
	2008	2009	2010	2011	Gjithsej	2008	2009	2010	2011	Gjithsej	2008	2009	2010	2011	Gjithsej	2008	2009	2010	2011	Gjithsej
Përdhunim	11	7	3	4	25	26	33	21	14	94	23	19	9	5	56	21	8	4	6	39
Akt seksual (mbi person të pamundur)		2	1	1	4	5	6	3	2	16	2	6	3	1	12	1	4	1		6
Sulm seksual mbi fëmijë	33	36	39	25	133	37	40	46	31	154	22	31	35	16	104	25	23	16	20	84
Akt seksual me keqpërdorim të pozitës			1	2	3	2	2		1	5		2		1	3				1	1
Kënaqje e epsheve seksuale para fëmijës	7	6	1	5	19	10	5	2	3	20	5	4	2	2	13	5	3	2		10
Ndërmjetësim gjatë kryerjes së prostitucionit	1	5	1	2	9	2	6	3	2	13	1	5	1		7		4	1		5
Manipulim dhe mundësim të marrëdhënies seksuale me fëmijë	5	1	1	3	10	5	4	3	4	16	4	3	1	3	11	1	2	1	1	5
Shfaqje e materialit pornografik fëmijës		5	1	2	8	1	2	1	2	6		2			2		1			1
Prodimi dhe shpërndarja e pornografisë së fëmijëve përmes sistemit kompjuterik		1	1	1	3		7			7		6			6		1			1
Incest	3	7	3	1	14	1	3	1	1	6	1	1		1	3		1			1
Bashkësi jashtëmartesore me të mitur	9	29	27	16	81	12	38	44	14	108	9	30	28	9	76	8	27	24	9	68
Futja në prostitucion për shkak të neglizhencës nga ana e prindërve			2	1	3	2		1	1	4			1		1			1		1
Eksploatim seksual - trafikim me fëmijë																				
Gjithsej:	69	99	81	63	312	103	146	125	75	449	67	109	80	38	294	61	74	50	37	222

*Numri përgjithshëm i fëmijëve-viktima sipas pyetjes së përgjithshme (2) - 302 që nuk i përgjigjet numrit sipas tabelave të Pyetësorit.

Persona të dënuar të moshës madhore sipas veprës penale dhe sanksioni	Burgim					Dënim me para					I shpallur fajtor, por i liruar nga dënimi					Masa alternative Dënim me kusht					Lloj tjetër i masave alternative					Masa sigurie				
	2008	2009	2010	2011	Gjithsej	2008	2009	2010	2011	Gjithsej	2008	2009	2010	2011	Gjithsej	2008	2009	2010	2011	Gjithsej	2008	2009	2010	2011	Gjithsej	2008	2009	2010	2011	Gjithsej
Përdhunim	17	8	6	6	37					0					0	2		1		3										
Akt seksual (mbi person të)	2	2	2		6					0					0		2		1	3					0					
Sulm seksual mbi fëmijë	23	23	15	19	80					0					0		2			2		1			1	2	1			3
Akt seksual me keqpërdorim të pozitës		1		1	2					0					0	1				1										
Kënaqje e epsheve seksuale para fëmijës		5	2		7		1			1																				
Ndërmjetësim gjatë kryerjes së prostitucionit		3	1		4		1			1								1		1								1		1
Manipulim dhe mundësim të marrëdhënies seksuale me fëmijë	2	5	1		8					0																				
Shfaqje e materialit pornografik fëmijës		2			2					0																				
Prodimi dhe shpërndarja e pornografisë së fëmijëve përmes sistemit kompjuterik					0					0																				
Incest		1			1					0																				
Bashkësi jashtëmartesore me të mitur	3	7	1	6	17		2		1	3						6	16	20	3	45	2	2	1		5					
Futja në prostitucion për shkak të neglizhencës nga ana e prindërve			1		1					0																				
Eksploatim seksual - trafikim me fëmijë					0					0																				
Gjithsej:	47	57	29	32	165	4			1	5						9	20	22	4	55	0	3	2	1	6	2	2	1	1	4

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME – SEKTORËT PËR PUNË TË BRENDSHME

Vepra penale	Numri i përgjithshëm i fëmijëve-viktima të eksploatimit seksual					Gjinia e viktimave të eksploatimit seksual								Paraqitja e kallëzimit penal					Numri i të dyshuarve					Numri i veprave penale të kryera					
						2008		2009		2010		2011																	
	2008	2009	2010	2011	Gjithsej	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	2008	2009	2010	2011	Gjithsej	2008	2009	2010	2011	Gjithsej				
Përdhunim	14	14	10	6	44	7		12	1	7	2	5			6	13	9	4	32	9	17	10	2	38	9	13	8	4	34
Akt seksual (mbi person të pamundur)	1	4	1	1	7	1		2	1	3					1	3	3	1	8	1	3	3	1	8	1	4	4	1	10
Sulm seksual mbi fëmijë	35	34	36	22	127	31	9	35	6	29	10	19	4	38	41	39	21	139	47	48	46	21	162	37	39	41	20	137	
Akt seksual me keqpërdorim të pozitës		1			1	6		1							2	1			3	2	1		3	2	1			3	
Kënaqje e epsheve seksuale para fëmijës	21	7	17		45	11	6	5		10	1				9	4	4		17	10	2	3	15	8	3	11		22	
Ndërmjetësim gjatë kryerjes së prostitucionit	1	1			2	1		1							6	1	1		8	11	2	2	15	6	1	2		9	
Manipulim dhe mundësim të marrëdhënies seksuale me fëmijë	4	1			5	4		1				1		3	1				4	7	1		8	3	1			4	
Sfaqje e materialit pornografik fëmijës	1	2	2	1	6	1		2		2		1	1	1	1	2	1	5	1	1	2	1	5	1	1	2	1	5	
Prodhim dhe shpërndarja e pornografisë së fëmijëve përmes sistemit kompjuterik					1	1							1		1			1	2		1	1	2	1			1	2	
Incest	3	3	3	1	10	2	1	2		1		1		4	3	3	1	11	3	3	3	1	10	4	3	3	1	11	
Bashkësi jashtëmartesore me të mitur	18	20	16	16	70	18		18		16		16		20	23	16	19	78	21	27	16	17	81	19	25	16	16	76	
Futja në prostitucion për shkak të neglizhencës nga ana e prindërve						1		3		3																			
Eksploatim seksual - trafikim me fëmijë	3			1	4	3						1																	
Gjithsej:	101	87	85	49	322	86	16	82	8	71	13	43	7	90	92	77	48	307	112	106	86	43	347	91	91	87	44	313	

*Numri i përgjithshëm i fëmijëve-viktima, sipas pyetjes së përgjithshme (2), nuk është dhënë përgjigje nga të gjithë sektorët e Ministrisë dhe nuk mund të krahasohet nëse numri përgjigjet me të dhënat e prezantuara në tabela.

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME - BYROJA PËR SIGURI PUBLIKE

Vepra penale	Numri i përgjithshëm i fëmijëve-viktima të eksploatimit seksual					Gjinia e viktimave të eksploatimit seksual								Paraqitja e kallëzimit penal					Numri i të dyshuarve					Numri i veprave penale të kryera					
						2008		2009		2010		2011																	
	2008	2009	2010	2011	Gjithsej	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	2008	2009	2010	2011	Gjithsej	2008	2009	2010	2011	Gjithsej				
Përdhunim																													
Akt seksual (mbi person të pamundur)																													
Sulm seksual mbi fëmijë	58	58	64	45	225	48	10	49	9	49	15	37	8							61	61	71	44	237	52	53	61	40	206
Akt seksual me keqpërdorim të pozitës	5				5	5									2					2									
Kënaqje e epsheve seksuale para fëmijës	14	7	10	3	34	8	6	2	5	9	1		3		1	3	10	2	16	11						10	2	23	
Ndërmjetësim gjatë kryerjes së prostitucionit																													
Manipulim dhe mundësim të marrëdhënies seksuale me fëmijë	9	3	1	6	19	9		3		1		4	2							13	3	2	7	25	9	3	1	5	18
Sfaqje e materialit pornografik fëmijës	4	2	7	16	29	2	2	2		4	3	3	13		2	2	4	9	17	3	2	4	8	17					
Prodhim dhe shpërndarja e pornografisë së fëmijëve përmes sistemit kompjuterik				2	2					2										2				2			2	2	
Incest	2	2	3		7	2		2		3					2	1	1		4	2	1	1	4	2	1	1	4		
Bashkësi jashtëmartesore me të mitur	21	39	35	26	121	20	1	1	38	34	1	24	2		25	47	47	30	149	21	39	34	46	140					
Futja në prostitucion për shkak të neglizhencës nga ana e prindërve																			0										
Eksploatim seksual - trafikim me fëmijë	11	4	5	6	26	11		4		5		6			21	12	12	28	73	9	6	3	5	23					
Gjithsej:	124	115	127	102	468	105	19	63	52	107	20	74	28		127	131	147	120	525	107	104	116	106	433					



QENDRA PËR PUNË SOCIALE

Vepra penale	Numri i përgjithshëm i fëmijëve-viktima të eksploatimit seksual					Gjinia e viktimave të eksploatimit seksual								Statusi arsimor i viktimave të abuzimit seksual				
						2008		2009		2010		2011		Arsimi fillor		Arsimi i mesëm		
	2008	2009	2010	2011	Gjithsej	F	M	F	M	F	M	F	M	Ndjekin	Nuk ndjekin	Ndjekin	Nuk ndjekin	
Përdhunim	1	1	3	2	7	1				1	1	2	2		3	2	1	1
Akt seksual (mbi person të pamundur)	4	5	5	4	18	4		5		5		4	1	5	1			
Sulm seksual mbi fëmijë	46	40	28	24	138	33	11	34	6	18	10	10	5	29	9	4	2	
Akt seksual me keqpërdorim të pozitës	1	5	1	4	11	1		2	1		2	4		4		4		
Kënaqje e epsheve seksuale para fëmijës	4	2	2	5	13	2	2	3	1		2	3	2	6	2			4
Ndërmjetësim gjatë kryerjes së prostitucionit																		
Manipulim dhe mundësim të marrëdhënies seksuale me fëmijë	1	8	4	3	16	1		8	2	4		3	1	6	8	1	5	
Shfaqje e materialit pornografik fëmijës			2	2	4					1	2	2	2	4	1			
Prodhim dhe shpërndarja e pornografisë së fëmijëve përmes sistemit kompjuterik				2	2													
Incest			5	3	8					5		2						1
Bashkësi jashtëmartesore me të mitur		5	3	8	16			5		3		8			3	2	4	
Futja në prostitucion për shkak të neglizhencës nga ana e prindërve	1		3		4							3			1	2	1	
Eksploatim seksual - trafikim me fëmijë	1	1	2	2	6	1		1		2		2		1		2	1	
Gjithsej:	59	67	58	59	243	43	13	58	11	39	18	43	11	58	27	16	19	

Mosha e fëmijës	2008	2009	2010	2011	Gjithsej
0 - 3 vjeç			1	1	2
4-7 vjeç	5	4	3	2	14
7-10 vjeç	5	5	2	2	14
10-14 vjeç	12	13	17	14	56
14-16 vjeç	9	7	6	16	38
16 -18 vjeç	1		4	11	15
Gjithsej	32	29	33	33	

Nacionaliteti i viktimës					
	2008	2009	2010	2011	Gjithsej
Maqedonas	33	37	27	28	125
Romë	22	21	17	18	78
Turq		2	1	3	6
Shqiptarë	1	8	9	3	21
Egjiptianë		1			1
Gjithsej	56	68	54	52	

ORGANIZATA JOQEVERITARE

Vepra penale	Numri i përgjithshëm i fëmijëve-viktima të eksploatimit seksual					Gjinia e viktimave të eksploatimit seksual								Statusi arsimor i viktimave të eksploatimit seksual			
						2008		2009		2010		2011		Arsimin fillor		Arsimin e mesëm	
	2008	2009	2010	2011	Gjithsej	F	M	F	M	F	M	F	M	Ndjekin	Nuk e ndjekin	Ndjekin	Nuk e djekin
Përdhunim					0												
Akt seksual (mbi person të pamundur)					0												
Sulm seksual mbi fëmijë	2	4	3	1	10	2		3	1	2	1	1		7		1	
Akt seksual me keqpërdorim të pozitës			1		1						1			1			
Kënaqje e epsheve seksuale para fëmijës					0												
Ndërmjetësim gjatë kryerjes së prostitucionit		1		1	2			1				1		1		1	
Manipulim dhe mundësim të marrëdhënies seksuale me fëmijë		1	2		3			1		2				1	1		
Shfaqje e materialit pornografik fëmijës			3	1	4						2						
Prodhimi dhe shpërndarja e pornografisë së fëmijëve përmes sistemit kompjuterik					0					1		1					
Incest					0												
Bashkësi jashtëmartesore me të mitur	5	8	7	2	22	5		8		5	2	2			20 (13 e kanë ndërprerë)	1	
Futja në prostitucion për shkak të neglizhencës nga ana e prindërve	1				1	1								1			
Eksploatim seksual - trafikim me fëmijë	7	4	8	2	21	7		4		8		2		2	7	5	7
Gjithsej:	15	18	24	7	64	15		17	1	18	6	7		13	8	8	7

Mosha e fëmijës	2008	2009	2010	2011	Gjithsej
0 - 3 vjeç			2		2
4-7 vjeç	1	2	2		5
7-10 vjeç		5		1	6
10-14 vjeç	2	3	5		10
14-16 vjeç	9	9	8	4	30
16 -18 vjeç	3	4	7	1	15
Gjithsej	15	23	24	6	

Nacionaliteti i viktimës					
	2008	2009	2010	2011	Gjithsej
Maqedonas	4	7	16	2	29
Romë	5	5	1	1	12
Shqiptarë	3	2	1	2	8
Boshnjakë		1	1		2
Të tjerë					
Gjithsej	12	15	19	5	

*Numri i përgjithshëm i fëmijëve-viktima sipas pyetjes së përgjithshme (2), nuk është dhënë përgjigje nga të gjitha organizatat joqeveritare dhe nuk mund të bëhet krahasimi nëse numri përgjigjet me të dhënat e prezantuara në tabelë.



KONSTATIME NGA TREGUESIT STATISTIKORË

Nga të dhënat e **gjykatave dhe prokurorive publike**, rezulton se:

- vepra penale më e shpeshtë e abuzimit seksual të fëmijës është "Dhunimi seksual mbi fëmijë", pastaj vijon "Përdhunimi" dhe "Bashkësia jashtëmartesore me të mitur". Rrjedhimisht, për numrin më të madh të veprave penale të cekura paraprakisht, më i madh është edhe numri i kallëzimeve penale të paraqitura në lidhje me të njëjtat, si dhe numri më i madh i personave që janë dënuar për këto vepra. Dënimi më i shpeshtë është dënimi me burgim, gjë që është pozitive, por për këto vepra janë shqiptuar edhe dënime me para, masa alternative dhe masa për siguri, edhe pse në numër të pakonsiderueshëm.

Është karakteristike se gjykatat dhe prokuroritë publike nuk kanë denoncuar asnjë vepër penale për trafikim me fëmijë, edhe pse sipas informatave një numër i madh i viktimave të kësaj vepre janë të mitur. Megjithatë, shifrat, të cilat i kanë dhënë gjykatat dhe prokuroritë publike, dallojnë shumë, si nga aspekti i veprave penale, kallëzimeve penale të paraqitura dhe personave të dënuar, e që mund të nxirret konkluzioni se nuk mbahet evidencë e drejtë dhe adekuate, sidomos në gjykata, sepse aty vërehen dallimet më të mëdha në aspekt të të dhënave nga prokuroritë publike, por edhe në aspekt të të dhënave të policisë. Në lidhje me të dhënat e prokurorive publike dhe policisë ato janë përafërsisht të njëjta me disa dallime të vogla.

Sa i përket gjinisë së viktimave, nga të dhënat e policisë, qendrat për punë sociale dhe organizatat joqeveritare, rezulton se shumë më i madh është numri i fëmijëve-viktima femra. Më së shpeshti viktima janë fëmijët nën moshën 14 vjeç deri në moshën 16 vjeç dhe se numri më i madh i viktimave janë të bashkësisë etnike maqedonase dhe rome. Në veçanti shqetëson numri i madh i fëmijëve-viktima të popullatës rome, nëse merret parasysh numri i përgjithshëm i popullatës rome që jeton në Republikën e Maqedonisë krahasuar me numrin e bashkësive tjera etnike, me ç'rast mund të nxirret përfundimi se fëmijët romë janë viktimat më të shpeshta. Po ashtu, nga të dhënat pakontestueshëm mund të konstatohet se më së shpeshti viktimat janë me arsim fillore ose pa arsim të përfunduar fillor.

STANDARDE, STRATEGJI, PLAN VEPRIME, PROGRAME, PROTOKOLLE

Me qëllim të mbrojtjes së fëmijëve nga eksploatimi seksual dhe abuzimi seksual, detyrimisht duhet të miratohen programe përkatëse sociale dhe fëmijëve-viktima dhe familjeve të tyre t'u ndihmojë ekipi multidisiplinar (Neni 11 i Konventës), por duke e respektuar privatësinë, konfidencialitetin dhe mundësinë për qasje deri në shërbime dhe linja përkatëse për kontakte për ndihmë dhe këshilla për ata që i denoncojnë abuzimet e këtilla të fëmijëve (Neni 13 i Konventës).

Në Republikën e Maqedonisë janë miratuar plan veprime, programe, protokolle, standarde dhe norma për parandalim, mbrojtje dhe trajtim të fëmijëve-viktima të abuzimit seksual.

Procedura standarde operative për trajtimin e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore

Procedurat Standarde Operative janë vendosur me qëllim që të sigurohet mbështetje dhe mbrojtje e të gjitha viktimave të trafikimit me qenie njerëzore, përmes qasjes gjithëpërfshirëse, e cila bazohet në të drejtat e njeriut dhe fokusohet tek viktimat përmes kornizës

së institucionalizuar për bashkëpunim. Masat e Procedurave Standarde Operative i përfshijnë fushat si vijojnë: identifikimin e viktimave, statusin juridik të viktimave, ndihmën për viktimat para se të kthehen, si dhe masat për integrimin e tyre, procedurën penale e cila i përfshin viktimat e trafikimit si dëshmitarë dhe dëmshpërblimin e viktimave. Më tej, si masa të veçanta me PSO është parashikuar **mbrojtja dhe ndihma** përmes masave, programeve, dhënira e shërbimeve dhe rehabilitimi i viktimave, ndërsa këto masa mund të përfshijnë vendosjen, mbrojtjen shëndetësore, ndihmën psikologjike, edukimin, trajnimin profesional dhe ndihmë juridike të viktimave.

Për më tepër, parashikohet **riintegrimi** i cili para së gjithash fokusohet në bashkimin e sërishëm të viktimave me familjet e tyre ose integrimin e tyre në bashkësi të re dhe në mjedis social përmes zgjidhjes afatgjate sociale dhe ekonomike. Gjithashtu, parashikohet edhe **sigurimi i shërbimeve** përmes organizatave dhe institucioneve, duke i përfshirë edhe punonjësit social, psikologët, personelin në qendrat e pranimi, punonjësit mjekësor dhe avokatët, si dhe organizatat joqeveritare. Së këtejmi, parashikohen edhe **qendra pranimit** përmes sigurimit të dhomave dhe ambienteve të sigurta, në të cilët sigurohet vendosja e përkohshme afatshkurtë ose afatgjatë e viktimave, si dhe mbrojtja e dëshmitarëve me masa sigurie, masa të nevojshme për sigurimin e mbrojtjes së viktimave gjatë procedurave ligjore dhe mbrojtja e dëshmitarëve.

Plan veprimi nacional për luftë kundër trafikimit me Qenie njerëzore për periudhën kohore 2009-2012

Konform Planit të Veprimit Nacional për Luftë Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore, duhet të përforcohet koordinimi midis institucioneve qendrore për luftë kundër trafikimit, të sigurohet implementim efektiv i Planit të Veprimit, përmes monitorimit dhe evaluimit sistematik, të forcohet fokusi i identifikimit të viktimizimit sekondar, si dhe të avancohet procedura hetimore dhe ndjekja penale, ndërkohë që gjatë ndërmarrjes së aktiviteteve të përfshihet dhe të merr pjesë edhe shoqëria civile. Trajtimi i viktimave të bazohet në të drejtat e njeriut dhe të ketë qasje dhe koordinimin interdisiplinar. Njëherësh, imponohet kryerjen e analizës së situatës dhe vlerësimin e kornizës ekzistuese institucionale dhe analizën e gjendjes në kuptim të tendencave me trafikimin me njerëz.

Me Planin e Veprimit janë paraparë edhe disa objektiva strategjike, në mesin e të cilave: përmirësimi i kornizës ligjore dhe ndjekjes penale, me ç'rast ndër të tjerash rekomandohet që për çdo fëmijë-viktimë të sigurohet ndihmë juridike falas dhe të ketë fond të posaçëm për dëmshpërblimin e viktimave, të përforcohet bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar, me qëllim të luftimit efikas të trafikimit me njerëz, të përmirësohen mekanizmat për koordinim (Komisioni Nacional për Luftë Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore, Nën-grupi për Luftë Kundër Trafikimit me Fëmijë, Raportuesi Nacional për referimin e Viktimave, Raportuesi Nacional dhe këshillat lokal të cilët duhet të formohen në komuna).

Në kontekst të parandalimit, me Planin e Veprimit janë paraparë më tepër masa dhe aktivitete dhe në veçanti: identifikimi i shkaqeve për fenomenin e trafikimit me njerëz dhe identifikimi i grupeve në rrezik, ngritja e plotë e vetëdijes për shkaqet e trafikimit me njerëz përmes krijimit të aktiviteteve prioritare për parandalim, të bazuara në rezultatet e hulumtimit të realizuar, përforcimi i kapaciteteve për parandalim nga ana e specialistëve të cilët punojnë me grupe në rrezik dhe ngritja e vetëdijes dhe edukimit përmes ndërtimit të sistemit për edukim të vazhdueshëm, ngritja e vetëdijes qytetare për trafikimin me njerëz, ulja e vulnerabilitetit përmes krijimit të mekanizmave për reduktimin e shkaqeve të trafikimit, përfshirjen e temave në shkollat fillore dhe të mesme, përforcimin e gjendjen ekonomike të grupeve vulnerable, ndërtimin e marrëveshjeve bilaterale të cilat e rregullojnë punësimin sezonal, sigurimin dhe mbështetjen e viktimave përmes identifikimit dhe referimit, me dhënien e ndihmës së drejtpërdrejt për viktimat, sigurimin e informatave për viktimat në lidhje me të drejtat, obligimet dhe mundësitë e tyre, ndihmë mjekësore falas, ndihmë dhe



kujdes psikologjik varësisht nga nevojat individuale, ndihmë juridike për viktimat dhe migrantët, riadhesimi dhe riintegrimi, si dhe masa të tjera.

Sa i përket luftës së trafikimit me njerëz, përkatësisht me fëmijë ekziston Plan i veçantë i Veprimit, në të cilin janë përcaktuar objektiva dhe orientime të përgjithshme ku janë përcaktuar: sigurimi i mekanizmave dhe praktikave të mira për tejkalimin e problemit me trafikimin me fëmijë, përfshirë edhe parandalimin, mbrojtja dhe riintegrimi i fëmijëve-viktima, ndjekja e kryerësve të veprave penale, ndërmarrja e masave parandaluese për reduktimin e shkaqeve dhe rreziqeve të cilat çojnë në rritjen e dukurisë së trafikimit dhe eksploatimit të fëmijëve, inkorporimi i paketës së standardeve të shërbimeve minimale për sigurimin e ndihmës, mbrojtjes, rehabilitimit dhe riintegrimit të fëmijëve-viktima, vlerësimi i gjendjes përmes sistemit të instaluar për ndjekjen e gjendjes dhe grumbullimin e përpunimin e të dhënave për trafikimin me fëmijë dhe organizimin e trajnimeve të specializuara për organet kompetente për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave.

Në kontekst të parandalimit, me Planin e Veprimit për Luftë Kundër Trafikimit me Fëmijë është përcaktuar: përforcimi i kapaciteteve njerëzore dhe institucionale me qëllim të aktiviteteve parandaluese për trafikimin e fëmijëve dhe ngritja e vetëdijes publike për problemin, sidomos tek fëmijët dhe prindërit, hapja e qendrave ditore për përkujdesjen e fëmijëve në rrugë, të cilët janë viktimat potenciale të trafikimit, sensibilizimi i mediave për këtë fenomen dhe organizimi i trajnimeve profesionale në qendra dhe polici për parandalim, pajisja e ambienteve të veçanta për punë me fëmijët, organizimi i ligjëratave parandaluese në shkollë dhe përfshirja e trafikimit për fëmijë në përmbajtjet mësimore, etj.

Në lidhje me ndihmën dhe mbrojtjen, në Planin e Veprimit parashikohet: inkorporimi i minimum standardeve për ndihmë, trajtimi dhe mbrojtja e viktimave dhe fëmijëve dëshmitarë, sistemi nacional për ndjekjen e zbatimit të programit për riintegrim dhe risocializim sidomos përmes qendrave për punë sociale, trajnimi i familjeve kujdestare dhe trajnimi i përfaqësuesve nga të gjitha institucionet, veçanërisht trajnimi për përdorimin e teknikave të posaçme për zhvillimin e bisedës me fëmijën-viktimë.

Sa u përket masave për rehabilitim dhe riintegrim, me Planin e Veprimit, mes tjerash, parashikohet: inkorporimi i sistemit për rehabilitimin, riintegrimin dhe riadhesimin e sigurt të fëmijëve-viktima, ndjekja e programeve për riintegrim dhe risocializim, krijimi i politikave për mbështetjen psiko-sociale të fëmijëve të vendosur në qendrat e pranimit dhe krijimi i qendrave për rehabilitim dhe masa të tjera.

Plan veprimi për parandalimin dhe luftimin e abuzimit seksual të fëmijëve dhe pedofilisë 2009-2012

Plani i Veprimit për Parandalimin dhe Luftimin e Abuzimit Seksual të Fëmijëve dhe Pedofilisë, bazohet në Konventën e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Eksploatimi Seksual dhe Abuzimi Seksual, Konventën e cila ka të bëjë me ndalimin e punës së fëmijëve dhe veprimin urgjent në eliminimin e formave më të këqija të punës së fëmijëve, Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe Protokollin Fakultativ për Shitjen e Fëmijëve, Prostitucionin e Fëmijëve dhe Pornografinë e Fëmijëve ndaj Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

Me qëllim të realizimit efikas dhe gjithëpërfshirës të objektivave të Planit të Veprimit, janë përcaktuar udhëzimet dhe prioritetet si vijojnë: zbatimin e dokumenteve ndërkombëtare të cilët kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijës dhe me mbrojtjen nga forma të ndryshme të dhunës dhe abuzimit, ndërmarrjen e masave për parandalimin dhe sensibilizimin e publikut të gjerë për këtë dukuri negative, krijimin e masave për ndihmë dhe mbrojtjen e viktimave të abuzimit seksual dhe pedofilisë, inkorporimin e masave për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të abuzimit seksual dhe pedofilisë, inkorporimin e masave dhe programit për trajtimin e personave të dënuar për këto vepra, gjatë kohës së vuajtjes së dënimit dhe pas përfundimit të dënimit, ndërkaq me qëllim të pengimit të recidivizmit, inkorporomin e mekanizmit për koordinimin e subjekteve të involvuara nga të gjitha fushat në parandalimin dhe



luftimin e abuzimit seksual të fëmijëve dhe pedofilisë, inkorporimin e edukimit të personave profesionistë për identifikimin dhe ndërmarrjen e masave të mbrojtjes, inkorporimin e evidencës unike dhe zbatimin e monitorimit dhe evaluimit, si dhe avancimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Sa i përket parandalimit parashikohet: sensibilizimi dhe ngritja e vetëdijes publike për problemet e abuzimit seksual të fëmijëve dhe pedofilisë, organizimi i punëtorive edukative dhe inkorporimi i përmbajtjeve programore në shkollat fillore dhe të mesme, si dhe në institucione tjera edukative-arsimore për këtë problem, informimi dhe edukimi i prindërve dhe familjeve të cilat janë në rrezik social për problemin e cekur, trajnimi i organizatave joqeveritare për zbatimin e aktiviteteve parandaluese për tejkalimin e këtij problemi dhe trajnimi i përfaqësuesve të mjeteve të informimit publikë me qëllim të informimit të tyre me problemin dhe njoftim përkatës për të njëjtin, nxitjen e denoncimit të rasteve të abuzimit seksual të fëmijëve dhe ndërmarrjen e masave për përfshirjen e fëmijëve në sistemin arsimor.

Në aspekt të mjeteve për ndihmë dhe mbrojtje, me Panin e Veprimit, mes tjerash, parashikohet: pengimi i viktimizimit të mëtuqjeshëm të fëmijëve-viktima, sigurimi i formës përkatëse të mbrojtjes dhe përkujdesjes së fëmijës-viktimë, hapja e këshillimoreve për trajtimin e fëmijëve-viktima dhe mbështetja e tyre psiko-sociale, përgatitja dhe hapja e këshillimoreve për trajtim, hartim dhe realizim të masave dhe programit për trajtimin e viktimave, por edhe të kryerësve dhe personave të dënuar për vepra për abuzim seksual të fëmijëve, gjatë kohës së dënimit dhe pas vuajtjes së dënimit, edukim i vazhdueshëm i të gjithë profesionistëve dhe koordinim ndërmjet institucioneve kompetente dhe ndërmjet institucioneve dhe organizatave joqeveritare.

Programi për risocializimin dhe riintegrimin e fëmijëve-viktima të trafikimit me qenie njerëzore

Në përputhje me Strategjinë dhe Planin Nacional për Luftë Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Migracion Ilegal, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Planin e Veprimit për Luftë Kundër Trafikimit me Fëmijë, si dhe kornizën ligjore ekzistuese në shtetin tonë, Ministria për Punë dhe Politikë Sociale miratoi Programin për Risocializimin dhe Riintegrimin e Fëmijëve-Viktima të Trafikimit me Qenie Njerëzore, në të cilin janë përfshirë çështje që kanë të bëjnë me parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve-viktima të trafikimit me njerëz.

Me këtë Program, veçanërisht parashikohet që: fëmijës-viktimë t'i caktohet kujdestari në afat sa më të shkurtër kohor ose të bëhet bashkë me familjen, nëse një gjë e tillë është në interesin e tij më të mirë. Në rast se kthimi në familje nuk do të thotë siguri për fëmijën, të ndërmerren masa për ndihmë dhe mbrojtje të të drejtave dhe interesave të fëmijës, të respektohet mendimi i fëmijës, konform mundësisë së tij për ta shprehur mendimin dhe të mbrohet privatësia dhe identiteti i fëmijëve-viktima, të miratohen programe individuale për punë për mbrojtjen dhe mbështetjen e fëmijëve-viktima sa i përket ndihmës fizike, psikologjike, arsimore, shëndetësore, strehimit dhe ngjashëm.

Protokolli për bashkëpunim ndërmjet institucioneve kompetente në rastet e abuzimit seksual të fëmijëve dhe pedofilisë

Me këtë Protokoll rregullohet bashkëpunimi i organeve kompetente në përputhje me ligjet, aktet nënligjore dhe Planin e Veprimit për Parandalimin dhe Luftimin e Abuzimit Seksual të Fëmijëve dhe Pedofilisë për vitet 2009-2012, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Në Protokoll janë përfshirë format, mënyra dhe përmbajtja e bashkëpunimit ndërmjet organeve kompetente dhe pjesëmarrësve tjerë në zbulimin dhe parandalimin e abuzimit seksual të fëmijëve dhe pedofilisë në dhënien e mbrojtjes së fëmijëve-viktima të



abuzimit seksual dhe pedofilisë, si dhe ndryshimin e sjelljes dhe integrimin e në shoqëri të kryerësve të veprave të këtuilla.

Sipas Protokollit, çdo organ shtetëror duhet: të veprojë maksimalisht me kujdes me fëmijët-viktima të abuzimit seksual dhe pedofilisë, përkatësisht të veprojë në mënyrë me të cilën do të sigurohet respektim i të drejtave dhe dinjitetit të tyre; të shmang çdo veprim i cili do të mund të shpinte ose të trajtohet si viktimizim i sërishëm dhe i mëtutjeshëm i fëmijëve-viktima; duke vepruar me fëmijët-viktima, organet e kanë për detyrë të veprojnë konform parimit për interesin më të mirë të fëmijëve, me përkushtim dhe me kujdes t'i mbrojnë të gjitha të drejtat dhe interesat e fëmijës, veçanërisht duke mbajtur llogari për moshën dhe shkallën e zhvillimit psikofizik të fëmijës, si dhe për gjendjen e tij shëndetësore dhe emocionale. Gjithashtu, duke vepruar me fëmijët-viktima, e kanë për detyrë ta informojnë fëmijën-prindin-kujdestarin për të drejtat e tij dhe mundësitë për mbrojtje, t'i marrin parasysh mendimet dhe qëndrimet e tij dhe rregullisht ta informojnë për rrjedhën e procedurës sipas lëndës, ndërkaq kryerësi i veprës të njoftohet me mundësinë për përfshirjen në trajtim psiko-social pa e paragjykuar përgjegjësinë e tij penale, me qëllim që të ndikohet në ndryshimin e sjelljes së tij dhe të inkorporohet evidencë unike për fëmijët-viktima të abuzimit seksual dhe pedofilisë.

Me këtë Protokoll, për çdo organ veç e veç, janë përcaktuar procedurat dhe masat të cilat duhet t'i ndërmerr dhe të procedojë në koordinim të përbashkët me organet dhe organizatat e tjera relevante.

HULUMTIMI I ORGANIZATËS BOTËRORE TË SHËNDETËSISË¹

Hulumtimi është kryer nga Klinika Universitare për Psikiatri, Seksioni për Psikiatri të Fëmijëve dhe të Adolehentëve në Shkup dhe Këshilli Hulumtues Shkencor, i përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Zyra e Organizatës Botërore të Shëndetësisë në Shkup dhe Zyra Rajonale e OBSH për Evropë. Hulumtimi është formuar në bazë të modelit reprezentativ nga nxënës të viteve të katërta të shkollave të mesme dhe nga studentë të vitit të parë dhe të dytë të studimeve. Janë përfshirë 664 nxënës edhe atë 258 meshkuj dhe 406 femra dhe 613 studentë, nga të cilët 343 femra dhe 270 meshkuj. Shkollat dhe fakultetet janë zgjedhur me zgjedhje të rastit. Një pjesë e hulumtimit, përveç keqtrajtimit fizik dhe psikik, ka të bëjë me abuzimin seksual. Në hulumtim është shfrytëzuar qasja e pasqyrës transversale, në mënyrë që të vlerësohet shtrirja dhe eventualisht lidhja e rëndësishme e ndërsjellë midis përvojave negative nga fëmijëria dhe sjellja e rrezikshme për jetë.

Hulumtimi është realizuar në vitin 2010 dhe janë përfshirë pesë qytete më të mëdha të Republikës, ndërkohë që është zbatuar përmes Pyetësorit me 68 pyetje.

Sa i përket përkatësisë etnike të të anketuarve 69,2% kanë qenë maqedonas, 24.6% shqiptarë, 3,4% turq, 1,3% serbë, 0,5% vllah, 0,5% romë, 0,6% të tjerë, e që përafërsisht korrespondon me përfaqësimin në përqindje të bashkësive etnike në Republikën e Maqedonisë.

Një nga parametrat gjatë hulumtimit është përcaktimi dhe verifikimi i ekspozimit në përvoja negative në fëmijëri

Një nga parametrat e hulumtimit është përcaktimi i ekspozimit në përvoja negative në fëmijëri, me ç'rast në aspekt të abuzimit seksual në fëmijëri, sa i përket abuzimit seksual, është konstatuar se 7,3% e personave femra të anketuara janë ekspozuar në abuzim seksual në fëmijëri, ndërsa 20,8% e meshkujve, ose gjithsej nga të gjithë të anketuarit 12.9% në fëmijëri kanë qenë të ekspozuar në abuzim të këtyllë.

Sipas llojit të abuzimit seksual 7,3% e femrave të anketuara kanë qenë të ekspozuara në abuzim seksual me prekje ose përkëdhelje në mënyrë seksuale, 5.1% kanë prekur trupin e huaj në mënyrë seksuale, 5,7% dikush ka bërë përpjekje të ketë marrëdhënie seksuale me ta dhe 3,1% kanë pasur marrëdhënie seksuale me dikë. Ndërkaq, tek meshkujt 20.8% kanë qenë të abuzuar seksualisht me prekje ose përkëdhelje në mënyrë seksuale, 19% me prekje të trupit të huaj në mënyrë seksuale, 15% dikush ka bërë përpjekje të ketë marrëdhënie seksuale me ta dhe 1.2% kanë pasur marrëdhënie seksuale me dikë.

Sa i përket lidhshmërisë së viktimës me kryerësin, hulumtimi ka treguar se tek personat femra në 49% të rasteve ata kanë qenë persona të njohur, por që nuk kanë jetuar bashkë në shtëpi, 16,4% kanë jetuar bashkë me viktimën, 20% kanë qenë persona të panjohur, 36,4% janë abuzuar nga persona të cilët është dashur të kujdesen për ta, ndërsa 61,8% kanë qenë persona tek të cilët kanë pasur besim. Ndërkaq tek të anketuarit meshkuj 41,8% kryerësit kanë qenë persona të njohur, por që nuk kanë jetuar bashkë në shtëpi, 20,9% kanë jetuar bashkë me viktimën, 31,8% kanë qenë persona të panjohur, 20,9% persona të cilët është dashur të kujdesen për ta dhe 28,1% kanë qenë persona tek të cilët kanë pasur besim.

Sipas mënyrës së manipulimit të viktimave të abuzimit seksual, nga hulumtimi ka rezultuar se në 36,3% të rasteve, personat femra janë detyruar me mashtrim dhe duke i bindur në mënyrë verbale, 14,5% me përdorim të alkoolit dhe drogës, 23,6% me kërcënime për lëndim dhe 16,3% me forcë fizike. Ndërkaq tek meshkujt e anketuar 27,2% janë detyruar me mashtrim dhe bindje verbale, 29% me përdorim të alkoolit dhe drogës, 17,2% me kërcënime për lëndim dhe 13,6% me forcë fizike.

¹ "Raporti për përvojat negative në fëmijëri: hulumtim i realizuar në Republikën e Maqedonisë të modelit nacional reprezentativ të nxënësve dhe studentëve të shkollave të mesme dhe fakulteteve -2012"



Paraqitje të dukurisë suicide tek viktimat, për shkak të abuzimit seksual, ka pasur tek 4,76% e femrave të anketuara, ndërsa 0,8% tek viktimat meshkuj, ndërsa në aspekt të moshës, me këso tentativa, në numër më të madh kanë qenë fëmijët deri në moshën 14 vjeç. Tek 1,2% e femrave ka pasur lëndim si rezultat i tentativës për vetëvrasje, ndërsa 0.2% të meshkujt. Tek 1.5% e viktimave femra ka pasur më shumë se një herë tentativë për vetëvrasje, ndërsa tek meshkujt 0,4%, dukuri të anëtarit depresiv ose të sëmurë mendor në familje ka pasur 6,3% tek femrat dhe 5% tek meshkujt.

